



COVID - 19 dhe tregu i punës

Autorë:

Goran **LLAZAROV**, Diana **ZHUPANOSKA**,

Andreja STOJKOVSKI dhe Jovana **PETKOVSKA**



KOMITETI I
HELSINKIT PËR
TË DREJTAT E
NJERIUT



RRITJA E
PRODUKTIVITETIT
PËRMES PËRMIRËSIMIT
TË LEGJISLACIONIT
PËR MARRËDHËNIE
PUNË NË MAQEDONI



British Embassy
Skopje



UKaid
from the British people

Analiza është hartuar në suaza të projektit "Rritja e produktivitetit nëpërmjet të përmirësimit të kornizës ligjore mbi marrëdhëniet e punës në Maqedoninë e Veriut", financuar nga Fondi i Qeverisjes së Mirë të Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetje nga Ambasada britanike në Shkup. Opinione dhe qëndrimet e kësaj përmbajtjeje nuk i reflektojnë gjithmonë opinionet dhe qëndrimet e Qeverisë britanike.

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut përfaqësuar nga kryetarja prof. dr. Neda Zdraveva

Redaktore:

Uranija Pirovska, drejtore ekzekutive e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Autorë:

Goran Llazarov, koordinator

Mr. Andreja Stojkovski

Jovana Petkovska

Mr. Diana Zhupanoska

Përkthim:

Armina Sinani

Korrektimi:

Shenasi Jaji

Photo credit : Victor Furtuna

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.51:[616.98:578.834(497.7)(047.31)

331.5:[616.98:578.834(497.7)(047.31)

COVID - 19 dhe tregu i punës [Електронски извор] / Goran Llazarov
... [и др.]. - Текст во PDF формат, содржи 110 стр. ; графички прикази.
- Shkup : Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, 2021

Начин на пристапување (URL): <http://www.mhc.org.mk/>. - Наслов преземен
од екранот. - Опис на изворот на ден 10.03.2021. - Фусноти кон текстот.
- Други автори: Andreja Stojkovski, Jovana Petkovska, Diana Zhupanoska

ISBN 978-608-4790-88-4

1. Llazarov, Goran [автор] 2. Stojkovski, Andreja [автор] 3. Petkovska,
Jovana [автор] 4. Zhupanoska, Diana [автор]

COBISS.MK-ID 53349381

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	5
REZIME..	6
HYRJE..	7
METODOLOGJIA...	8
KRONOLOGJIA	11
ANALIZË..	16
ANALIZË E DISPOZITAVE RELEVANTE TË VENDIT DHE MASAT E QEVERISË	16
ANALIZË E EFIKASITETIT TË ZBATIMIT TË MASAVE..	20
ANALIZA E IMPLIKACIONEVE FINANCIARE NGA MASAT DHE PAKOT PËR BALLAFAQIM ME KRIZËN	28
ANALIZË E RREGULLAVE NDËRKOMBËTARE, REKOMANDIMEVE DHE MASAVE	39
ANALIZË E PËRVOJAVE TË SHTETEVE TË REGJIONIT	42
ANALIZA E REZULTATEVE TË HULUMTIMIT KUALITATIV	49
ANALIZA E TË DHËNAVE NGA HULUMTIMI KUANTITATIV	53
V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	85
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	92
SHTOJCË – PYETËSOR	93

LISTA E SHKURTESAVE

- COVID-19** – Sëmundja e një variacioni të ri të virusit korona nga viti 2019
- COVAX** – Mekanizmi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë për qasje më të shpejtë në ndihmë për trajtimin e virusit korona
- ONP** – Organizata Ndërkombëtare e Punës
- BE** – Bashkimi Evropian
- OBSH** – Organizata Botërore e Shëndetësisë
- RYP** – Reaksioni zinxhiror polimer
- PVP** – Përsosje e vazhdueshme profesionale
- TVSH** – Taksë mbi vlerën e shtuar
- FIZHT** – Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik
- PBB** – Prodhimi i brendshëm bruto
- KNF-PP** – Kërkesë për ndihmë financiare për pagesën e pagave
- TP** – Tatimpagues
- APRSM** – Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KMF-PVP** – Kërkesë për mbështetje financiare për pagesën e mjeteve financiare personave fizikë që kryejnë veprimtari të pavarur
- NF** – Ndihmë financiare
- KS-KSDS** – Kërkesa për subvencionimin e shumës për pagesën e kontributeve të sigurimit të detyrueshme social
- MPPS** – Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

Rezime

Analiza e titulluar **"COVID-19 dhe tregu i punës"** u përgatit në kuadër të projektit "Rritja e produktivitetit nëpërmjet të përmirësimit të kornizës ligjore për marrëdhëniet e punës në Maqedoninë e Veriut", financuar nga Fondi për Qeverisje të Mirë të Britanisë së Madhe dhe synon të përcaktojë pasojat nga kriza shëndetësore dhe ndikimin e masave për menaxhimin e saj në tregun e punës. Gjatë kësaj, pyetja kërkimore në të cilën u përpoq të përgjigjet ekipi, është si vijon: ***"Si ndikoi kriza shëndetësore në tregun e punës dhe si të ndryshohet legjislacioni, në mënyrë që ta bëjë tregun e punës më rrezistues dhe të gatshëm për krizën ekonomike që vijon?"***

Analiza përfshiu masat që i morri Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me qëllim të menaxhimit të pandemisë, legjislacionin përkatës kombëtar për marrëdhëniet e punës dhe mbrojtjen e shëndetit publik, por edhe rregullativën dhe standardet ndërkombëtare, që dalin nga

Organizata Ndërkombëtare e Punës dhe Bashkimi Evropian. Analiza gjithashtu i qaset dhe shqyrton edhe përvojën e Bashkimit Evropian dhe shteteve të ish-Jugosllavisë: Kroacisë, Malit të Zi, Sllovenisë, Bosnje e Hercegovinës, Serbisë dhe Kosovës. Së fundmi, analiza shqyrton pikëpamjet e tri grupeve të palëve të interesuara, nëpunësve publikë, punëtorëve dhe punëdhënësve, përmes hulumtimit cilësor, si dhe analizë të qëndrimeve dhe perceptimeve të qytetarëve në lidhje me pandeminë dhe mënyrën e menaxhimit të saj, të siguruara përmes hulumtimit kuantitativ.

Në fund, në analizë nxirren konkluzione dhe jepen rekomandime në drejtim të segmenteve të analizuara dhe menaxhimit të pandemisë, e të cilat do të mund të kontribuonin edhe në përmirësimin e situatës së tregut të punës dhe zvogëlimin e efekteve negative të pandemisë në periudhën e ardhshme.

I. HYRJE

Ky raport është rezultat i hulumtimit të kryer nga ekipi i Institutit PRESPA nga Shkupi, në periudhën nga gushti deri në nëntor 2020. Hulumtimi u bë për nevojat e projektit **"Rritja e produktivitetit nëpërmjet të përmirësimit të kornizës ligjore për marrëdhëniet e punës në Maqedoninë e Veriut"** të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Përmes hulumtimit, ekipi i përbërë nga: **Goran Llazarov**, koordinator, **Diana Zhupanoska** dhe **Andreja Stojkovski**, hulumtues dhe **Jovana Petkovska** ndihmës hulumtuese, përpiqet të përcaktojë pasojat e krizës shëndetësore dhe ndikimin që masat për menaxhimin e saj e kanë në tregun e punës. Gjatë kësaj, pyetja kërkimore në të cilën përpiqet të përgjigjet ekipi, është si vijon: ***"Si ndikoi kriza shëndetësore në tregun e punës dhe si të ndryshohet legjislacioni në mënyrë që ta bëjë tregun e punës më rrezistues dhe të gatshëm për krizën ekonomike që vijon?"***

Analiza përfshin masat që u morrën me qëllim të menaxhimit të pandemisë së koronavirusit, si dhe rregullativën përkatëse kombëtare në legjislacionin ekzistues të punës. Këtu është përfshirë rregullativa përkatëse ndërkombëtare, gjegjësisht rregullativa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) për menaxhimin e krizës - me qëllim që të fitohet një pasqyrë e rekomandimeve të ONP - së, standardeve të vendosura për mbrojtje në punë, kapërcimit të ndikimit ekonomik dhe social të COVID-19, si dhe përgjigjen e Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu u bë edhe një analizë e shkurtër e standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit të BE-së në aspekt të tregut të punës dhe menaxhimit të krizës - në mënyrë që të analizohet programi SURE¹, si një përgjigje e përbashkët e Bashkimit Evropian në luftën me pasojat e COVID-19. Gjatë kësaj u shqyrtuan të gjitha direktivat dhe vendimet shtesë në fusha të ndryshme, që u miratuan në përgjigje të pandemisë². Së fundmi, analiza përfshin edhe rregullativën kombëtare dhe përgjigjet ndaj krizës në Slloveni, Kroaci, Bosnje e Hercegovinë, Mal të Zi, Serbi dhe Kosovë, për të krahasuar efektet përmes shembujve të tyre.

Analiza është bërë për nevojat e vlerësimit të ndikimit të masave për mbrojtjen e punëtorëve, në mënyrë që të përcaktohet zbatimi praktik dhe shkalla se sa janë të kënaqur punëtorët në aspekt të përballjes me krizën. Rezultatet e analizës dhe hulumtimit janë përmbledhur dhe pastaj u nxorrën edhe konkluzione e rekomandime për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve gjatë dhe pas pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.

¹ Support to mitigate Unemployment Risks in an Emergency (SURE), skemë programore për mbështetje të punësimit afatshkurtër - Komisioni Evropian, në dispozicion në linkun: <https://rb.gy/t9wivo>.

² Pasqyrë e legjislacionit të Bashkimit Evropian, miratuar në kapituj të ndryshëm, si rezultat i COVID-19, në dispozicion në linkun: <https://eur-lex.europa.eu/content/news/Covid19.html>.

II. METODOLOGJIA

Realizimi i hulumtimit nënkuptonte kombinim të disa metodave të hulumtimit, kurse hulumtimi anketues ishte bazë për marrjen e informatave për menaxhimin e pasojave të krizës shëndetësore në tregun e punës dhe avancimin e legjislacionit maqedonas. Përgatitjes së pyetësorit për hulumtimin i paraprinë më shumë hapa që mundësuan në të njëjtin të përfshihen të gjitha çështjet relevante në lidhje me temën.

Në fillim të periudhës së hulumtimit, si hap të parë, ekipi i Institutit PRESPA filloi **hulumtimin në zyrë**. Në të, u bë një analizë e hollësishme e dokumenteve relevante vendase dhe ndërkombëtare në lidhje me krizën shëndetësore. Fokus i veçantë në analizë u vu në informatat e mëposhtme:

1. Masat që u morrën me qëllim të ballafaqimit me virusin dhe legjislacioni relevant kombëtar;
2. Rregullativa kombëtare dhe rregullativa e zgjedhur ndërkombëtare, reagimet ndaj krizës dhe krahasimi i efekteve;
3. Rregullativa e TNP për ballafaqimin me krizën.

Gjatë analizës së rregullativës kombëtare u përfshinë **Ligji për Marrëdhëniet e punës** (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.62/2005 dhe ndryshimet vijuese)³; **Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë** (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.92/2007 dhe ndryshimet vijuese)⁴; **Ligji për mbrojtjen e popullësisë nga sëmundjet infektive** (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.66/2004 dhe ndryshimet vijuese)⁵; të gjitha dekretet me fuqi ligjore të miratuara gjatë gjendjes së jashtzakonshme⁶ dhe konkluzionet dhe rekomandimet e Qeverisë për organizimin e punës (siç janë masat dhe konkluzionet e Qeverisë nga seanca e mbajtur më 19.03.2020)⁷.

Në kuadër të hulumtimit në zyrë, gjithashtu u shfrytëzua edhe mekanizmi për qasje të lirë në informata të karakterit publik, me qëllim të përcaktimit dhe analizimit të numrit të punëtorëve që ngelën pa punë, që kishin ulje të konsiderueshme të pagave

³ Ligji për marrëdhënie pune, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 62/2005 dhe ndryshimet vijuese, në dispozicion në linkun: <https://rb.gy/mj8p7w>.

⁴ Ligji për siguri dhe shëndet në punë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.92/2007 dhe ndryshimet vijuese, në dispozicion në linkun: <https://rb.gy/vb3q31>

⁵ Ligji për mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet infektive, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 66/2004 dhe ndryshimet vijuese, në dispozicion në linkun: <https://rb.gy/xszpdx>.

⁶ Dekrete me fuqi ligjore që i ndërmoi Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë gjendjes së jashtzakonshme - Pasqyrë e sistematizuar, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj - Shkup, në dispozicion në linkun: <https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Sistematiziran-pregled-Uredbi-so-zakonska-sila.pdf>

⁷ Pasqyrë e masave dhe konkluzioneve për menaxhimin e krizës shëndetësore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në mbledhjen e mbajtur më 19 mars të vitit 2020, në dispozicion në linkun: <https://koronavirus.gov.mk/vesti/211176>

ose në ndonjë mënyrë tjetër u përballën me shkelje të rëndë të të drejtave të tyre të punës në periudhën para, gjatë dhe pas gjendjes së jashtëzakonshme, si dhe për përcaktimin dhe analizimin e numrit të punëdhënësve dhe qytetarëve që kanë shfrytëzuar masat për përballjen me koronavirusin.

Në fazën vijuese, ekipi i Institutit PRESPA iu qas **hulumtimit cilësor** në të cilin u zhvilluan 33 intervista të strukturuar në kategoritë e mëposhtme të qytetarëve:

1.Nëpunës civilë dhe publik;

2.Punëdhënës nga industritë që u prekën më shumë (industria e tekstilit, industria e përpunimit, hotelieria, etj.), përfaqësues të ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha;

3.Punëtorët e punësuar në industrinë e përpunimit dhe tekstilit, punëtorët me aftësi të kufizuara, punëtorët në rrezik social dhe punëtorët nga zonat rurale.

Intervistat u zhvilluan sipas rregullave të anonimitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Fillimisht, para çdo interviste, të intervistuarve iu kërkuar pëlqim për të marrë pjesë dhe pëlqim që biseda të regjistrohej. Secili prej të intervistuarve mund të identifikohet vetëm nga të dhënat demografike për: gjininë, moshën dhe grupmoshën, ku jetojnë dhe cili është niveli më i lartë i arsimimit. Pyetjet në intervista ishin të llojit të hapur dhe të përshtatura rrëfimit personal të të intervistuarit. Informatat që u morrën nga intervistat me punëdhënësit japin të dhëna se si kompanitë i kanë zbatuar masat dhe standardet për siguri dhe mbrojtje në punë, sa u kanë ndihmuar masat e Qeverisë e të ngjashme. Ndërkaq, informatat nga intervistat me punëtorët tregojnë: sa dhe si janë respektuar rekomandimet për sigurinë dhe shëndetin në punë, si ka qenë qëndrimi i punëdhënësit, mënyrën e organizimit të marrëdhënies së punës dhe hapësirës, nëse u ishte lejuar të punojnë nga shtëpia etj. Të dhënat nga intervistat me nëpunësit shtetërorë dhe publikë tregojnë përvojën që këta qytetarë e kanë pasur me sigurinë në punë dhe menaxhimin e koronavirusit. Për nevojat e hulumtimit, ishin planifikuar edhe dy fokus grupe me punëtorë të industrive më të prekura, por për shkak të krizës shëndetësore dhe rrezikut të cilit do të duhej t'i ekspozoheshin të gjithë pjesëmarrësit, të dy grupet u anuluan.

Të dhënat që u morrën nga intervistat kanë edhe një qëllim të dytë dhe përveç në përgatitjen e këtij raporti, ndihmuan edhe gjatë përgatitjes së pyetësorit të sondazhit. Sondazhi i kryer i opinionit publik u krye përmes një sondazhi telefonik me asistencë të kompjuterit, në një shembull reprezentativ të punëtorëve, numri i të cilëve u përcaktua në përputhje me standardet e një ekzemplari përfaqësues. Gjegjësisht, shembulli përfaqësues kombëtar është bazuar në të dhënat e fundit të disponueshme nga Enti shtetëror i statistikës, i ashtuquajtur "etalon". Bazuar në disa parametra (rajoni, kombësia, fshati / qyteti), u përdor një metodë e veçantë për të përcaktuar se sa sondazhe do të kryhen në një komunë etj. Sondazhi u realizua me të ashtuquajturën "**popullatë të panjohur**", gjegjësisht ishte e panjohur se ku dhe sa qytetarë janë të punësuar, përkatësisht sa janë të papunë, kanë gjetur ose kanë humbur punën e tyre

gjatë pandemisë. Për këto parametra, nuk ka të dhëna zyrtare si në nivel shtetëror, ashtu edhe në nivel komunal. Prandaj, "etalon" më i afërt ishin të dhënat zyrtare në dispozicion, kurse supozimi kryesor ishte humbja ose fitimi i një pune gjatë pandemisë, si dhe supozimi se qytetarët të cilët janë të punësuar dhe punojnë që nga periudha parapandemike janë shpërndarë në mënyrë simetrike në të gjithë vendin. Sipas kësaj, numri i të anketuarve të synuar në sondazh korrespondon me numrin e të anketuarve sipas popullësisë, dmth. sipas të dhënave nga Enti shtetëror i statistikës.

Anketa telefonike u realizua nga agjencia BRIMA midis 15 tetorit dhe 5 nëntorit të vitit 2020 dhe shembulli u përcaktua në 1,007 të anketuar që gjetën një punë, ose u pushuan nga puna gjatë epidemisë, përkatësisht që paraprakisht kanë qenë të punësuar. Të anketuarit u përkasin të gjitha bashkësive etnike, jetojnë në të gjitha zonat urbane ose rurale dhe në të gjitha rajonet statistikore dhe planifikuese. Marzhi i gabimit në sondazh u përcaktua në +/- 3.08% me një nivel besueshmërie prej 95%.

Duke pasur parasysh faktin që sondazhi u bë në "**popullatë të panjohur**", analiza duhet të bëjë një krahasim brenda vetë kampionit: për shembull, sa përqind e një rajoni e kanë humbur punën, në krahasim me përqindjet e atyre që kanë humbur punën në një rajon tjetër dhe ngjashëm, pasi që gabimi standard për një segment të caktuar do të përcaktohet në varësi të madhësisë së shembullit dhe ndryshueshmërisë së tij. Për shembull, nëse tek një parametër i matur (të themi të njerëzve që u përgjigjën "PO" në një pyetje) është 30% ose 70%, gabimi standard për këto përqindje për shembullin prej $n = 1007$ të anketuarve është 2.83%

Me qëllim që të kuptohet dhe analizohet, në vijim kemi një tabelë orientuese:

Përqindja e matur	Marzhi i gabimit
50%	+/- 3.08%
40% ose 60%	+/- 3.02%
30% ose 70%	+/- 2.83%
20% ose 80%	+/- 2.47%
10% ose 90%	+/- 1.85%

Sondazhi i realizuar përmbante grupet e mëposhtme të pyetjeve:

- Grupi 1- Prezencë fizike në vendin e punës ose punë nga shtëpia;
- Grupi 2- Ndikimi i krizës shëndetësore (COVID-19) në vëllimin dhe përfitimin e ndërmarrjeve;
- Grupi 3- Kushtet e punës në kohën e krizës shëndetësore (COVID-19);

- Grupi 4-Të drejtat e punëtorëve dhe diskriminimi në vendin e punës;
- Grupi 5-Masat e Qeverisë për ballafaqim me krizën shëndetësore (COVID-19);
- Grupi 6-Favorizimi dhe / ose diskriminimi i sektorëve të caktuar, kompanive ose grupeve të punëtorëve.

III. KRONOLOGJIA

Me qëllim që të kuptohen zhvillimet dhe për përcjellje më të thjeshtë të masave të miratuara, në vazhdim të raportit është dhënë kornizë kronologjike e krizës shëndetësore, duke filluar nga rastet e para në Vuhan, Republika Popullore e Kinës e deri në nëntor 2020. Gjatë kësaj, në kornizë nuk do të përdorim linqe dhe fusnota, në mënyrë që të lehtësojmë leximin, veçanërisht duke ditur se gjatë analizës së secilës prej masave dhe ndikimit të tyre, tregojmë burimin e shfrytëzuar të informacionit, ose literaturën e shfrytëzuar.

JANAR

8 janar

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) shpalli se koronavirusi i ri mund të jetë shkaku i epidemisë së pneumonisë me origjinë të panjohur, që ndodhi në dhjetor në qytetin kinez Vuhan.

11 janar

U regjistrua rasti i parë me vdekje, si pasojë e koronavirusit të ri në Kinë dhe u regjistruan edhe infeksionet e para jashtë Kinës.

24 janar

Në Francë u regjistruan rastet e para në Evropë.

25 janar

Pas Vuhanit, pothuajse e gjithë provinca qendrore Hubei në Kinë, u vu në izolim.

28 janar

Në Japoni dhe Gjermani u regjistruan dy transmetimet e para direkte të infeksionit jashtë Kinës, kurse më shumë shtete i kthejnë shtetasit e tyre nga Vuhani.

30 janar

OBSH shpall gjendje ndërkombëtare të jashtëzakonshme, megjithëse nuk rekomandon kufizimin e udhëtimeve dhe tregtisë me Kinën.

SHKURT

16 shkurt

Kuvendi vendosi të vetëshpërndahet dhe ndaloi punën.

26 shkurt

U konfirmua rasti i parë i koronavirusit të ri (SARS-CoV-2) në Klinikën Universitare për sëmundje Infektive dhe gjendje febrile në Shkup.

MARS

6 mars

Dy raste të reja u konfirmuan në Qendrën e Zhupës.

10 mars

U miratuan masat e para kufizuese, të cilat përfshinë mbyllje dyjavore të të gjitha institucioneve arsimore, ndalimin e udhëtimit në vendet me rrezik të lartë dhe ndalimin e mbajtjes së manifestimeve publike dhe ngjarjeve sportive me publik.

11 mars

OBSH shpall pandemi globale.

13 mars

Shpallet gjendje krize në territorin e komunave të Dibrës dhe Qendrës Zupa, dhe e gjithë lëvizja brenda dhe jashtë këtyre komunave është e ndaluar.

U ndalohet hyrja shtetasve të huaj që vijnë nga vendet me rrezik të lartë.

14 mars

Të gjitha objektet e hotelierisë që përgatisin dhe shërbejnë ushqim janë të mbyllura për vizitorët - mysafirët.

16 mars

Të gjitha vendkalimet kufitare tokësore janë të mbyllura, si dhe kalimi kufitar në aeroportin në Shkup.

18 mars

Shpallet gjendje e jashtëzakonshme. Duke pasur parasysh faktin që Kuvendi ishte vetëshpërndarë, Qeveria, në përputhje me Kushtetutën, mori edhe pushtetin legjislativ.

19 mars

U miratua pakoja e parë e masave ekonomike.

21 mars

U shpall orë policore, si masë shtesë, e vlefshme nga ora 21:00 deri në 06:00 të mëngjesit tjetër.

22 mars

U regjistrua rasti i parë me vdekje nga COVID-19.

31 mars

U miratua pakoja e dytë e masave ekonomike.

U shpall orë policore për fundjavën që filloi të premten në orën 16:00 dhe mbaroi të hënën në orën 5:00 të mëngjesit.

PRILL

3 prill

U shpall orë policore për fundjavën që filloi të premten në orën 16:00 dhe mbaroi të hënën në orën 5:00 të mëngjesit.

8 prill

U vendos që ora policore në fundjavë do të fillojë të premten në orën 16:00 dhe do të zgjasë deri të hënën në orën 5:00 të mëngjesit.

17 prill

U vendos që ora policore në fundjavën festive do të fillojë të premten, më 17 prill, në orën 16:00 dhe do të përfundojë të martën, më 21 prill në orën 05:00 të mëngjesit.

23 prill

U vendos që ora policore do të fillojë në orën 19:00 dhe do të zgjasë deri në orën 05:00 të mëngjesit të ardhshëm. Gjatë fundjavëve, ora policore do të fillojë në orën 15:00 të shtunën dhe do të zgjasë deri të hënën, në orën 05:00 të mëngjesit.

MAJ

17 maj

U miratua pakoja e tretë e masave ekonomike.

24 maj

U vendos që ora policore në fundjavën e zgjatur do të fillojë të dielën, më 24 maj, në orën 11:00 dhe do të zgjasë deri në orën 05:00 të mëngjesit të të martës, 26 maj.

27 maj

U vendos që ora policore të pushojë së qeni e vlefshme.

28 maj

U vendos që të gjitha objektet hotelierike të jenë të hapura për punë me vizitorë-mysafirë, si dhe të punojnë me orar pune nga ora 8:00 deri në 22:00.

QERSHOR

17 qershor

Janë të hapura të gjitha vendkalimet kufitare, kurse hyrja në vend lejohet vetëm për ata që do të tregojnë test negativ PCR që nuk do të jetë më i vjetër se 72 orë. Qytetarët maqedonas mund të udhëtojnë vetëm në Shqipëri dhe Serbi.

23 qershor

Përfundoi gjendja e jashtzakonshme.

KORRIK

15 korrik

Zgjedhjet që ishin të planifikuara për më 12 prill 2020, janë shtyrë për këtë datë, për shkak të gjendjes së jashtzakonshme.

26 korrik

Hyrja në dhe nga Shqipëria lejohet pa testin e kërkuar më parë, PCR, si dhe pa karantinën e kërkuar.

GUSHT

31 gusht

Kuvendi zgjodhi përbërjen e re të Qeverisë.

SHTATOR

26 shtator

U miratua pakoja e katërt e masave ekonomike.

TETOR

6 tetor

Hyrja në dhe nga Serbia, Kosova, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina është e lejueshme pa testin e kërkuar më parë PCR, si dhe pa karantinën e kërkuar.

10-12 tetor

U mbajt fundjava pa TVSH, e cila ishte një nga masat e Qeverisë për të mbështetur prodhuesit vendas dhe qytetarët.

20 tetor

Është vendosur që orari i punës në objektet e hotelierisë, përveç atyre që bëjnë furnizime, të zgjatet deri në orën 23:00.

29 tetor

Kuvendi miratoi Ligjin për Ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Mbrojtjen e Popullësisë nga sëmundjet Infektive, i cili, ndër të tjera, parashikonte mbajtjen e detyrueshme të maskës mbrojtëse edhe në ambient të hapur.

NËNTOR

06 nëntor

U vendos që orari i punës për objektet gastronomike, përveç të atyre që bëjnë dërgesa, të shkurtohet deri në orën 21:00. U miratua rekomandimi për të gjithë qytetarët vendas, si dhe shtetasit e huaj që jetojnë në territorin e vendit, pas ores 21:00 të mos lëvizin në hapësirë publike, nëse nuk kanë nevoja të rëndësishme dhe të domosdoshme, si dhe rekomandimi për qytetarët, që të mos grupohen nëpër shtëpi për festime familjare, festa ose tubime të tjera në grupe me më shumë se katër persona që nuk jetojnë në të njëjtën bashkësi.

20 nëntor

U shpall gjendje krize në tërë territorin e vendit, në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Shpallja e gjendjes së krizës në territorin e gjithë vendit, është pasojë e rritjes së ndjeshme të rasteve të reja dhe ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit publik. Për shpalljen e gjendjes së krizës në territorin e të gjithë vendit, vendosi Qeveria. Vendimi i Qeverisë u bazua në propozimin e Komitetit Drejtues për Koordinimin dhe Menaxhimin e Sistemit të Menaxhimit të Krizave, si dhe në Grupin për vlerësim. Kjo procedurë u parapri nga një seancë e Këshillit të Sigurimit, i cili rekomandoi shpalljen e gjendjes së krizës në të gjithë vendin. Periudha e ekzistencës së gjendjes së krizës është 30 ditë, duke filluar nga 20 nëntori 2020.

IV. ANALIZË

1. ANALIZË E DISPOZITAVE RELEVANTE TË VENDIT DHE MASAT E QEVERISË⁸

Menaxhimi me krizën shëndetësore dhe sfidat që pasuan, si dhe mbrojtja e popullatës, filloi me masat e miratuara nga Qeveria më 11 mars, që më vonë, më 18 mars 2020, të vijojë shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme në të gjithë vendin.⁹ Gjendjen e jashtëzakonshme, në përputhje me nenin 125 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut¹⁰ e shpalli Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke qenë se Kuvendi u shpërnda. Gjendja e jashtëzakonshme përfundoi më 22.06.2020, pasi u shpall pesë herë: dy herë në kohëzgjatje prej 30 ditësh, dy herë në kohëzgjatje prej 14 ditësh dhe një herë në kohëzgjatje prej 8 ditësh.

Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme, përveç mbrojtjes së popullatës nga sëmundja nfektive, kishte për qëllim të ndihmojë Qeverinë që më shpejt dhe në mënyrë më efikase të ballafaqohet me rreziqet shëndetësore dhe ekonomike, të shkaktuara nga pandemia. Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme, duke pasur parasysh që Kuvendi ishte shpërndarë. Duke pasur parasysh kompetencat kushtetuese të Qeverisë dhe gjendjen e shpallur të jashtëzakonshme, në këtë periudhë Qeveria veproi si ligjvënëse duke shpallur **dekrete me fuqi ligjore**. Përgjatë gjendjes së jashtëzakonshme, u miratuan gjithsej 250 dekrete me fuqi ligjore, shumica e të cilave u referohen fushave: *ekonomi e financa* (54) dhe *kujdes shëndetësor* (22), ndërsa për fushën *marrëdhëniet e punës* (14). Duke ditur interesat e këtij hulumtimi, është e rëndësishme të theksohet se në ato 250 dekrete me fuqi ligjore, janë miratuar 7 dekrete që i referohen mbrojtjes sociale dhe sigurimit pensional dhe invalidor, si dhe 18 që i referohen ekonomisë, tregtisë, hotelierisë dhe turizmit.¹¹

Kjo pjesë e analizës synon të rishikojë dispozitat ekzistuese të legjislacionit përkatës për mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet infektive dhe mbrojtjen në punë, si dhe të analizojë masat, rekomandimet dhe dekretet me fuqi ligjore të miratuara nga

⁸ Me dispozita, lidhur me këtë hulumtim dhe raport, nënkuptojmë aktet ekzistuese ligjore dhe nënligjore të Republikës së Maqedonisë së Veriut me të cilat rregullohen marrëdhëniet e punës, ndërsa me masa nënkuptojmë të gjitha aktet, protokollet, rregulloret, rekomandimet që u sollën si rezultat i pandemisë dhe u orientuan drejt punëtorit dhe mbrojtjes së të drejtave të tij.

⁹ Kryetari Pendarovski shpalli gjendje të jashtëzakonshme, Akademik, në dispozicion në linkun: <https://akademik.mk/pretsedatelo-pendarovski-proglasi-vonredna-sostojba/>.

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në linkun: <https://www.sobranie.mk/content/Odluki%20USTAV/UstavSRSM.pdf>.

¹¹ Dekrete me fuqi ligjore që i solli Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë gjendjes së jashtëzakonshme— Pasqyrë e sistematizuar, Shoqata Maqedonase e juristëve të rinj - Shkup, në dispozicion në linkun: <https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Sistematiziran-pregled-Uredbi-so-zakonska-sila.pdf>, fq.28.

Qeveria e që kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi punëtorin gjatë pandemisë. Kryesisht do të shqyrtohen 2 aspekte: mbrojtja e shëndetit të punëtorëve, gjegjësisht ndihma financiare për menaxhim më të lehtë të krizës për punëtorët dhe punëdhënësit.

Para se të vazhdojmë më tutje, duhet të kemi parasysh se jo të gjithë punëtorët janë prekur njësoj nga kriza shëndetësore. Kategori të ndryshme kanë dhe/ose ndiejnë pasoja të ndryshme. Sipas dokumentit për politikë publike të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP), *"kriza ka ndikim të ndryshëm mbi kompanitë, mbi punëtorët dhe familjet e tyre, megjithëse në çdo rast thellon pabarazitë ekzistuese"*.¹² Gjatë kësaj, ONP rekomandon që vëmendje e veçantë t'u kushtohet: grave, punëtorëve në ekonominë informale dhe punëtorëve që punojnë punë të përkohshme, punëtorëve të rinj, punëtorëve më të vjetër, refugjatëve dhe punëtorëve migrantë, si dhe mikro-sipërmarrësve dhe të vetëpunësuarve.

Argumentet për një rekomandim të këtillë, janë të shumta, për shembull **gratë**, përfaqësojnë pothuajse 70 % të të punësuarve në sektorin shëndetësor dhe social dhe shpesh janë të parat përgjegjëse për ballafaqim me krizën.¹³ Gjithashtu, gratë janë më të përfaqësuara në sektorin informal të shërbimeve dhe në sektorin e prodhimtarisë intensive, kështu që preken seriozisht nga efektet e krizës ose i ekspozohen rrezikut të lartë shëndetësor.¹⁴ Nga ana tjetër, punëtorët e rinj janë të ndjeshëm ndaj luhatjeve të kërkesës në tregun e punës, ndërsa punëtorët e moshuar kanë mundësi jashtëzakonisht të kufizuara për të gjetur punë të re dhe janë më të ekspozuar ndaj rreziqeve shëndetësore.¹⁵ Së fundmi, mikro-sipërmarrësit dhe të vetëpunësuarit janë kryesisht ata që punojnë në ekonominë informale dhe janë disproporcionalisht më pak të qëndrueshëm ekonomikisht ndaj rreziqeve të krizës shëndetësore dhe pasojave të saj mbi ekonominë dhe tregun e punës.

Sipas nenit 42, paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Punës,¹⁶ punëdhënësi ka detyrimin që punëtorit t'i garantojë kushte të sigurta pune. Duke pasur parasysh këtë dispozitë, pritet që e njëjta të ketë një zbatim më të rreptë në kohë epidemie. Pikërisht për një qasje të tillë, duke ndjekur ligjin për përparimin dhe garantimin e kushteve të sigurta të punës, u vendos edhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjatë kësaj, Qeveria në mbrojtje të punëtorëve, kryesisht rregullonte procesin e punës dhe

¹² "A policy framework for tackling the economic and social impact on workers", Organizata ndërkombëtare e punës, fq.3, në dispozicion në linkun: <https://rb.gy/leqvr6>.

¹³ Dekrete me fuqi ligjore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë gjendjes së jashtëzakonshme – pasqyrë e sistematizuar, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj-Shkup, në dispozicion në linkun vijues: <https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Sistematiziran-pregled-Uredbi-so-zakonska-sila.pdf>.

¹⁴ „Kovid-19 në Maqedoni goditi vendet e punës, nga të papunët shumica janë gra”, Kariera.MK, në dispozicion në linkun vijues: <https://rb.gy/iict8n>.

¹⁵ Dekrete me fuqi ligjore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë gjendjes së jashtëzakonshme – pasqyrë e sistematizuar, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj-Shkup, në dispozicion në linkun vijues: <https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Sistematiziran-pregled-Uredbi-so-zakonska-sila.pdf>.

¹⁶ LMP, neni 42, paragrafi 1: "Punëdhënësi duhet të sigurojë kushte për sigurinë e jetës dhe shëndetin të punëtorëve në përputhje me rregulloret e veçanta për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe të marrë masat e domosdoshme me të cilat garantohet që çdo punëtor është trajnuar mjaftueshëm në përputhje me karakteristikat specifike të punës, duke mbajtur llogari për aftësimin dhe përvojën e tij profesionale."

miratonte rekomandime dhe masa për kategori të caktuara të punëtorëve, si dhe protokolle me të cilat përshtatet ose sigurohet shëndeti publik gjatë procesit të punës.

Për më tepër, sipas Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë,¹⁷ Qeveria dhe punëdhënësi së bashku, kanë për detyrë të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit të punonjësit në procesin e punës. Gjatë kësaj, Qeveria përcakton "*strategjinë për zhvillimin e sigurisë dhe shëndetit në punë në lidhje me mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe aftësisë punuese të punonjësve dhe parandalimin e lëndimeve në punë dhe sëmundjeve profesionale dhe të tjera që lidhen me punën*"¹⁸. Në pajtim me dispozitat dhe rregullat e përcaktuara, punëdhënësi duhet të ndjekë standardet e përcaktuara, si dhe "*t'i ndërmarre masat e nevojshme për sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve*".¹⁹ Duke pasur parasysh përgjegjësitë dhe kompetencat e saj, Qeveria përcaktoi një sërë rekomandimesh²⁰ në lidhje me mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve që ishin të ekspozuar ndaj rrezikut më të lartë nga koronavirusi. Gjatë kësaj, u përfshinë sektorët e mëposhtëm:²¹ 1) punëtorët që punojnë në kapacitetet prodhuese;²² 2) transportuesit që udhëtojnë në vendet me rrezik të mesëm dhe të lartë, gjatë udhëtimit të tyre, si dhe gjatë kthimit të tyre në vend;²³ 3) prodhuesit e ushqimit;²⁴ dhe 4) fermerët.²⁵

Duke vepruar në bazë të propozimeve dhe konkluzioneve të Shtabit kryesor koordinativ të krizës për sigurimin e koordinimit të plotë në lidhje me parandalimin e futjes dhe përhapjes së Koronavirusit COVID-19, në seancën e mbajtur më 12 maj, 2020, Qeveria miratoi Plan për zvogëlimin e masave kufizuese, i cili u realizua në tri faza.²⁶ Fazat e këtij plani nënkuptojnë funksionimin aktual të veprimtarive ekonomike

¹⁷ LSSH, neni 5: "Punëdhënësi ka detyrimin të sigurojë siguri dhe shëndet në punë për punonjësit e tij në çdo aspekt që lidhet me punën. Si pjesë e përgjegjësisë së tij, punëdhënësi duhet të marrë masat e nevojshme për sigurinë dhe shëndetin e punonjësve në punë, duke përfshirë mbrojtjen nga rreziqet profesionale, sigurimin e informatave, trajnimit dhe sigurimin e organizimit përkatës dhe mjetet e duhura. (2) Punëdhënësi ka detyrimin të vendosë masa mbrojtëse dhe të zgjedhë metoda të atilla prodhuese, të cilat do të përmirësojnë nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe do të përfshihen në të gjitha veprimtaritë e punëdhënësit dhe në të gjitha nivelet e organizatës."

¹⁸ LMP, neni 4, paragrafi 2.

¹⁹ LMP, neni 5, paragrafi 1.

²⁰ Rekomandimet që i miratoi Qeveria më së shpeshti kishin të bëjnë me organizimin e procesit të punës, rregullat e mbajtjes së higjienës personale dhe zvogëlimin e kontakteve personale me njerëz të tjerë.

²¹ Rekomandime për vendet e punës, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në linkun vijues: <https://koronavirus.gov.mk/merki>.

²² Rekomandime për sjelljen e të punësuarve në proceset prodhuese, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në linkun vijues: <https://koronavirus.gov.mk/vesti/214845>.

²³ Rekomandime për transportuesit gjatë udhëtimit në vendet me rrezik të mesëm dhe të lartë si dhe kthimit në vend, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në linkun vijues: <https://koronavirus.gov.mk/vesti/214850>.

²⁴ Rekomandime për të punësuarit në kapacitetet prodhuese që prodhojnë prodhime ushqimore dhe therretoret, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut-së, në dispozicion në linkun vijues: <https://koronavirus.gov.mk/vesti/214848>.

²⁵ Rregulla për lëvizjen e fermerëve gjatë ndalesës për lëvizje, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në linkun vijues: <https://koronavirus.gov.mk/vesti/214831>.

²⁶ Procesverbal nga mbledhja e 51-të e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në linkun vijues: <https://vlada.mk/sednica/2020-51>.

në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme të shpallur dhe lëvizjes së kufizuar të popullsisë në të gjithë territorin e vendit me zvogëlim gradual të kohës së ndalimit të lëvizjes. Faza e dytë është në fakt fazë kalimtare e vendosjes fillestare të aktiviteteve të punës duke respektuar masat e rekomanduara dhe protokollet e rrepta për punë në kushtet e parandalimit të paraqitjes dhe përhapjes së COVID-19. Ndërkaq, faza e tretë parashikon një kthim të plotë në procesin e rregullt të punës duke respektuar masat themelore parandaluese, masat kundërepidemike për mbajtjen e higjienës personale dhe distancimit fizik.

Plani përmbante rekomandimet e Komisionit për mbrojtje nga sëmundjet Infektive dhe ishte bazë për 69 protokolle për punë,²⁷ veprimin dhe organizimin e situatave dhe ngjarjeve të ndryshme. Protokollin i parë i referohet masave parandaluese për të gjitha vendet e punës,²⁸ që rekomandon veprime për sigurimin e higjienës së duarve dhe higjienës respiratore, distancimit fizik dhe zvogëlimit të organizimit të udhëtimeve lidhur me punën, pastrimin dhe dezinfektimin e rregullt të vendit të punës, komunikimin dhe edukimin mbi rreziqet dhe sjelljen me personat me COVID-19 dhe kontaktet e tyre.

Përveç rekomandimeve dhe protokolleve për masat parandaluese në vendin e punës, Qeveria miratoi masa të veçanta për të sëmurit kronikë e gratë shtatzëna, për punëtorët e punëtoret që janë me leje lindjeje dhe për prindërit që kanë fëmijë deri në 10 vjeç, si dhe për punëdhënësit.

Masat e veçanta për të sëmurit kronikë dhe gratë shtatzëna, nënkuptonin lirim nga puna për të gjithë ata që do të siguronin vërtetim nga mjeku i familjes se vuajnë nga një prej diagnozave të parapara të gjendjeve kronike, gjegjësisht për të gjitha gratë shtatzëna.²⁹ Këto masa zgjatën deri më 23 shtator 2020, me përjashtim të grave shtatzëna, për të cilat vazhdoi të vlejë mbrojtja e veçantë dhe masat e veçanta³⁰.

Masat e veçanta për punëtorët dhe punëtoret në pushim të lehonisë, nënkuptonin një zgjatje praktike të mungesës me pagesë nga puna. Masa u miratua me Dekret me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për Marrëdhëniet e Punës³¹. Kjo masë zgjati deri më 23 shtator 2020.

²⁷ Pasqyrë e protokolleve që dalin nga Plani për zvogëlimin e masave kufizuese për ndalimin e përhapjes së koronavirusit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në linkun vijues:

<https://vlada.mk/protokoli-koronavirus>.

²⁸ Rekomandime për transportuesit gjatë udhëtimit në vendet me rrezik të mesëm dhe të lartë si dhe kthimit në vend, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në linkun vijues:

<https://koronavirus.gov.mk/vesti/214850>.

²⁹ Procesverbal nga mbledhja e 17-të e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në linkun vijues: <https://vlada.mk/node/20489>.

³⁰ Masa për lirim nga puna për personat e sëmurë kronikë, gratë shtatzëna, prindërit e vetëm dhe kategoritë tjera të prekshme të qytetarëve, vazhdon të vlejë, Ministria për punë dhe politikë sociale, në dispozicion në linkun vijues: https://www.mtsp.gov.mk/covid-19-ns_article-mtsp-merkata-za-osloboduvanje-od-rabota-na-hronicno-bolnite-lica-bremenite-zeni-samohranite-roditeli.nsp.x.

³¹ Dekret me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për marrëdhënie pune, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 113/2020, në dispozicion në linkun vijues: <https://rb.gv/rn0dh5>.

Masat e veçanta për prindërit me fëmijë deri në 10 vjeç, kishin të bëjnë vetëm me të punësuarit në sektorin publik dhe nënkuptonin që ata do të lirohen nga puna për shkak të ndërprerjes së procesit edukativo-arsimor. Njëkohësisht, Qeveria rekomandoi që masa të merret edhe nga sektori privat³². Kjo masë zgjati deri më 23 shtator, 2020.

Më në fund, masat e veçanta për punëdhënësit i referoheshin organizimit të procesit të punës, kur Qeveria u rekomandoi të gjithë punëdhënësve, përkatësisht çdo personi udhëheqës të institucionit, të organizojë punën e personave të punësuar, përmes institutit "punë nga shtëpia".³³

Të gjitha masat kishin për qëllim të parandalonjë përhapjen e virusit, të mbrojnë kategoritë e caktuara të prekshme të qytetarëve dhe të garantojnë se ata do të vazhdojnë të punojnë. Masat kishin për qëllim gjithashtu të garantojnë se ekonomia do të vazhdonte të zhvillohej, megjithëse parashikonin detyrime për punëdhënësit. Përgjegjësi e punëdhënësve ishte të përcaktonin "koordinatorë për COVID-19", që buronte nga udhëzuesi i ONP për punëdhënësit, për menaxhim në vendin e punës gjatë COVID. Detyra kryesore e koordinatorit është të informohet për masat e vendosura dhe rekomandimet e dhëna si dhe të sigurojë rregullisht informacione të azhurnuara, të besueshme për punonjësit, furnizuesit dhe klientët. Gjithashtu, detyrë e koordinatorit është të studiojë dhe më pas të sqarojë dhe komunikojë procedurat dhe politikat e ndërmarrjes, duke përfshirë edhe ato për organizimin fleksibël të punës, punën nga shtëpia, mungesën, pushimin mjekësor, pushimin vjetor, etj."³⁴

2. ANALIZË E EFIKASITETIT TË ZBATIMIT TË MASAVE

Pavarësisht të gjitha përpjekjeve për të organizuar procesin e punës dhe për të mbrojtur kategoritë e prekshme të punëtorëve, lajmet për pushim nga puna të punëtorëve,³⁵ për punëtorë me fëmijë deri në 10 vjet të cilët nuk janë liruar nga puna, për punëtorë të sëmurë kronikë që kanë qenë të detyruar të shkojnë në punë, për

³²Procesverbal nga mbledhja e 15-të e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në linkun vijues: https://vlada.mk/sites/default/files/zakluchoci_covid-19.pdf.

³³Procesverbal nga mbledhja e 19-të e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në linkun vijues: <https://rb.gy/ixut1j>.

³⁴Udhëzues për punëdhënësit për udhëheqje në kohën e KOVID-19, Organizata ndërkombëtare e punës, në dispozicion në linkun vijues: shorturl.at/gjqH4.


³⁵Në tremujorin e dytë, shkalla e papunësisë ishte 16,7 %, Suzi Koteva-Stoimenova, Agjencia informative maqedonase, në dispozicion në linkun vijues: <https://mia.mk/vo-vtoriot-kvartal-stapkata-na-nevrabotenost-16-7-otsto/>.

punëtorë të sëmurë në industrinë e tekstilit për shkak të mosrespektimit të rekomandimeve për mbrojtje në vendin e punës dhe të ngjashme, vazhduan.

Në përgjithësi, masat dhe rekomandimet e Qeverisë që u miratuan në periudhën pas 11 marsit, mund të ndahen në tri kategori:

1. masa dhe rekomandime që synonin të mundësojnë funksionimin normal të ekonomisë në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme dhe krizës shëndetësore;
2. masa që kanë / kishin për qëllim mbrojtjen e punonjësit në vendin e punës dhe organizimin e procesit të punës; dhe
3. masa që u krijuan si lehtësime financiare dhe subvencione për të zbutur pasojat negative financiare për qytetarin dhe ekonominë në përgjithësi.


Efikasitetin e të gjitha masave të miratuara nga Qeveria, për qëllimin e kësaj analize, do ta masim përmes dy parametrave. I pari është numri i qytetarëve, punësimi i të cilëve u ndërpre në periudhën prej marsit deri në dhjetor 2020. Gjatë hartimit të raportit jemi nisur nga ajo se marrëdhënia e punës këtyre personave u është ndërprerë si rezultat i krizës shëndetësore. I dyti është nëpërmjet të ndjekjes së rolit proaktiv të shtetit për të mbrojtur punëtorët, matur përmes inspektimeve të punëdhënësve. Së fundmi, parametër shtesë është këqyrja dhe monitorimi i zbatimit të masave ekonomike për menaxhimin me krizën si dhe numri i aplikimeve për ndihmë financiare, numri i kërkesave të aprovuara, përfshirja e të njëjtave dhe shuma e ndihmës së dhënë.



Grafiku 1. Përmbledhje e numrit të të papunëve në periudhën 16 mars - 18 shtator 2020 në sektorët e interesit dhe në sektorë të tjerë.

Sipas Agjencisë së Punësimit, nga 18 marsi 2020 deri më 18 shtator 2020, është regjistruar ndërprerje e marrëdhënies së punës, pra ndërprerje e sigurimit të detyrueshëm social për 11,478 persona, nga të cilët 4,261 persona janë nga industria përpunuese, kurse prej tyre 1,403 nga sektori i prodhimit të tekstilit dhe veshjeve dhe 957 në sektorin për veprimtari të objekteve për akomodim dhe objekte shërbimi për ushqim.³⁶

Duhet të merret parasysh se këto janë të dhëna për punëtorët në ekonominë formale, kurse është edhe një numër i madh i punëtorëve që humbën punën dhe ishin pjesë e ekonomisë informale. Pasojat e krizës shëndetësore më së shumti mund të vërehen me rritjen e numrit të të papunëve në vitin 2020, nga marsi deri në tetor, për më së paku 49,390 persona.³⁷ Ndryshe nga viti 2020, viti 2019 shënon trend të qëndrueshëm të numrit të personave të papunë, përkatësisht nga 105,658 në janar 2019, në dhjetor 2019 ulet në 101,748, në janar 2020 është 104,409, që në dhjetor 2020 të arrijë 156,432 persona të papunë.



Grafiku 2. Lëvizja e numrit të personave të papunë në periudhën janar 2019 deri në dhjetor 2020, për fillimin dhe fundin e çdo viti.

Gjatë pandemisë, me masat e shtuara dhe rekomandimet e Qeverisë për siguri në punë, ekzistonte / ekziston mundësia për shkelje të shtuar të të drejtave të punëtorëve, kurse për të zvogëluar mundësitë për abuzime dhe shkelje, shteti duhej të bënte veprime të intensifikuara kontrolli. Sipas Inspektoratit Shtetëror të Punës, një total prej 15,078 inspektimesh u kryen midis 18 marsit dhe 18 shtatorit 2020, ose një mesatare prej 742 inspektimesh në ditë (një total prej 155 ditësh, përfshirë të shtunën dhe të dielën). Gjatë kësaj, janë shqiptuar 394 vendime për shkelje, që paraqet 2.6% të mbikëqyrjeve totale të kryera, e që përfunduan me ndonjë vendim³⁸.

³⁶ Vendim për qasje në informata të karakterit publik nr. 2747/2.

³⁷ Burim Agjencia për punësim e RMV, të dhënat në dispozicion në linkun vijues: <https://bit.ly/2Y0dZal>.

³⁸ Përgjigje lidhur me kërkesën për qasje në informata të karakterit publik nga Ministria për punë dhe politikë sociale.

Keqpërdorime u vunë re edhe në zbatimin e masave ekonomike për pagesën e pagave për punëtorët. Masa për ndihmë direkte për pagat, kishte për qëllim parandalimin e largimit nga puna të punëtorëve dhe mbajtjen e vendeve të punës, dhe megjithëse iu dha drejtpërsëdrejti kompanive, kishte për qëllim të përfundojë në llogari të më të prekurve, pra punëtorëve. Sidoqoftë, lajmet që ndihmën e dhënë, punëdhënësit nuk ua kanë paguar punëtorëve, nuk kishin të sosur.³⁹ Sipas Drejtorisë për të ardhura publike "Me datë 2 shkurt 2021, 13,160 punëdhënësve u janë paguar gjithsej 961,709,306.00 denarë për t'ua paguar pagën e dhjetorit 60,974 të punësuarve. Prej tyre, 306 punëdhënës mbështetjen financiare të pranuar, që kap vlerën e 16,305,020.00 denarësh, për 992 të punësuar, nuk ua kanë paguar punëtorëve".⁴⁰ Këto janë lajmet për keqpërdorimet e pakos së katërt të masave, por keqpërdorimet e këtilla ndodhin nga pagesa e kësaj mase si pjesë e pakos së parë.

Mbikëqyrje COVID 19						
Muajt	Numri i mbikëqyrjeve	Numri i përgjithshëm i të punësuarve në kompanitë nën mbikëqyrje	Numri i punëtorëve që mun gojnë në bazë - fëmijë deri në 10 vjeç dhe nënë e vetme	Numri i punëtorëve që mun gojnë në bazë të sëmundjeve kronike	Numri i atyre që mun gojnë në bazë gra shtatzëna	Vendim
Mars	2,506	170,467	4,488	1,862	746	34
Prill	2,925	73,653	2,059	1,051	326	53
Maj	2,536	46,114	818	345	265	42
Qershor	2,857	56,795	1,655	859	264	85
Korrik	1,842	33,319	330	244	127	76

³⁹"Masa prej 14,500.00 denarë i mbajti punëtorët, por disa nuk morën paga, paratë përfunduan tek punëdhënësit, do të pasojnë sanksione", Suzi Koteva-Stoimenova, Agjencia Informativ e Maqedonisë, në dispozicion në linkun: https://www.mtsp.gov.mk/covid-19-ns_article-mtsp-merkata-za-osloboduvanje-od-rabota-na-hronicno-bolnite-lica-bremenite-zeni-samohranite-roditeli.nsp

⁴⁰„Analizë për shfrytëzimin e masës mbështetje financiare për pagesën e pagave të të punësuarve“, Drejtoria e të ardhurave publike, në dispozicion në linkun vijues: <http://www.ujp.gov.mk/mk/javnost/soopstenija/pogledni/844>.

Gusht	1,373	113,158	902	686	69	58
Shtator (1-18)	1,039	10,627	11	4	22	46
Gjithsej	15,078	504,133	10,263	5,051	1819	394

Për të shmangur abuzime të tilla në të ardhmen, është e nevojshme që Drejtoria e të ardhurave publike, mjetet t'i paguajë direkt në llogaritë e transaksioneve të punonjësve. Për momentin, për të parandaluar abuzime të tilla, zbatohet masa e vërejtjes, pastaj sanksionimi dhe si mjet i fundit, përgjegjësi penale për shkelësit. Kështu, Drejtoria e të ardhurave publike fillimisht paraqet vërejtje për pagë të papaguar dhe pas skadimit të vërejtjes, zbatohet procedura e pagesës së pagës me forcë, duke bllokuar fondet në llogaritë e tyre të transaksionit dhe transferimin e mjeteve në llogaritë e personave të punësuar dhe në llogaritë e pagesave për të ardhurat publike. Për ata të cilët nuk i kanë paguar pagat, kurse kanë shfrytëzuar subvencione nga pakoja e parë, gjegjësisht pagat për prill, maj ose qershor, Drejtoria e të hyrave publike ka dorëzuar të dhëna të hollësishme në Prokurorinë Publike, për të filluar procedurat penale, dhe tek të njëjtit janë kryer kontrole në koordinim me Inspektoratin Shtetëror të Punës. Serioziteti i luftës kundër abuzimeve të tilla do të dëshmohej me vendim të prerë të gjykatave dhe veprimin e Prokurorisë Publike në këto lëndë.

Gjatë pandemisë dhe për nevojat e mbrojtjes së punëtorëve, Qeveria vendosi masat për "shpëtim të vendeve të punës" përmes të cilave ishte paraparë pagesa prej 14,500,00 denarësh në muaj, si pagë minimale për punëtorët dhe mbulim deri në 50% të kontributeve. Në këtë kategori ishte paraparë edhe mbështetje financiare për personat fizikë që kryejnë veprimtari të pavarur, si dhe për punonjësit në kompani në sektorët e turizmit, transportit dhe hotelierisë. Këto ishin masat 1 (*Shteti shpëton vende pune, 14,500 denarë në muaj për punonjës për prill dhe maj, për kompanitë e prekura nga kriza ose 50% të kostos së kontributeve për secilin punonjës*), 20 (*mbështetje financiare për muajt prill dhe maj 2020 në vlerë prej 14,500 denarë në muaj për persona fizikë që kryejnë veprimtari të pavarur*), 21 (*Subvencionim të 50% të kontributeve për të punësuarit në kompani të sektorëve të turizmit, transportit dhe hotelierisë dhe ndërmarrjeve të tjera të prekura nga virusi korona*) dhe 26 (*Mbështetje për pagesën e pagave, e cila vazhdon të jetë e vlefshme edhe për tremujorin e fundit të vitit, përkatësisht për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor*). Me katër masat, gjithsej u përfshinë 464,048 të punësuar dhe persona që kryejnë veprimtari të pavarur, ndërsa ndihma e dhënë arriti një total prej 5,145,866,715.00 denarë ose përafërsisht 84 milion euro. Kjo praktikisht do të thotë që secili nga të punësuarit ose vetëpunësuarit që ishin përfshirë në këto katër masa, ka marrë përafërsisht 180 euro, ose 11,089.00 denarë.

Masa 1 - Shteti shpëton vende pune, 14,500 denarë në muaj për punonjës për prill dhe maj , për kompanitë e prekura nga kriza ose 50 % të kostos së kontributeve për çdo punonjës⁴¹

Periudha	Numri i kërkesave të aprovuara KNF-PP	Kërkesa të TP që morrën mbështetje financiare	Numri i të punësuarve që shfrytëzuan mbështetje financiare	Shuma e mbështetjes financiare
Prill 2020	21.363	19.826	128.165	1.796.282.702,00
Maj 2020	21.087	19.999	119.114	1.671.755.264,00
Qershor 2020	19.235	18.172	101.585	1.420.066.089,00

Masa 20 - Mbështetje financiare për muajt prill dhe maj 2020 në vlerë prej 14,500 denarë në muaj për personat fizikë që kryejnë veprimtari të pavarur⁴²

Periudha	Numri i KMF-PVP për NF të paguar personave me veprimtari të pavarur	Shuma
Prill 2020	5818	84.361.000,00
Maj 2020	6022	87.319.000,00
Qershor 2020	5964	8.647.800,00

⁴¹ Drejtoria e të hyrave publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vendim nr.02-6911/2.

⁴² Drejtoria e të hyrave publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vendim nr.02-842/1.

Masa 21 - Subvencionim i 50% të kontributeve për punonjësit në kompani nga sektorët e turizmit, transportit dhe hotelierisë dhe ndërmarrjeve të tjera të prekura nga virusi korona⁴³

Periudha	Numri i kërkesave të aprovuara KNF-PP	Numri i TP nga urdhëresat e dorëzuara në MPPS për pagesë të subvencioneve	Numri i të punësuarve për të cilët është shfrytëzuar subvencionim i kontributeve	Shuma e kontributeve të subvencionuara
Prill 2020	2.532	1.652	11.669	36.608.376,00
Maj 2020	2.465	1.868	12.915	40.822.665,00
Qershor 2020	2.137	1.655	12.096	38.198.174,00

Masa 26 - Mbështetje për pagesën e pagave, që vazhdon të vlejë edhe për tremujorin e fundit të vitit, dmth për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor⁴⁴

Periudha	Numri i KNF-PP të aprovuara	Numri i TP që morrën mbështetje financiare	Numri i të punësuarve që shfrytëzuan mbështetje financiare	Shuma e mbështetjes financiare
Tetor 2020	13.796	12.368	60.700	945.210.474,00

Me qëllim të ngjashëm, Qeveria ka vendosur edhe masat 31 (*Rimbursimi i taksës turistike për vitin 2019, për të mbështetur sektorin e turizmit, si një nga më të prekurit në krizë*), 32 (*Grante për agjencitë turistike prej 3,000.00 deri në 7,000.00 euro*), 34 (*Grante për restorantet e dasmave*) dhe 36 (*Grante për këndet e lojërave për fëmijë*). Gjegjësisht, sektori i turizmit dhe hotelierisë me vendkalimet e mbyllura kufitare, numrin e zvogëluar të udhëtimeve lokale, ndalimet e grupimit dhe orën policore, përjetoi vitin e tij më të vështirë. Prandaj, masat e Qeverisë duheshin t'u ndihmojnë punëdhënësve në këto sektorë dhe në të njëjtën kohë të garantojnë që shfrytëzuesit e fundit, dmth. punëtorët në sektorë do të jenë në gjendje t'i ruajnë vendet e punës. Sipas të dhënave në dispozicion dhe përgjigjes nga Ministria e Ekonomisë, për shfrytëzimin e masave,

⁴³ Drejtoria e të hyrave publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vendim nr. 02-6903/2.

⁴⁴ Drejtoria e të hyrave publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vendim nr. 02-6906/2.

nga 109 të paraqitur, vetëm 78 udhërrëfyes turistikë morën mbështetje për pagën. 31 aplikantët tjerë, nuk i kanë plotësuar kushtet e parapara.

Masa 30 - Mbështetje me paga për guidat turistike

Aplikuan	Fituan
109	78

Përmes masave të tjera të këtij grupi, sipas informacionit të Ministrisë së Ekonomisë, janë përfshirë 1403 punonjës në 409 subjekte afariste. Ndihma totale e dhënë në grante për agjencitë turistike, restorantet e dasmave dhe këndet e lojërave për fëmijë është 148,420,000.00 denarë ose përafërsisht 2.5 milion euro. Një fakt interesant është se me ndihmën e ndarë financiare për 81 këndet e lojërave për fëmijë, ishin përfshirë vetëm 3 punonjës.

Masa 32 - Grante për agjencitë turistike prej 3.000 deri në 7.000 euro:

	Aplikuan	Fituan
	339	276
Sa të punësuar ka përfshirë kjo masë?		1000 të punësuar
Sa mjete u ndanë		79.690.000,00 denarë

Masa 34 - Grante për restorantet për dasma:

	Aplikuan	Fituan
	238	133
Sa të punësuar ka përfshirë kjo masë?		400 вработени
Sa mjete u ndanë		55.440.000,00 денари

Masa 36 - Grante për këndet e lojërave për fëmijë:

	Aplikuan	Fituan
	119	81
Sa të punësuar ka përfshirë kjo masë?		3 të punësuar
Sa mjete u ndanë		13.290.000,00 denarë

Artistët e pavarur ishin edhe një nga kategoritë e punonjësve të cilët vështirë e përjetuan pandeminë dhe masat kufizuese. Në mbështetje të tyre, Qeveria miratoi masën 3, përmes së cilës për artistët e estradës, filmit dhe kulturës ishte paraparë ndihmë në vlerë prej 2 pagave minimale bruto ose 21,776.00 denarë. Qeveria vlerësoi

se me këtë masë do të përfshihen 731 person, por sipas të dhënave të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë dhe Ministrisë së Kulturës, aplikuan gjithsej 487 persona, kurse ndihmë morrën vetëm 122 persona⁴⁵.

Masa 3 - Ndihmë për artistët

	Aplikuan	Fituan
Artistë të estradës	379	58
Artistët e filmit	87	61
Artistët e kulturës	21	3

Secila prej masave të përpunuara deri më tani tregon se përfshirja e paraparë dhe kërkesat e paraqitura për ndihmë financiare tregojnë një mospërputhje të madhe. Të mos flasim për atë se sa ka qenë përfshirja reale ose kërkesat e përgjigjura pozitivisht. Disproporcionalisht i vogël është numri i punëtorëve që kanë qenë të përfshirë me këto masa, në llogari të përfshirjes paraprakisht të planifikuar. Nëse kësaj i shtojmë informatat në lidhje me keqpërdorimet e ndihmës së marrë, rezulton se ndihma më e mirë ishte ajo e masës 4 (Kompensim në të holla për qytetarët që ngelën pa punë për shkak të krizës, në pajtim me përvojën e punës), ku për përfshirjen e paraparë (11 mars - 30 Prill), aplikuan 3,794 persona, kurse ndihmë morrën 3,123 persona⁴⁶. Kjo në të vërtetë do të thotë se përgjigje pozitive janë dhënë në 82 % të kërkesave të paraqitura. Megjithatë, më e sukseshmja, të paktën në përfshirje, ishte masa 27 (*Kartat e pagesave për konsum më të lartë dhe për zhvillim të veprimtarive vendase ekonomike*), ku 283,000 qytetarë ndanë 27.6 milionë euro.⁴⁷

Nuk guxojnë të ndodhin keqpërdorime, kurse shkelja e të drejtave të punëtorëve nuk guxon të mbetet e pandëshkuar. Prandaj, veprimi i shtetit gjatë mbikëqyrjes intensive është plotësisht i justifikuar. Sigurisht, shteti duhet të veprojë edhe në mënyrë preventive, pra me masa aktive të kontribuojë në ruajtjen e vendeve të punës, ruajtjen e shëndetit të punëtorëve dhe garantimin e të drejtave të njeriut, në këtë rast nga korpusi i marrëdhënieve të punës.

3. ANALIZA E IMPLIKACIONEVE FINANCIARE NGA MASAT DHE PAKOT PËR BALLAFAQIM ME KRIZËN

Pandemia kishte efekte jashtëzakonisht negative në ekonomi, me aktivitetin e zvogëluar ekonomik që çoi në ndryshime në tregun e punës, ulje të ofertës, kërkesës dhe prodhimit të mallrave dhe shërbimeve, ulje të investimeve, por edhe ulje të konsumit etj. Efektet e pandemisë do të jenë afatgjata dhe largpërfshirëse, do të bëjnë ndryshime strukturore dhe përshtatje në tregun e punës dhe ekonominë, ofertën dhe

⁴⁵ Sekretariati i përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, vendim nr: 49-11183/2.

⁴⁶ Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut, vendim nr.: 03-3439/2.

⁴⁷ Sekretariati i përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, vendim nr.: 49-11182/2.

kërkesën, prodhimin e mallrave dhe shërbimeve etj. Disa nga pasojat mund të mos jenë ende të dukshme, por ato mund të supozohen. Masat kufizuese, si gjendja e shpallur e jashtëzakonshme, izolimi social, ora policore, zvogëlimi i udhëtimeve zyrtare dhe private, pasiguria e përgjithshme, si dhe pasiguria e investimeve, fuqia e zvogëluar blerëse e qytetarëve, janë vetëm disa nga arsyet e ngadalësimit të ekonomisë në Maqedoninë e Veriut, por edhe në nivel global. Sigurisht, kriza financiare nuk ka prekur të gjithë sektorët në mënyrë të barabartë. Disa sektorë janë shumë më të prekur se të tjerët, dhe sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, në Maqedoninë e Veriut, sektorët më të prekur do të jenë: tregtia me shumicë dhe pakicë, hotelieria, turizmi, arti, argëtimi dhe rekreacioni.⁴⁸

Ngadalësimi i ekonomisë sigurisht që nuk do të jetë fundi i pasojave të krizës. Shumë më e frikshme do të jetë rritja e varfërisë që na pret.⁴⁹ Simulimet e Bankës Botërore parashikojnë se shkalla e varfërisë do të rritet nga përafërsisht 17% në vitin 2019, në rreth 20-23% në vitin 2020.

Në numra absolutë, kjo do të thotë se numri i personave që jetojnë nën pragun e varfërisë do të shënojë rritje prej 55.000 deri në mbi 130.000 qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sigurisht, parashikimet e tilla të Bankës Botërore marrin parasysh kohëzgjatjen e periudhës gjatë së cilës po kalojmë krizën dhe a do të zgjasë ajo një, dy apo tre tremujorë.⁵⁰

⁴⁸ „Ndikimi ekonomik dhe social i Kovid 19 – Varfëria dhe mirëqenia e amvisërive, Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor, World Bank Group, fq.13 tabela A1, në dispozicion në linkun: <http://pubdocs.worldbank.org/en/419241590709526138/WRER17-08-Poverty-%D0%9C%D0%9A.pdf>.

⁴⁹ Maqedonisë i kërcënohet rreziku nga rritja e varfërisë për shkak të Kovid-19, Evropa e lirë, në dispozicion në linkun: <https://rb.gy/oqfncf>.

⁵⁰ Procesverbal nga mbledhja e 17-të e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, fq.11.

Në mënyrë që të zvogëlojë efektet negative të COVID-19 në ekonomi, dhe kështu të parandalojë rritjen e mëtejshme të papunësisë dhe varfërisë, Qeveria miratoi 4 pako masash ose gjithsej 57 masa ⁵¹, të grupuara në pesë kategori:


1. Mbështetje financiare për qytetarët;
2. Mbështetje e drejtpërdrejtë për ekonominë maqedonase - për inovacion dhe zhvillim, për ruajtjen e vendeve ekzistuese dhe për vende të reja të punës ;
3. Mbështetje për fermerët;
4. Mbështetje direkte për personat pa punë - për sportistët, për artistët dhe udhërrëfyesit turistikë dhe
5. Lehtësime të taksave dhe shtyrje të borxheve.

Sipas të dhënave zyrtare ⁵², katër pakot peshojnë gjithsej 1.02 miliardë euro, nga të cilat midis 200 dhe 500 milionë euro janë pakoja e parë dhe e dytë, 335 milion euro është pakoja e tretë, kurse pakoja e katërt peshon 470 milion euro. Por, mbetet e hapur pyetja se sa është shfytëzimi i katër pakove dhe sa këto masa do të arrijnë efektin e dëshiruar.

Në kategorinë e parë të masave, ishte planifikuar të lëshohen karta pagese për qytetarët, në mënyrë që të rritet konsumi dhe të zhvillohet ekonomia vendore. Kartat e pagesave ishin në vlerë prej 6,000 denarë. Kartat i morrën 5,726 prindër të vetëm, 85,108 të papunë dhe 520 artistë të pavarur të filmit, kulturës dhe të estradës. Ndihmë të këtillë morrën edhe 540 studentë, të cilët fillimisht u përjashtuan, si dhe 182,271 pensionistë me pension deri në 15,000 denarë.

⁵¹ <https://vlada.mk/ekonomski-merki-covid19>.

⁵² Masa ekonomike për ballafaqim me pasojat e Kovid-19:
<https://koronavirus.gov.mk/merki/ekonomski-merki>.



Grafiku 3. Përmbledhje e numrit të kartave të lëshuara të pagesave për secilën nga kategoritë e qytetarëve

Studentët dhe nxënësit morrën edhe ndihmë shtesë në mbështetje të standardit të studentëve dhe nxënësve, në vlerë prej 44 milion denarësh. Me këtë rast, si përfitues të masës së fundit u paraqitën 884 studentë dhe 347 nxënës. Ndihmë morrën edhe qytetarët mbi 64 vjeç, që nuk kanë pension e as pension social shtetëror dhe kanë të ardhura më të ulëta se 15,000 denarë ose nuk kanë fare të ardhura. Një masë e ngjashme ishte paraparë edhe për të gjithë qytetarët e punësuar, të cilët në periudhën janar - prill 2020 nuk kishin realizuar të ardhura totale të pagës neto dhe shtesa të pagave më të mëdha se 60,000 denarë, sipas të dhënave të Drejtorisë për të hyra publike. Për të përforcuar turizmin e vendit, dhe si një mbështetje për qytetarët, u përcaktua masa e kuponit të turizmit. Kuponi mund të përdorej në hotelet vendase dhe objektet e tjera të akomodimit. Me këtë masë u përfshinë rreth 115,000 qytetarë, kurse vlera totale ishte caktuar në 16 milion euro. Mbështetje iu dha punësimit të të rinjve, në mënyrë që të fitojnë njohuri dhe aftësi të reja në teknologjinë informatike dhe aftësi të ngjashme. Me anë të masave u mbuluan kostot e trajnimit deri në shumën maksimale prej 30,000 denarësh. Masa përfshiu midis 7,000 dhe 10,000 të rinj nën 29 vjeç dhe kishte një vlerë totale prej 3 milion eurosh. Në këtë kategori, si dhe për të mbështetur prodhimin e brendshëm, ishte parashikuar masa **"fundjavë pa TVSH"**, e cila përfshiu më shumë se 350,000 qytetarë, përdorues të aplikacionit **"MojDDV"**. Qeveria parashikoi një xhiro prej 170 milion eurosh, mjete që do të ishin një injeksion për ekonominë, ndërsa rreth 17 milion euro do t'u ktheheshin qytetarëve përmes rimbursimeve të TVSH-së. Rezultati për këtë masë tregoi se përgjatë tri ditëve, 204,088

qytetarë realizuan një qarkullim në vlerë prej 558,176,715.00 denarë, ose përafërsisht 9 milionë euro dhe u kthyen 66.853.929,00 denarë, ose përafërsisht 1 milionë euro.⁵³

Çdo qytetar i cili ka skanuar faturat, ka shpenzuar mesatarisht nga 44,5 euro, kurse ka marrë si rimbursim mesatarisht nga 5,50 euro.

Së fundmi, kategoria iu përgjigj edhe atyre që ishin më të prekur gjatë pandemisë, mjekët dhe personeli tjetër mjekësor në klinikat dhe departamentet e sëmundjeve infektive, institutet dhe qendrat e shëndetit publik, si dhe në ndihmën e shpejtë mjekësore, për të cilin kategori u vendos një shpërblim prej 40% nga rroga bazë.

Kategoria e dytë parashikonte disa masa për ndihmë të drejtpërsëdrejtë në ekonomi. Fillimisht, u parapa një linjë kredie pa interes, në vlerë 31 milion euro për ndërmarrjet mikro dhe të vogla. Ajo gjithashtu ofroi edhe fonde të pakthyeshme në shumën deri në 31% të shumës totale të përcaktuar, për kompanitë që drejtohen ose janë themeluar nga gratë, që punësojnë persona të rinj dhe janë të orientuara nga eksporti ose inkorporojnë inovacion dhe dixhitalizim në punën e tyre. Në këtë drejtim, si mbështetje kompanive për qasje më të lehtë në mjete finaciare, Qeveria krijoi një garanci shtetërore kreditore në vlerë prej 10 milion euro, që mundëson qasje në 65 milion euro shtesë, kurse u caktua edhe garanci doganore për sigurimin e borxhit doganor dhe mbështetje eksportit dhe importit. Gjithashtu, 25 milion euro ndihmë financiare u siguruan përmes programit për forcimin e konkurrencës në industri, kurse ndihma u siguroa edhe për ato industri që do të krijojnë platformë në të cilën do të mund t'i plasojnë produktet e tyre në tregje të reja, si dhe për ata që do të zhvillojnë produkte inovative. Në këtë mbështetje ishin të përfshirë Banka e zhvillimit dhe Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik, ndërsa fshati turistik maqedonas Nerezi i Shkupit u shndërrua në një fshat maqedonas START AP. Në këtë kategori u përfshi edhe mbështetja për turizmin vendor, nëpërmjet të subvencionimit të organizimit të ngjarjeve, trajnimeve, seminareve, konferencave dhe të ngjashme në kapacitetet turistike vendase. Nga kjo kategori u zhvillua mbështetja për ekonominë përmes pagesës së pagave. Gjatë krizës, masa u ndryshua dhe risi ishte përcaktimi gradual i pagesave të mbështetjes.

⁵³ „DAP: „Fundjava pa TVSH e suksesshme“ Republika.mk, në dispozicion në linkun: <https://republika.mk/vesti/ekonomija/ujp-vikendot-bez-ddv-uspeshen/>

Me këtë masë, sipas metodologjisë së re u mbështetën **250.000** paga për vende pune. Vlera e përgjithshme e kësaj mase kap shifrën **70 milionë euro**, kurse kushti ishte që kompanitë që do të aplikojnë ta mbajnë numrin e të punësuarve që e kanë pasur me datë 31 korrik 2020.

Në drejtim të ngjashëm po lëvizin edhe masat e linjave kreditore COVID 1 dhe COVID 2, me një vlerë totale prej 12.7 milion euro, në mbështetje të veprimtarive që nuk mund të punojnë për shkak të krizës dhe masave mbrojtëse, si dhe linja e kredisë për kapital të ri në mbështetje të projekteve të reja, punësimeve të reja dhe rritjes së likuiditetit të ekonomisë. Në mbështetje të turizmit dhe hotelierisë, masat në këtë kategori parashikuan rimbursim të taksës turistike për vitin 2019, si dhe grante me të cilat janë përfshirë afërsisht 500 agjenci turistike, grante për restorantet për dasma si dhe mbështetje për rreth 120 diskoteka dhe klube të natës, si dhe për rreth 7000 transportues, përmes vazhimit të licencës për vitin 2021, pa kompensim. Në këtë kategori përfitues janë 9,360 kontabilistë të regjistruar, për të cilët në vitin 2020 nuk do të vlejë kushti për mbledhjen e pikëve nga përsosja e vazhdueshme profesionale, për vazhdimin e licencës.

Në mbështetje të bujqësisë, në kategorinë e tretë të masave u caktuan më shumë aspekte, në të cilat shteti mund të ofrojë ndihmë për këtë kategori të qytetarëve tanë. Fillimisht, me 5 milion euro kredi të volitshme, përmes Bankës së zhvillimit, u mbështetën ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme që kryejnë prodhimtari primare, përpunuese dhe eksport të produkteve primare dhe të përpunuara bujqësore, kurse me 3 milionë euro u ndihmuan kantinat familjare të verës dhe fermat. Me anë të kredisë së Bankës Botërore, në shumë prej 50 milionë eurosh, u mundësua modernizimi i bujqësisë maqedonase, me qëllim rritjen e konkurrencës dhe përfitimit. Si pjesë e masave, u shfytëzua edhe subvencionimi në konsumin e vajit të gjelbër, ku u ndihmuan 50,000 fermerë. Në këtë kategori, u stimuluan përpunuesit e rrushit dhe kantinat për prodhimin e distilatit alkoolik, kurse u siguria mbështetje edhe për blerjen e rrushit nga të rekolta e vitit 2020. Ndihmë u siguria edhe për modernizimin dhe vënien në funksion të kapaciteteve për prodhimin e produkteve të duhanit dhe përpunim të rrushit, me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të sektorit të vreshtarisë dhe duhanit, si degë bujqësore që po eksportojnë gjithnjë e më shumë. Nëpërmjet të kësaj kategorie, ishte paraparë dhe përkrahur dhënia me qira e kullotave për një afat më të gjatë, me çka blegtorët marrin në dispozicion rreth 500,000 hektarë kullota.

Në përpjekjet që të mos anashkalohet askush, në kategorinë e katërt të masave u siguria ndihmë për të gjithë ata që humbën punën nga 11 marsi deri më 30 prill 2020. Kjo masë është mbase më e rëndësishmja për punëtorët / punëtoret, sepse ndikon

drejtpërsëdrejti në kategorinë më të prekshme të qytetarëve / qytetareve që u goditën drejtpërsëdrejti nga kriza dhe ngelën pa punë. Shuma e kompensimit mujor në të holla gjatë papunësisë u përcaktua në bazë të pagave të llogaritura dhe të paguara të punëdhënësi dhe është 50% e pagës mesatare mujore neto të punonjësit për 24 muajt e fundit, për një person që ka të drejtë në kompensim në të holla deri në 12 muajt. Asistenca e marrë nuk mund të jetë më e lartë se 80% e pagës mesatare mujore neto të punonjësit e shpallur për muajin e fundit. Në këtë kategori, u sigurua ndihmë për të gjitha klubet sportive që kanë të regjistruar më së paku 15 sportistë të rinj nën 18 vjeç në sportet individuale, përkatësisht më së paku 50 sportistë të rinj nën 18 vjeç në sportet në ekip. Gjithashtu në këtë kategori, për 141 artistë të pavarur u sigurua paga minimale për muajt prill dhe maj, si dhe kontributet. Në këtë kategori, 150 udhërrëfyes turistikë të regjistruar morrën pagë minimale bruto, si ndihmë për periudhën e krizës.

Si ndihmë e përgjithshme për qytetarët, në kategorinë e pestë, ishte paraparë shtyrje për 3 deri në 6 muaj e pagesës së kësteve të kredive, ngrirje ose grejs periudhë për pagesën e kredive, etj. Gjithashtu u mundësua shtyrja e pagesës së qirasë për banesat sociale, kurse u shty, përkatësisht u pezullua deri në fund të qershorit, edhe ligji i përmbarimit. Në këtë kategori, u vendos që të shtyhet edhe pagesa e paradhënies të tatimit mbi fitimin deri në mars 2021, për kompanitë që kanë rënie të të ardhurave prej më shumë se 40%. Shkalla e TVSH-së për shërbimet e restoranteve dhe të ushqimit e pijeve u ul në 10%.

I. Pakoja e parë ekonomike

Pakoja e parë e masave ekonomike u miratua më 18 mars të vitit 2020, pra në ditën e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në vend. Duke ditur pozicionin juridik të Qeverisë në raste të gjendjes së jashtëzakonshme, pakoja e parë u miratua në mundësinë e parë për miratim të dekreteve me fuqi ligjore ose Qeveria e shfrytëzoi rastin e parë për të luftuar pasojat negative ekonomike të krizës shëndetësore.

Masat e miratuara me këtë pako, fillimisht u drejtohen qytetarëve, por edhe sektorëve më të prekur: hotelierisë, dhe transportit:⁵⁴

- 1. Lirim nga pagesa e paradhënies nga tatimi mbi fitimin;*
- 2. Shtyrje dhe ristrukturim i pagesës së kredive për kompanitë dhe qytetarët;*
- 3. Subvencionim i 50% të kontributeve për prill, maj dhe qershor për punonjës, maksimum deri në pagën mesatare në vend;*
- 4. Kredi pa interes për të mbrojtur likuiditetin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, të prekura nga koronavirusi;*

⁵⁴Pako e masave ekonomike për kapërcimin e krizës së koronës, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në linkun: <https://www.finance.gov.mk/mk/node/8597>

5. *Fond për mbështetjen e turizmit për rimëkëmbje nga Covid-19;*
6. *Ngrirje e çmimeve të produkteve themelore në çmimin që ka qenë në ditën e shpalljes së pandemisë, dmth. 11 mars;*
7. *Kredi pa interes për mbrojtjen e vendeve të punës përmes Bankës për zhvillim, për kompanitë që do të kenë probleme në pagesën e pagave;*
8. *Subvencionim në kontribute për punonjësit në sektorët e turizmit, transportit dhe hotelierisë dhe për kompanitë tjera të prekura;*
9. *Zvogëlim i interesit ligjor ndëshkimor për 50%;*
10. *Përgjysmim i interesit ndëshkimor për të dhënat publike - nga 0,03% në 0,015.*

II. Pakoja e dytë ekonomike

Pakaja e dytë e masave ekonomike u miratua me vonesë prej më pak se dy javësh nga pakoja e parë, përkatësisht më 31 mars 2020. Pakoja "siguroi likuiditet dhe injeksion financiar për ekonominë përmes masave për të ndihmuar punëtorët dhe ekonominë",⁵⁵ dhe u bënë përpjekje që të garantohen sa më shumë vende pune.

Pakoja e dytë përfshinte masat në vijim:

1. *Pagesën e pagave të punëtorëve tek punëdhënësi - aplikues për mbështetje financiare për muajt prill dhe maj 2020 ;*
2. *Ndihmë për sportistët;*
3. *Ndihmë për artistët;*
4. *Pagë mujore (kompensim në të holla) për qytetarët që kanë ngelur pa punë për shkak të krizës, në shumën prej 50 % të pagës mesatare të punëtorit;*
5. *Zvogëlim i pagave të të gjithë funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, në vlerë të pagës minimale për prill dhe maj 2020; ;*
6. *Heqje e shpërblimit për kryetarët dhe anëtarët e këshillave drejtues dhe mbikëqyrës të institucioneve publike gjatë kohëzgjatjes së krizës; ;*
7. *Kujdes për njerëzit në ekonominë informale;*
8. *Pezullim i Ligjit për përmbarimin deri në fund të qershorit 2020;*
9. *Shtyrje e kredive në banka;*
10. *Ulje e kësteve dhe riprogramim i kredive për shoqatat financiare dhe kompanitë e lizingut;*
11. *Shtyrje e pagesës së qirasë për shfrytëzuesit e banesave sociale;*
12. *Kredi shtesë pa interes për ndërmarrjet, në vlerë prej 8 milion eurosh;*

⁵⁵ Prezantim i pakos së dytë të masave ekonomike për menaxhimin e krizës Covid, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në linkun: <https://vlada.mk/node/20813>

13. Kredi të lira, në vlerë prej 50 milion eurosh nga Banka e zhvillimit, të plasuar nëpërmjet të bankave komerciale për të mbrojtur likuiditetin e kompanive;
14. Ndalesë për hapjen e procedurës së falimentimit;
15. Shfrytëzim i obligueshëm i pjesës së parë të pushimit vjetor;
16. Formim i Fondit solidar COVID-19;
17. Ulje e honorareve autoriale të personave të angazhuar në institucionet publike.

II. Pakoja e tretë ekonomike

Pakaja e tretë ekonomike kishte për qëllim gjallërimin, rimëkëmbjen e ekonomisë dhe stimulimin e konsumit dhe industrisë dhe u miratua në ditën e lehtësimit të masave kufizuese, 17 maj 2020.⁵⁶

Pakaja përmban masat në vijim:

1. Kartë pagese me vlerë 9,000 denarë për produktet dhe shërbimet maqedonase;
2. Kupon për turizëm vendas prej 6,000 denarë dhe kartelë pagese vendase prej 3,000 denarë;
3. Mbështetje financiare për të rinjtë, deri në 6,000 denarë, kartelë pagese vendase prej 3,000 denarë dhe kuponë për bashkëfinancim për trajnime IT dhe aftësi dixhitale;
4. Fundjavë pa TVSH për të gjithë qytetarët;
5. Kompensim në të holla për të gjithë personat që kanë ngelur pa punë nga 11 marsi deri më 30 prill 2020;
6. Kredi pa interes për ndërmarrjet në mbështetje të grave, të rinjve dhe dixhitalizimit të biznesit, përmes Bankës së zhvillimit, në vlerë prej 31 milion euro;
7. Garanci shtetërore për kreditë komerciale dhe për sigurimin e borxhit doganor;
8. Mbështetje për tregje të reja, konkurrencë dhe modernizim të sektorit privat, në vlerë prej 25 milionë eurosh;
9. Platformë dixhitale për tregje të reja për ndërmarrjet e tekstilit;
10. Mbështetje për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve vendore start-up përmes FIZHT;

⁵⁶ Prezantim i pakos së tretë të masave ekonomike për menaxhimin e krizës Covid, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në linkun: <https://vlada.mk/node/21424>.

11. Bashkëfinancim i ngjarjeve dhe konferencave me 50% mbështetje financiare nga shteti, në shumë maksimale deri në 30,000 denarë;
12. Mbështetje për ndërmarrjet, duke subvencionuar 50% të kostove për organizimin e ngjarjeve, trajnimeve dhe konferencave, deri në një shumë maksimale prej 30,000 denarë, në një vlerë totale prej 245 mijë euro;
13. Mbështetje prej 5 milionë eurosh për sektorin e bujqësisë, përmes Bankës së zhvillimit;
14. Mbështetje për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme që kryejnë prodhimtari primare, për përpunuesit dhe eksportuesit e produkteve bujqësore primare dhe të përpunuara, në vlerë 5 milion euro;
15. Subvencionim i konsumit të vajit të gjelbër në 50%;
16. Stimulim për përpunuesit e rrushit për të prodhuar produkte të reja;
17. Mundësimi i partneritetit publik-privat në vreshtari dhe industrinë e duhanit;
18. Inkorporim i marrjes afatgjate me qira të kullotave;
19. Konsolidim i tokës bujqësore për një konkurrencë më të madhe të bujqësisë maqedonase;
20. Program për financimin e ndërmarrjeve bujqësore mikro.

IV. Pakoja e katërt ekonomike

Pakaja e katërt ekonomike ishte në të njëjtën kohë edhe më voluminozja dhe synonte të sigurojë qëndrueshmërinë e veprimtarive ekonomike vendase dhe të vendeve të punës, si dhe rimëkëmbjen e veprimtarive të caktuara, përkatësisht të sigurojë stabilitet të transferimeve sociale.⁵⁷ Pakoja e katërt u miratua në fillim të valës së dytë, më 27 shtator 2020.

Masat që janë pjesë e grupit të katërt janë:

1. Mbështetje për pagesën e pagave, që vazhdon të jetë e vlefshme edhe për tremujorin e fundit të vitit;
2. Karta të pagesave për qytetarët për konsum më të lartë dhe zhvillim të ekonomisë vendase;
3. Rritje e grejs periudhës tek kreditë pa interes nga COVID-19;
4. Kredi të favorshme nga Banka për zhvillim e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vlerë prej 100 milion eurosh;
5. Mbështetje me paga për udhërrëfyesit turistikë;
6. Rimbursimi i taksës turistike për vitin 2019;

⁵⁷ Prezentim i pakos së katërt të masave ekonomike për menaxhimin e krizës Covid, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dispozicion në linkun: <https://vlada.mk/node/22629>.

7. *Grante për agjencitë turistike;*
8. *Reduktim dhe / ose heqje e të dhënave parafiskale;*
9. *Grante për restorantet për dasma;*
10. *Vazhdim i kohëzgjatjes së licencave për punë të diskotekave, klubeve të natës dhe kompanive të komunitetit të transportit;*
11. *Grante për kënde lojërash për fëmijë;*
12. *Mbështetje për artizanët;*
13. *Garanci kreditore shtetërore;*
14. *Garanci doganore shtetërore;*
15. *Shtyrje e pagesës së kredive për kompanitë, deri në fund të vitit;*
16. *Ulje e interesit ndëshkimor për detyrimet publike nga 0,03% në 0,015%, deri në fund të vitit;*
17. *Shtyrje e pagesës së paradhënies së tatimit mbi fitimin;*
18. *Lirim nga TVSH-ja për donacionet e karakterit publik për 12 muaj të tjerë;*
19. *Ulje e shkallës së TVSH-së për shërbimet e restoranteve dhe shërbimin e ushqimit dhe pijeve, kështu që tatimi i këtyre shërbimeve do të bëhet me shkallë të re preferenciale të TVSH-së prej 10%, në vend të normës aktuale të rregullt prej 18%;*
20. *Shtyrje e pagesës së TVSH-së;*
21. *Fshirje e kushtit për mbledhje të pikëve nga përsosja e vazhdueshme profesional (PVP) për rinovimin e licencës për kontabilistët;*
22. *Vazhdim i periudhës për mbulimin e humbjeve në llogari të fitimeve të ardhshme;*
23. *Rritje e pragut me të cilin subjektet do të ishin pjesë e regjimit jo-tatimor me tatimin mbi fitimin dhe rritje e pragut me të cilin subjektet do të hynin në regjimin e të ardhurave totale;*
24. *Njohja e kostos së sigurimit shëndetësor privat si një shpenzim i pranuar;*
25. *Njohja e kostove të testimit për COVID-19, gjithashtu si shpenzim i pranuar;*
26. *Ulje e detyrimeve të importit të lëndëve të para;*
27. *Mbështetje për zhvillimin e kapitalit njerëzor;*
28. *Mbështetje për blerjen e rrushit nga të vjelat e vitit 2020;*
29. *Lirim në vlerë prej dy të tretave të shumës së parashikuar ligjërisht për organizatorët e lojërave të fatit;*
30. *Ndryshim i llogaritjes së bazës për financimin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale;*
31. *Fundjavë pa TVSH për të gjithë qytetarët.*

4. ANALIZË E RREGULLAVE NDËRKOMBËTARE, REKOMANDIMEVE DHE MASAVE

I. Organizata Ndërkombëtare e Punës

Organizata Ndërkombëtare e Punës,⁵⁸ si promotore dhe garantuese e të drejtave të punëtorëve, njëherit edhe luftëtare për standarde, punë të ndershme dhe dialog social, në kulmin e krizës shpalli rekomandime minimale që duhen ndjekur për të thjeshtësuar tejkalimin ose zbutjen e pasojave të COVID -19. Sipas organizatës, masat që i propozon cilado qoftë Qeveri, duhet të përqëndrohen në realizimin e katër qëllimeve kryesore dhe politikat duhet të bazohen në katër shtyllat e mëposhtme:

1. *Stimulim i ekonomisë dhe punësimeve;*
2. *Mbrojtje e shëndetit të punëtorëve në vendet e tyre të punës;*
3. *Vendosje e dialogut social për gjetjen e zgjidhjeve dhe*
4. *Mbështetje për kompanitë, të ardhurat dhe vendet e punës.*⁵⁹

Për të qenë të suksesshme dhe për të arritur qëllimin, masat duhet të kenë një ndikim afatgjatë, të jenë gjithëpërfshirëse dhe të ndërtohen në bazë të besimit dhe dialogut social. Në rekomandimet e saj, ONP thekson një listë të masave, si modele, nga më shumë shtete.

Në fushën e mbrojtjes së **shëndetit të punëtorëve në vendin e punës**, sipas ONP, masa më e rëndësishme është puna në distancë dhe orar fleksibël i punës. Kjo masë u zbatua edhe në vend, kurse Qeveria që në fillim të krizës doli me rekomandim për punëdhënësit për të organizuar procesin e punës duke punuar nga shtëpia. Sipas këtij rekomandimi, disa kompani punuan tërësisht punuan, përkatësisht, ende punojnë nga shtëpia. Disa kompani pjesërisht e zbatojnë këtë masë, përkatësisht implementuan një sistem rotacioni, në të cilin në ditë të caktuara punëtorët punojnë nga shtëpia, dhe në ditët tjera janë në zyrë, ose zbatojnë punë me turne. Kjo shtyllë gjithashtu përmban edhe masa për garantimin e qasjes në kujdesin shëndetësor për të gjithë, parandalim të diskriminimit dhe përjashtimit, përkatësisht rritje të përfshirjes së mungesës së paguar nga puna.

Në fushën e **stimulimit të ekonomisë**, sipas ONP, është e nevojshme të ndiqet një politikë monetare fiskale aktive dhe e adaptueshme, të sigurohen hua dhe mbështetje tjetër financiare për sektorë të caktuar, përfshirë këtu edhe sektorin e

⁵⁸ ONP është agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara dhe e vetmja agjenci "**tripalëshe**" e KB-ve që bashkon përfaqësues të qeverive, punëdhënëseve dhe punëtorëve për të krijuar së bashku politika dhe programe. ONP është trup global përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e standardeve ndërkombëtare të punës. Në punën e saj me 179 shtete anëtare, ONP garanton respektimin e standardeve të punës në praktikë dhe në esencë.

⁵⁹ A policy framework for tackling the economic and social impact of the COVID-19 crisis, International labor organization, fq. 4, në dispozicion në linkun: <https://rb.gy/leqvr6>.

shëndetësisë. Si shembull pozitiv në këtë fushë, ONP përmend uljen e normave të interesit në Australi, Kanada, Zelandën e Re, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.⁶⁰ Një masë për të trajtuar me sukses pasojat negative të krizës, e propozuar nga organizata, është gjithashtu sigurimi i mbështetjes financiare për sektorë të caktuar. Në këtë shtyllë, për sa i përket mbështetjes së punësimit, ONP veçon mbajtjen e punësimit, mbështetjen financiare dhe lehtësimet tatimore të punësimit, duke përfshirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. ONP thekson nevojën për zbatim të suksesshëm dhe përfshirje të gjerë të mbrojtjes sociale për të gjithë.

Lidhur me shtyllën e **dialogut social** për zgjidhje, ONP thotë se masat duhet të përqëndrohen në rritjen e kapacitetit të sindikatave dhe shoqatave të tjera të punëtorëve dhe punëdhënësve, duke rritur edhe kapacitetet e qeverive dhe forcimin e dialogut social.⁶¹ Sipas organizatës, pavarësisht nga politikat e shpallura që një vend do të zgjedhë për të zvogëluar pasojat e pandemisë, ato duhet të adresojnë sfidat e mëposhtme:

- Të arrijnë balancë ndërmjet aspekteve shëndetësore, ekonomike dhe sociale të politikave për intervenime;
- Të garantojnë efektivitet dhe efikasitet;
- Të ketë politika ndërhyrëse për grupet e prekshme të qytetarëve;
- Të mbështesin dialogun social si një mekanizëm efektiv për krijimin e politikave dhe
- Të sigurojnë solidaritet më të madh ndërkombëtar me vendet në zhvillim, me qëllim nxitjen e investimeve.⁶²

Në punën e saj, Organizata Ndërkombëtare e Punës, përveç rekomandimeve për qeveritë, ofroi rekomandime edhe për punëdhënësit, si të organizojnë procesin e punës nga shtëpia,⁶³ si t'u përgjigjen pyetjeve të shpeshta lidhur me sfidat nga COVID-19 dhe konventat tashmë të vendosura⁶⁴ dhe si të ndërtohen politika me fokus në familje,

⁶⁰ Dialogu social rreth sigurisë dhe shëndetit gjatë punës në kontekst të COVID - 19, Organizata ndërkombëtare e punës, në dispozicion në linkun: <https://socijalendijalog.mk/wp-content/uploads/2020/10/Kratok-pregled-na-politiki-final.pdf>

⁶¹ Ibid 48, fq.7

⁶² ILO Monitor: COVID-19 and the world of work. Sixth edition, fq.2, në dispozicion në linkun: <http://kss.mk/wp-content/uploads/2020/09/ILO-COVID19-Monitor-6th-Edition-1.pdf>

⁶³ Politika të përqëndruara në familje dhe praktika të tjera të mira në vendin e punës në lidhje me COVID-19: Hapat kryesorë që mund të ndërmarrin punëdhënësit, Organizata Ndërkombëtare e Punës.

⁶⁴ Standarde të ONP dhe Kovid-19 (koronavirus) – pyetje shpesh të parashtruara, Organizata Ndërkombëtare e Punës, në dispozicion në linkun: <https://socijalendijalog.mk/wp-content/uploads/2020/07/Standardi-na-MOT-i-Kovid-19.pdf>.

përkatësisht rekomandime për punëdhënësit si të organizojnë procesin e punës gjatë pandemisë.⁶⁵

II. Bashkimi Evropian

Duke pasur parasysh strukturën e Bashkimit Evropian, nuk duhet harruar që masat që ajo do t'i ndërmarrë, do të plotësojnë masat që shtetet anëtare do t'i zbatojnë në mënyrë të pavarur.⁶⁶ Deklarata e kryetares së Komisionit Evropian, Ursula fon der Lajen, flet për motivimin e fortë të Unionit të kontribuojë në uljen e pasojave të krizës COVID. Në deklaratë, ajo tha: "Pandemia COVID po na teston të gjithëve. Kjo nuk është vetëm sfidë e madhe për sistemet tona shëndetësore, por edhe një tronditje e madhe për ekonominë tona. Pakoja ekonomike e shpallur sot adreson situatën. Ne jemi të gatshëm të bëjmë më shumë, varësisht si do të zhvillohet situata. Ne do të bëjmë gjithçka që duhet, për të mbështetur të gjithë evropianët dhe ekonominë evropiane."⁶⁷ Gjegjësisht, Komisioni Evropian, përveç pakove ekonomike për zvogëlimin e pasojave të koronavirusit, miratoi edhe masa me të cilat i "liroi" rregullat e veta për të lejuar Qeveritë të ishin të shpejta në ndërhyrjet e tyre në fushën e politikave fiskale dhe dhënien e ndihmës shtetërore përmes miratimit të shpejtë nga Komisioni Evropian.

Një nga vendimet e para të Komisionit së bashku me Këshillin, ishte aktivizimi i "**klauzolës së arratisjes**" nga Pakti i stabilitetit dhe rritjes,⁶⁸ duke pasur parasysh që kriza është diçka që është përtej kontrollit të qeverive.⁶⁹ Në fakt, mbështetja u shfaq përmes relaksimit të rregullave fiskale dhe monitorimit fiskal mbi vendet anëtare. Për më tepër, Komisioni miratoi një kornizë të përkohshme për ndihmë shtetërore që u lejon shteteve anëtare fleksibilitetin e plotë në rregullat e ndihmës shtetërore, si dhe lehtësime të tjera të nevojshme procedurale, për të mundësuar veprim të shpejtë lidhur me njohtimin për ndihmë shtetërore.⁷⁰

⁶⁵ Politika të përqëndruara në familje dhe praktika të tjera të mira në vendin e punës lidhur me COVID-19: Hapat kryesorë që mund të ndërmarrin punëdhënësit, Organizata Ndërkombëtare e Punës, në dispozicion në linkun <https://www.unicef.org/northmacedonia/mk/media/5841/file>.

⁶⁶ Policy measures taken against the spread and impact of the coronavirus – 16 November 2020, Komisioni Evropian, Drejtoria e përgjithshme për çështje ekonomike dhe financiare, në dispozicion në linkun: https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/coronavirus_policy_measures_16_november.pdf.

⁶⁷ Deklaratë e kryetares së Komisionit Evropian, Ursula fon der Lajen, në konferencën e përbashkët për shtyp me nënkryetarët ekzekutivë të Komisionit, Margarete Vestaja dhe Vlladis Dombrovskis, të 13 marsit 2020, në dispozicion në linkun :

https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/statement_20_465

⁶⁸ Pakti për stabilitet dhe rritje janë një grup rregullash për shtetet e BE-së që mundësojnë koordinim të politikave fiskale të shteteve anëtare dhe financa stabile publike

⁶⁹ Komisioni propozon aktivizim të klauzolës së përgjithshme për shmangien e detyrimeve nga pakti për stabilitet dhe rritje, Komisioni Evropian, në dispozicion në linkun:

https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_20_499

⁷⁰ "Temporary Framework for State aid measures to support the economy in the current COVID-19 outbreak", Komisioni Evropian, në dispozicion në linkun:

https://ec.europa.eu/competition/state_aid/what_is_new/sa_covid19_temporary-framework.pdf

Ndihmën kryesore, Unioni e siguron përmes programit SURE ose **Temporary Support for Unemployment Risks in an Emergency**,⁷¹ në vlerë prej 90 miliardë eurosh. Ky program u dedikohet shteteve anëtare që janë më të goditura nga kriza dhe është shprehje e solidaritetit të Unionit. Gjatë kësaj, shtetet anëtare bien dakord të mbështesin njëri-tjetrin përmes Unionit duke vënë në dispozicion fonde shtesë përmes huave. Kontributi i çdo shteti anëtar në shumën totale të garancisë, korrespondon me pjesën e tij relative në Prodhimin e Brendshëm Bruto të Unionit, bazuar në buxhetin e vitit 2020. Nga ky program, 31 miliardë euro i janë paguar tashmë Italisë, Spanjës, Polonisë, Greqisë, Kroacisë, Lituanisë, Qipros, Sllovenisë, Maltës dhe Letonisë. Instrumenti SURE vepron si një linjë e dytë e mbrojtjes, duke mbështetur skemat e shkurtra të punës dhe masa të ngjashme për të ndihmuar shtetet anëtare të mbrojnë vendet e punës, me këtë edhe të punësuarit dhe të vetëpunësuarit, nga rreziku i papunësisë dhe humbjes së të ardhurave.

Fondi Evropian i investimeve strategjike ka siguruar 8 miliardë euro për likuiditet të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të goditura rëndë, kurse Nisma Evropiane e investimeve ka parashikuar një përgjigje në vlerë prej 65 miliardë eurosh. Kjo shumë i është alokuar Fondit Struktural Evropian me 29 miliardë euro, në buxhetin e Unionit me 7.9 miliardë euro dhe 28 miliardë euro të fondeve të pashpenzuara dhe të pashpërndara nga fondet strukturore.⁷²

1. ANALIZË E PËRVOJAVE TË SHTETEVE TË REGJIONIT

1. Kroacia

Ekonomia kroate është prekur ndjeshëm nga KOVID-19. Duke ditur që Kroacia është në pjesë të madhe e varur nga turizmi dhe partneri i saj më i madh tregtar është Italia, ky përfundim është mjaft i qartë dhe i pritshëm. Kroacia, që në fazat e hershme të pandemisë, mori masa konkrete për t'u ballafaquar me të. Gjegjësisht, më 17 Mars, 2020, qeveria Kroate miratoi 63 masa ekonomike dhe të tjera, me qëllim të ruajtjes së vendeve të punës dhe zvogëlimit të ndikimit negativ të KOVID-19. Vlera totale e masave ekonomike ishte 3.9 miliardë euro⁷³. Përveç injeksionit financiar, qeveria kroate ndërmorri hapa për lehtësimin dhe funksionimin e pandërprerë të ekonomisë, përkatësisht shtyerje të pagesës së detyrimeve publike për tre muaj, me mundësinë e

⁷¹ The European instrument for temporary Support to mitigate Unemployment Risks in an Emergency (SURE), Komisioni Evropian, në dispozicion në linkun: <https://rb.gy/ebhlkd>

⁷² Pasqyrë e përgjigjes së Komisionit Evropian për ballafaqimin me koronavirusin, Komisioni Evropian, në dispozicion në linkun: https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/eu_coronavirus_response.pdf

⁷³ Overview of Policy responses to COVID-19, International Monetary Fund, në dispozicion në linkun: <https://www.imf.org/en/Topics/imf-and-covid19/Policy-Responses-to-COVID-19#C>

zgjatjes për tre muaj shtesë si dhe pezulloj përkohësisht pagimin e detyrimeve të zgjedhura para-fiskale.⁷⁴

Sipas Entit shtetëror të statistikës së Republikës së Kroacisë, në korrik 2020, në Kroaci ka pasur 1.528.500 persona të papunë, që është për 1,1 % më shumë krahasuar me muajin paraprak.

Nëse krahasojmë të dhënat nga fundi i tremujorit të parë të vitit 2020 me dhjetorin e vitit 2019, atëherë numri i të papunëve ishte më i lartë për 8% dhe trendi i rritjes së papunësisë vazhdon. Sidoqoftë, nga këndvështrimi i tregut të punës, ky reagim është relativisht i butë, nëse merret parasysh rënia jashtëzakonisht e fortë e aktivitetit ekonomik. Ndër të tjera, ky reagim i butë në tregun e punës pasqyron edhe masat e Qeverisë që synojnë ruajtjen e vendeve të punës. Deri në fund të vitit 2020, punësimi pritet të ulet me një total prej 3.2%, që do të jetë pasqyrim i intensitetit dukshëm më të ulët të punësimit sezonal, ndërsa në 2021 pritet një rimëkëmbje graduale e tregut të punës. Parashikimet e Entit kroat të statistikës janë që në vitin 2021, punësimi në nivel vjetor mund të rritet për 2%, ndërsa shkalla e pritur e papunësisë, mund të jetë 7,8 %.⁷⁵

2. Mali i Zi

Mali i Zi luftën për stabilitetin dhe ruajtjen e ekonomisë me pandeminë e filloi që në fazë të hershme. Si përgjigje, Qeveria e Malit të Zi miratoi 3 pako masash⁷⁶ për të ruajtur stabilitetin ekonomik dhe për të ruajtur vendet e punës. Me masat, qeveria siguroi subvencione për sektorët më të goditur, si turizmi dhe bujqësia, duke mbuluar, prej 50 deri në 100% të pagës minimale të punonjësve, në varësi të shkallës sa është goditur sektori dhe industria. Pastaj shtyu pagesën e detyrimeve publike, vendosi rimbursim të TVSH-së brenda 45 ditëve, linja të kredive për të përmirësuar likuiditetin e ekonomisë dhe shumë masa të tjera.⁷⁷

⁷⁴ Overview of Policy responses to COVID-19, International Labor Organization, në dispozicion në linkun: <https://www.ilo.org/global/topics/coronavirus/regional-country/country-responses/lang-en/index.htm#HR>

⁷⁵ "Sa do të ndikojë pandemia në (mos)punësimin në Kroaci?", Privredni.HR, në dispozicion në linkun: <https://privredni.hr/hnb-do-kraja-godine-zaposlenost-ce-pasti-3-2-posto-a-2021-rasti-za-2-posto>

⁷⁶ <https://www.imf.org/en/Topics/imf-and-covid19/Policy-Responses-to-COVID-19#M>

⁷⁷ Overview of Policy responses to COVID-19, International Labor Organization, në dispozicion në linkun: <https://www.ilo.org/global/topics/coronavirus/regional-country/country-responses/lang-en/index.htm#ME>

U siguruan 5 milionë euro për pagesën e pagave të punëtorëve në sektorin e turizmit në periudhë prej dy muajsh

Tregu i punës në Malin e Zi shënon rritje të numrit të të papunëve, krahasuar me fillimin e vitit 2020, pavarësisht përpjekjeve të qeverisë dhe punëdhënësve, për të mbajtur punonjësit, duke përdorur të gjitha masat, përfshirë orët e reduktuara të punës, punën nga shtëpia, subvencionet e pagave etj. Që nga fillimi i zbatimit të masave për ballafaqim me koronavirusin më 15 mars, numri i të papunëve është rritur për 24%, përkatësisht si të papunë janë regjistruar plus 8.436 persona. Në periudhën nga marsi deri në tetor 2020, Enti për Punësim i Malit të Zi regjistroi 20,596 persona të rinj të papunë, ose për 8,157 persona më shumë se në të njejtën periudhë të vitit të kaluar, që është një rritje prej 70.4%⁷⁸

3. Sllovenia

U paguan plotësisht të gjithë punëtorët që ishin të sëmurë nga virusi korona në periudhën prej 11 prillit deri në 31 maj të vitit 2020.

Gjatë valës së parë të KOVID-19, Sllovenia në kohë ndërmorri hapa për të mbrojtur

punëtorët, gjegjësisht për të garantuar stabilitetin e ekonomisë dhe vendeve të punës. Sllovenia vendosi të zbatojë orar të shkurtuar të punës, subvencionuar nga shteti me pagesë të 90 % të pagës së punëtorit.⁷⁹ Duke pasur parasysh situatën e re të krijuar, me rebalanc të buxhetit, 3 miliardë euro u rialokuan për të ndihmuar punëdhënësit, punëtorët, familjet (sipas numrit të anëtarëve), pensionistët etj.⁸⁰

Që nga fillimi i pandemisë, papunësia në Slloveni ishte në rritje. Gjegjësisht, në fund të tremujorit të parë të vitit 2020, papunësia ishte 4.6%, ndërsa në fund të

⁷⁸ "Epidemia Kovid-19 rriti papunësinë në Malin e Zi për gati 19 %", PVInformer.ME, në dispozicion në linkun: <https://www.pvinformer.me/epidemija-covid-19-dovela-je-do-povecanja-nezaposlenosti-u-crnoj-gori-za-skoro-19-odsto>

⁷⁹ <https://www.ilo.org/global/topics/coronavirus/regional-country/country-responses/lang-en/index.htm#SI>

⁸⁰ <https://www.imf.org/en/Topics/imf-and-covid19/Policy-Responses-to-COVID-19#S>

tremujorit të dytë, u shënua një rritje, papunësia totale ishte 5.2%. Kjo tendencë ndalet në tremujorin e tretë, kur në të vërtetë u shënua një rritje e lehtë e punësimit, me punësimin e 5.100 personave të rinj. Krahasuar me fillimin e tremujorit, kjo është 0.6% më shumë. Krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2019, paraqet një rënie prej 1.1%.

Për shkak të rritjes së madhe të numrit të të infektuarve, Qeveria e Sllovenisë më 11 nëntor 2020 shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në vend. Gjendja e jashtëzakonshme u shpall për një periudhë 30 ditore dhe vendimi u pasua nga pakoja e gjashtë e masave ekonomike dhe financiare.

Pakoja e gjashtë e masave parasheh një miliardë euro si mbështetje

Tani, pasi që ekspertët ekonomikë konstatuan se shumë punëdhënës nuk do të jenë në gjendje të përballen me situatën e re të krijuar dhe se për shkak të krizës mund të rritet numri i të papunëve për 10,000 të tjerë, qeveria e Sllovenisë po shqyrton mundësinë e shtyrjes së zbatimit të ligjit për rritjen e pagës minimale.⁸¹

4. Bosnja e Hercegovina

Fillimi i zbatimit të kufizimeve të para për qytetarët dhe bizneset u përcjell nga pakot e para të masave të Qeverisë së Bosnje e Hercegovinës. Mbyllja e një numri të madh të ndërmarrjeve, lokaleve, shkollave, etj. përbënte një rrezik serioz për rritjen e shkallës së papunësisë, që detyroi Qeverinë të bëjë rebalanc buxheti dhe të caktojë 50 milion marka të konvertueshme për të luftuar pandeminë dhe për pajisje mjekësore.

1.000.000.000,00 marka të konvertueshme = 3 % të PBB

⁸¹ "Worse conditions on the labour market in the 2nd quarter of 2020, unemployment rate at 5.2%" Labor Force Survey, State Statistical Office of Slovenia, në dispozicion në linkun: <https://www.stat.si/StatWeb/en/News/Index/8975>

Në të njëjtën kohë, 30 milionë marka të konvertueshme iu ndanë spitaleve të vendit dhe Qeveria njoftoi se shuma totale e ndihmës ekonomike prej afërsisht 1 miliardë MK do të sigurohen për të mbështetur ekonominë.



Tërësia e këtij fondi shërben për të ruajtur dhe përmirësuar likuiditetin e kompanive.⁸²

Edhe përkaj ndërmarrjes së masave ekonomike dhe identifikimit të pakove të ndihmës dhe garantimit të stabilitetit të ekonomisë, rritje e papunësisë u vu re edhe në Bosnje e Hercegovinë. Në fund të korrikut 2020, si të papunë u regjistruan 426,252 persona. Krahasuar me muajin paraprak, kjo paraqet rritje prej 1.18 %, përkatësisht 4.952 persona. Nëse të dhënat nga korriku i vitit 2020 krahasohen me ato të së njëjtës periudhë në vitin 2019, atëherë numri i të papunëve në vitin 2020 është më i lartë për 4.7%. Në total, që nga fillimi i pandemisë, papunësia është rritur me 23,364 persona ose 5,8%.⁸³

5. Serbia

Republika e Serbisë, si vendet tjera në rajon, në fillim të marsit 2020 miratoi paketë e para të masave për t'u ballafaquar me pandeminë. Masat që synonin mbrojtjen e shëndetit publik dhe parandalimin e përhapjes së infeksionit ishin të ngjashme me ato të miratuara në vendin tonë, përkatësisht ora policore, karantina, mbyllja e objekteve publike, kufizimet e grupimit të qytetarëve, mbajtja e detyrueshme e maskave, mbyllja e vendkalimeve kufitare etj.⁸⁴

⁸² Overview of Policy responses to COVID-19, International Monetary Fund, në dispozicion në linkun: <https://www.imf.org/en/Topics/imf-and-covid19/Policy-Responses-to-COVID-19#B>

⁸³ "Rritja e papunësisë si pasojë e aktivitetit të zvogëluar ekonomik gjatë pandemisë Covid-19", Ministria e çështjeve civile të Bosnjes e Hercegovinës, në dispozicion në linkun: <https://bit.ly/2LmTbu6>

⁸⁴ Overview of Policy responses to COVID-19, Organization for Economic Cooperation and Development, në dispozicion në linkun: <https://www.oecd.org/coronavirus/country-policy-tracker/>

100 miliardë RSD	Shtyerje e pagesës së taksave dhe kontributeve për të gjithë punonjësit në sektorin privat
21 miliardë RSD	Shtyerje e pagesës paradhënie të tatimit mbi fitimin në tremujorin e dytë të vitit 2020
93 miliardë RSD	Subvencione me paga minimale për të gjithë të punësuarit në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme
4 miliardë RSD	Pagesë e 50% të pagës minimale neto për të gjithë të punësuarit në ndërmarrjet e mëdha private dhe të papunët

Njëkohësisht, Qeveria e Republikës së Serbisë miratoi disa pako të masave financiare për të lehtësuar punën e ekonomisë, përkatësisht shtyerje fillestare 3-mujore të pagesës së taksave dhe kontributeve për punonjësit në të gjitha ndërmarrjet private dhe shtyerje të pagesës në 24 këste duke filluar nga viti 2021. Më pas, shtyerje të pagesës paradhënie të tatimit mbi fitimin gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020, si dhe subvencione të pagave, që përfshinte pagesën e pagave minimale për të gjithë punonjësit në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për një periudhë prej tre muajsh dhe pagesë të 50 % të pagës minimale neto për të gjithë të punësuarit në ndërmarrjet e mëdha të sektorit privat dhe për të papunësuarit.⁸⁵ Masat tjera përfshijnë një moratorium 3 mujor ekzekutimi dhe interesi mbi borxhin tatimor sipas marrëveshjeve të ristrukturimit dhe një ulje prej 10 pikë përqindjeje në normën e interesit të borxhit tatimor. Së fundmi, si masë u miratua edhe një skemë e garancisë shtetërore për hua bankare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në vlerë prej 240 miliardë dinarë, si dhe hua të reja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nga Fondi i Zhvillimit (24 miliardë RSD).⁸⁶

Statistikat e punësimit tregojnë se në tremujorin e tretë të vitit 2020, numri i të punësuarve ishte 2,936,600, kurse numri i të papunëve ishte 292,000. E shprehur në përqindje, shkalla e punësimit për periudhën e dhënë është 49.9%, ndërsa shkalla e papunësisë është 9%. Sipas hulumtimit të tregut të punës të kryer nga Enti Shtetëror i Statistikës i Republikës së Serbisë, në tremujorin e tretë të vitit 2020, numri i të papunëve shënoi ulje për 16,300 ose 5.3%. Numri i përgjithshëm i të punësuarve është zvogëluar për 2,100 persona, ose -0,1% krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2019.⁸⁷

⁸⁵ Overview of Policy responses to COVID-19, International Labor Organization, në dispozicion në linkun: <https://www.ilo.org/global/topics/coronavirus/regional-country/country-responses/lang-en/index.htm#RS>

⁸⁶ Overview of Policy responses to COVID-19, International Monetary Fund, në dispozicion në linkun: <https://www.imf.org/en/Topics/imf-and-covid19/Policy-Responses-to-COVID-19#S>

⁸⁷ "Anketë mbi fuqinë e punës, tremujori i tretë 2020", Enti shtetëror i statistikës i Republikës së Serbisë, në dispozicion në linkun: <https://publikacije.stat.gov.rs/G2020/Pdf/G20201320.pdf>

6. *Kosova*

Qeveria e re e Kosovës miratoi edhe program të ri të rimëkëmbjes ekonomike, në një vlerë prej 365 milion eurosh dhe parashikonte më shumë pako fiskale. Më 30 mars, 2020, qeveria miratoi pakon e madhe të mbështetjes emergjente për individë, kompani dhe komuna të prekura nga kriza, prej rreth 180 milion euro, ose ~ 2.5% të e PBB-së. Disa muaj më vonë, më 18 maj 2020, u caktuan 10.9 milion euro shtesë të përfshira në pakon e ndihmës emergjente, nga të cilat 9.4 milion euro iu ndanë Ministrisë së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Sipërmarrjes dhe Investimeve Strategjike, kurse 1.5 milion euro Ministrisë së Financave dhe Transfertave. Më 19 qershor të vitit 2020, me Programin e Mbështetjes së Bujqësisë, u caktuan 53 milionë euro shtesë, duke siguruar pagesa të drejtpërdrejta për fermerët.⁸⁸

Disa nga masat kyçe që i miratoi Qeveria e Kosovës janë:

1. 6 milionë euro iu ndanë Ministrisë së shëndetësisë;
2. Shtyrje e pagesës së tatimit mbi fitimin, tatimit personal dhe TVSH-së;
3. Avancim i pagesave nga skemat e ndihmës sociale me një shumë shtesë prej një muaji për të mbështetur familjet në nevojë për ndihmë;
4. Heqja e TVSH-së gjatë importit të grurit dhe miellit; dhe
5. Shtyrje të pagesave ndaj ndërmarrjeve publike komunale.⁸⁹

Në vitin 2019, Kosova ishte rekorder i Ballkanit përnga punësimi. Rritja për atë vit ishte 6,7 %.⁹⁰ Ky sukses u çrregullua për shkak të pandemisë. Sipas Institutit për studime të avancuara të Kosovës, parashikohet se pandemia ka lënë mbi 37.000 qytetarë të Kosovës pa punë.⁹¹ Shkalla e punësimit në sondazhin për fuqinë punëtore për tremujorin e tretë të vitit 2020 është 30.1%. Sipas hulumtimit të njëjtë, në periudhën e njëjtë shkalla e papunësisë ka qenë 24.6 %.⁹²

⁸⁸ Overview of Policy responses to COVID-19, Organization for Economic Cooperation and Development, në dispozicion në linkun: <https://www.oecd.org/coronavirus/country-policy-tracker/>

⁸⁹ Overview of Policy responses to COVID-19, International Monetary Fund, në dispozicion në linkun: <https://www.imf.org/en/Topics/imf-and-covid19/Policy-Responses-to-COVID-19#K>

⁹⁰ „Ndikimi ekonomik dhe social i Kovid - 19 – Varfëri dhe mirëqenie e amvisërive“, Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor, World Bank Group, në dispozicion në linkun: <http://pubdocs.worldbank.org/en/322591590708746523/WBRER17-03-Labor-BOS.pdf>

⁹¹ „Shkalla e papunësisë në Kosovë 24,6 %, gratë më të rrezikuara“ KosovoOnline.COM, në dispozicion në linkun: <https://www.kosovo-online.com/vesti/ekonomija/stopa-nezaposlenosti-na-kosovu-246-odsto-zene-ugrozenije-5-1-2021>

⁹² „Labour Force Survey, Q3 2020“ Kosovo Agency for Statistics, në dispozicion në linkun: <https://ask.rks-gov.net/sr/agencija-za-statistiku-kosova/add-news/anketa-radne-snage-k3-2020>

2. ANALIZA E REZULTATEVE TË HULUMTIMIT KUALITATIV

Hulumtimi cilësor u bazua në intervista me: 1) **nëpunës shtetërorë dhe publikë**; 2) **punëdhënës të industrive më të goditura** (industria e tekstilit, industria përpunuese, hotelieria, etj.), përfaqësues të ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha; 3) **punëtorë të punësuar në industrinë e përpunimit dhe tekstilit, punëtorët me aftësi të kufizuara, punonjësit në rrezik social dhe punëtorët nga zonat rurale**.

Në mënyrë që pyetjet në intervista të jenë sa më relevante, pyetësorin e përshtatëm për të tri kategoritë e qytetarëve.

Pyetësori i sondazhit është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë e pyetjeve u përqëndrua në pikëpamjet e të anketuarve se si kriza shëndetësore (COVID-19) ndikoi në produktivitetin e ndërmarrjes në të cilën ata punojnë dhe nëse kjo ka ndikuar në vendin e tyre të punës. Pjesa e dytë e pyetjeve ka të bëjë me atë se si të anketuarit i perceptojnë masat e miratuara nga Qeveria për ballafaqimin me krizën shëndetësore (COVID-19) dhe si ndikuan ato në pozicionin e tyre të punës.

Dy pyetjet e para nga grupi i parë, të cilat i parashtruam në intervista, kishin të bëjnë me atë se a ndikoi kriza shëndetësore në uljen e ngarkesës së punës dhe të ardhurave. Pjesa më e madhe e të gjithë të anketuarve thanë se sasia e punës dukshëm u zvogëlua. Siç pritej, më të goditur ishin pronarët dhe të punësuarit në hotelieri dhe turizëm. U shprehën se dëmet financiare janë aq të mëdha, sa që një pjesë e tyre dyshojnë se do t'ia dalin ta tejkalojnë krizën shëndetësore, ose do të jenë të detyruar t'i mbyllin objektet e tyre, pasi që, siç thonë, kriza ende vazhdon.

Na dha goditje të rëndë. Duke pasur parasysh se jemi një objekt gastronomik me sipërfaqe të vogël, jemi mësuar me ahengje, punë me shumë njerëz, qëndrim pranë banakut dhe pjesa më e madhe e qarkullimit bëhej në këtë mënyrë të punës. Tani, në kohë të koronës, me masat kufizuese, të mosgrupohen më shumë se katër persona, shënojmë rënie të hatashme” - Bashkëpronar i një objekti shërbyes në Shkup..

“Mund të them se punojmë shumë pak, përkatësisht punojmë me 1 % në krahasim me këtë periudhë të vitit të kaluar. Duke pasur parasysh se jetojmë prej turistëve, përkatësisht të huajve që vizitojnë vendin tonë, kurse kufijtë janë të mbyllur, 1 % e punës bëhet nga konferencat, konferencat për shtyp, e të ngjashme” - Pronar i hotelit në Shkup

Puna seriozisht është ndalur edhe tek të punësuarit në sektorin shtetëror / publik. Megjithatë, një pjesë e tyre që kanë shkuar rregullisht në punë u shprehën se

ata personalisht kanë pasur më shumë punë, meqë një pjesë e madhe e kolegëve të cilët i shfrytëzonin masat e Qeverisë, i kanë keqpërdorur ato dhe fare nuk kanë punuar nga shtëpia.

“Kishte kolegë që shfrytëzonin masa (përkatësisht të sëmurë kronikë, prindër me fëmijë të vegjël, shtatzëna etj), por nuk punonin nga shtëpia dhe për këtë arsye vëllimi i punës na u rrit ndjeshëm” - nëpunëse publike në ESHP Psikiatri.

Dy pyetjet vijuese ua parashtroam të trija kategorive të qytetarëve dhe ato i referohen pyetjes *“A u përballën ata me ulje të pagave për shkak të krizës shëndetësore, përkatësisht me zvogëlim të numrit të të punësuarve?”*. Siç pritej, në këtë pjesë morrëm përgjigje të ndryshme, veçanërisht nëse analizohen punonjësit në sektorin shtetëror dhe punonjësit / pronarët në sektorin privat .Siç dihet, përkundër faktit se ngarkesa e punës u ul ndjeshëm në shumicën e institucioneve shtetërore / publike, numri i të punësuarve dhe shuma e pagave mbetën të njëjtat. Situata në sektorin privat është krejtësisht e ndryshme, përkatësisht tek shumica e tyre pagat u ulën në mënyrë drastike, ndërsa në disa prej tyre kishte edhe largime nga puna të një pjese të punonjësve. Kjo është veçanërisht e theksuar në industrinë e tekstilit dhe në hotelieri dhe turizëm.

Lidhur me faktin nëse e drejta e tyre për pushim vjetor ishte zvogëluar, mendimi mbizotërues në mesin e të punësuarve në sektorin shtetëror është se e drejta e tyre për pushim nuk ishte zvogëluar, por disa prej tyre theksuan se ditët që kanë qëndruar në shtëpi u ishin llogaritur si pjesë e pushimit vjetor.

“Nuk na u shkurtua e drejta e pushimit vjetor, por ditët e pushimit të vjetër na u llogaritën si ditë pushimi në atë kohë kur kemi qëndruar në shtëpi. Nuk kam asgjë kundër, pasi që gjithsesi qëndronim në shtëpi dhe ai pushim gjithsesi duhej shfrytëzuar deri në fund të qershorit, kur akoma vazhdonte situata” - këshilltar në njësi të komunës Gjoçë Petrov.

Tek të punësuarit në sektorin privat, kemi një pasqyrë tjetër, përkatësisht ata janë ballafaquar me përvoja të ndryshme. Një pjesë e tyre thonë se e kanë shfrytëzuar plotësisht pushimin vjetor, ndërsa të tjerë u shprehën se pushimi u ishte zvogëluar plotësisht ose pjesërisht nga ana e punëdhënësve. Është interesante se, poqese

„Pjesërisht po, në tërësi jo. Nuk ka distancë, edhe sot e kësaj dite nuk respektohet, maska mbajnë një pjesë e punëtorëve, sepse ka disa që nuk besojnë në koronën dhe nuk mbajnë maska. Ata nuk mund t'i detyrojnë askush të mbajnë maska” - Punëtore konfeksioni nga Shtipi

shikohen përgjigjet e pronarëve, asnjë prej tyre nuk deklarohet se ka pasur shkurtim të pushimeve vjetore tek të punësuarit e tyre.

Pyetja e radhës ishte se institucionet / kompanitë a u janë përmbajtur të gjitha rekomandimeve të autoriteteve shëndetësore. Të gjithë të anketuarit pohojnë se masat në aspekt të higjienës (mjetet për dezinfektim e të ngjashme) janë respektuar plotësisht, por një pjesë e të anketuarve të sektorit privat ankohen se disa prej kolegëve nuk kanë mbajtur maska dhe se kanë punuar në ambiente, ku për shkak të kushteve nuk kanë pasur mundësi të mbajnë distancën prej dy metrash.

Puna nga shtëpia ishte shumë aktuale gjatë krizës shëndetësore, por fotografia e përgjithshme nga intervistat është se produktiviteti i punës nga shtëpia ishte shumë më i ulët. Disa të anketuar nga sektori shtetëror thanë se ata që shfrytëzuan masat e Qeverisë, i kanë keqpërdorur dhe nuk kanë punuar fare nga shtëpia. Në sektorin privat, ata që punonin nga shtëpia shpesh detyroheshin nga pronarët e tyre, dhe produktiviteti

Duheshte shumë më herët të propozojnë masa dhe ato duheshte të jenë më konkrete. Kjo për arsye se pasi i shpallnin, të paktën në sektorin tonë, në momentin e parë, si p.sh. masa për ndihmë në pagë për çdo të punësuar, ishin shumë të paqarta, askush nuk dinte se çfarë dhe si duhet bërë që të arrijë deri te ndihma. Brenda disa ditësh masat ndryshoheshin, plotësoheshin vazhdimisht. Qeveria kishte mirëkuptim për disa kërkesa, por në përgjithësi mendoj se ato ishin shumë pak, për tërë këtë goditje që na u dha” - Pronar i një objekti shërbyes në Shkup.

i tyre u ul ndjeshëm, në krahasim me periudhën kur shkonin rregullisht në punë. Sidoqoftë, duhet theksuar se intervistat u kryen me punonjës në industrinë e tekstilit, industrinë përpunuese dhe hotelieri, ku mundësitë për të punuar nga shtëpia janë ndjeshëm të zvogëluara në krahasim me sektorët e tjerë.

Grupi i dytë i pyetjeve lidhet me atë se sa janë të njohur të anketuarit me masat që i ndërmorrën institucionet për të ndihmuar ekonominë. Përgjigja dominante është se shumica e të trija kategorive të të anketuarve janë të njohur me masat. Kjo është veçanërisht e shprehur tek pronarët e kompanive private.

Pjesa më e madhe e tyre, për masat janë informuar nga mediumet tradicionale, interneti dhe konferencat për shtyp të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

“Nuk jemi të kënaqur, veçanërisht hotelieria u la në margjina. Restorantet dhe lokalet morrën protokolle dhe filluan me punë, kurse hotelierët edhe sot e kësaj dite nuk kanë diçka të tillë. Qeveria duheshte të bëjë një klasifikim se cilat kompani, cilat sektorë janë më të goditur dhe ashtu të ndahet ndihma. Kështu, ata të cilët kishin më shumë nevojë, u lanë në margjina” - menaxher operativ i një hoteli në Shkup.

Institucionet duheshte të sigurojnë që mjetet në të holla të shkojnë drejtpërsëdrejti në duart e punëtorëve, e jo në duart e pronarëve, ata nuk kishin aq nevojë për ndihmë nga institucionet” - punëtore nga Shkupi, e cila ka mbetur pa punë gjatë krizës shëndetësore.

Sa i përket pyetjes se sa janë të kënaqur nga masat, përsëri ka mendime të përziera tek të gjitha kategoritë e qytetarëve. Tek pronarët e ndërmarrjeve ka mendime të ndryshme, por të gjithë konfirmojnë se ka pasur vonesë të masave, të paktën prej një muaji, e njëherit masat nuk janë shpjeguar plotësisht, gjë që dukshëm e vështirësoi procesin.

Edhe tek të punësuarit, ka emocione të përziera lidhur me këtë pyetje; një pjesë mendon se masat kanë qenë të shkëlqyeshme, një pjesë mendon se nuk ishin të

“Në Serbi aplikohet on line për ndihmë financiare prej 100 eurosh dhe i përfshiu të gjithë, pa dallim të statusit social dhe situatës financiare. Unë mendoj se edhe tek ne duheshte të veprohet sipas modelit serb, kush paraqet kërkesë, të merr ndihmë” - profesor në shkollë të mesme në Shkup.

mjaftueshme, ose se janë keqpërdorur nga ana e pronarëve të kompanive.

“Sipas asaj që unë e përcjell, ne i ndjekim trendet e Evropës dhe ia përshtasim gjendjes sonë, kështu që, kjo është që është” - Pronar i një kompanie tekstili nga Shtipi.

Pyetja e fundit që ua parashtruam të anketuarve, ishte se a dinë për ndonjë masë që ka qenë e pranishme në ndonjë shtet tjetër (me theks të veçantë në shtetet fqinje), e pët të cilën mendojnë se do të ishte me të vërtetë e dobishme të zbatohet edhe në shtetin tonë.


Në lidhje me këtë çështje, shumë prej njerëzve që intervistojmë nuk ishin aspak të njohur me masat në vendet e tjera, por ata që ishin pjesërisht të njohur kanë pikëpamje të ndryshme. Disa mendojnë se institucionet kanë marrë masa të ngjashme si edhe vendet e tjera, ndërsa disa prej tyre theksuan masa që kanë mund të përdoren edhe tek ne.

3. ANALIZA E TË DHËNAVE NGA HULUMTIMI KUANTITATIV

Pyetësi i sondazhit është i ndarë në dy pjesë të cilat ndahen në gjashtë grupe pyetjesh. **Pjesa e parë** e pyetjeve u përqëndrua në pikëpamjet e të anketuarve se si kriza shëndetësore (COVID-19) ndikoi në produktivitetin e kompanisë në të cilën ata punojnë dhe nëse dhe në çfarë mënyre ndikoi në vendin e tyre të punës. **Pjesa e dytë** e pyetjeve përqëndrohet në atë se si të anketuarit i perceptojnë masat e miratuara nga Qeveria e RMV për trajtimin e krizës shëndetësore (COVID-19) dhe si ato ndikuan në pozicionin e tyre të punës. Për të fituar një pasqyrë më të gjerë të perceptimit të kategorive të ndryshme të qytetarëve, përveç analizës së përgjithshme, kryqëzuam gjashtë pyetjet me 5 të dhëna demografike (mosha, niveli i arsimit, të ardhurat personale, sektori dhe industria ku i intervistuari / a është i / e punësuar). Është me rëndësi të theksohet se në varësi të natyrës së çështjes, disa prej tyre u kryqëzuan me të gjitha të dhënat e theksuara demografike, ndërsa disa prej tyre vetëm me ato të dhëna demografike që janë të rëndësishme për ato çështje.

Grupi 1. Prezencë fizike në vendin e punës ose punë nga shtëpia


Grupi i parë i pyetjeve përbëhet nga 3 pyetje dhe dy nënpyetje. **Në pyetjen e parë** "Gjatë krizës shëndetësore (COVID-19), në periudhën kur shteti vendosi masa të jashtëzakonshme, a keni shkuar rregullisht në ambientet e vendit tuaj të punës?" 49.7% u përgjigjën se gjatë gjithë kohës së krizës kanë shkuar rregullisht në vendin e tyre të punës; 21.2% që shumicën e kohës së krizës kanë shkuar rregullisht në vendin e tyre të punës; ndërsa 26.6% u përgjigjën se fare nuk kanë shkuar në punë, ose vetëm herë pas here kanë shkuar në vendin e punës.



Grafiku 4. Gjatë kohës së krizës shëndetësore (Covid - 19), në periudhën kur shteti vendosi masa të jashtzakonshme, a keni shkuar rregullisht në ambientet e vendit tuaj të punës?

Analiza e përgjigjeve sipas **moshës** tregon se gjatë krizës, të moshuarit kanë shkuar më me rregull në vendin e tyre të punës, përkatësisht 54.6% e të anketuarve midis 50-59 vjeç dhe 52.8% e të anketuarve midis 40-49 vjeç deklaruan se rregullisht kanë shkuar në vendet e tyre të punës. Në mesin e të rinjve, përqindja e atyre që kanë deklaruar se rregullisht kanë shkuar në punë është më e ulët, përkatësisht 46.3% në mesin e të anketuarve midis 18-29 vjeç dhe 42% në mesin e të anketuarve midis 30 dhe 39 vjeç.


Dalime lidhur me këtë çështje ka edhe sipas **nivelit të arsimit**, përkatësisht përqindja e shkuarjes së rregullt në punë është më e ulët midis të anketuarve me arsim më të lartë. Në vendin e tyre të punës, rregullisht kanë shkuar 56.9 % të të anketuarve me arsim fillor, 53.9 % të anketuarve me arsim të mesëm dhe dukshëm më pak, 40.7 % të anketuarve me arsim të lartë.




Grafiku 5. Gjatë kohës së krizës shëndetësore (Covid - 19), në periudhën kur shteti vendosi masa të jashtzakonshme, a keni shkuar rregullisht në ambientet e vendit tuaj të punës?-(kryqëzuar me moshën e të anketuarit)

TABELA

Përsa i përket **sektorit** ku punojnë të anketuarit, dallimi lidhur me këtë çështje është i vogël. Në mesin e të anketuarve që janë të punësuar në sektorin publik dhe privat, përqindja e atyre që kanë shkuar rregullisht në punë është diçka më pak se 50%, ndërsa në mesin e të anketuarve që janë të vetëpunësuar është më e lartë, përkatësisht 55.7%.




Grafiku 6. Gjatë kohës së krizës shëndetësore (Covid - 19), në periudhën kur shteti vendosi masa të jashtzakonshme, a ke ni shkuar rregullisht në ambientet e vendit tuaj të punës? - (kryqëzuar me shkallën e arsimimit të anketuarit)?




Grafiku 7. Gjatë kohës së krizës shëndetësore (Covid - 19), në periudhën kur shteti vendosi masa të jashtzakonshme, a keni shkuar rregullisht në ambientet e vendit tuaj të punës? - (kryqëzuar me sektorin e vendit të punës të anketuarit)

Ka ndryshime të mëdha për këtë çështje, nëse analizohet sipas **industrisë** në të cilën punojnë. Përqindja më e lartë, 71.9% e të punësuarve në shëndetësi, kanë shkuar rregullisht në vendet e tyre të punës, pastaj vijnë punonjësit në tregtinë me pakicë 64.5% dhe në prodhimtari 62.6%. Përqindja është shumë më e ulët midis të anketuarve që punojnë në veprimtari shërbimi 41.7% dhe më e ulta midis të punësuarve në arsim, vetëm 12.5%.




Grafiku 8. *Gjatë kohës së krizës shëndetësore (Covid - 19), në periudhën kur shteti vendosi masa të jashtzakonshme, a keni shkuar rregullisht në ambientet e vendit tuaj të punës? - (kryqëzuar me veprimtarinë e vendit të punës të anketuarit)*

Në fund, këtë çështje e kemi analizuar edhe në aspekt të të **ardhurave personale** në baza mujore. Më rregullisht në ambientet e vendit të punës kanë shkuar të anketuarit me të ardhura mujore ndërmjet 30,000 - 45,000 denarë, me 64,3%, pas tyre me 62,5% janë të anketuarit me të ardhurat më të ulëta, përkatësisht me të ardhura mujore nga 0 deri në 12,000 denarë. Më të parregulltit, sa i përket shkuarjes në vendin e punës janë të anketuarit me të ardhura mujore ndërmjet 21,000 - 30,000 denarë, me 49.6%.




Grafiku 9. Gjatë kohës së krizës shëndetësore (Covid - 19), në periudhën kur shteti vendosi masa të jashtzakonshme, a keni shkuar rregullisht në ambientet e vendit tuaj të punës? - (kryqëzuar me të ardhurat mujore të anketuarit)

Pyetja e dytë ishte e dedikuar për të anketuarit që **shkonin rregullisht ose herë pas here në punë**, përkatësisht nëse kompanitë respektonin të gjitha rekomandimet (dezinfektimi i rregullt, distanca e përshtatur midis punonjësve dhe kështu me radhë) që ishin imponuar gjatë krizës COVID-19. Një përqindje e lartë, përkatësisht 88.7% e të anketuarve u përgjigjën se kompanitë ku ata punojnë plotësisht u përmbahen të gjitha rekomandimeve, 9.4% që pjesërisht u janë përmbajtur rekomandimeve, ndërsa vetëm 1.4% që fare nuk u janë përmbajtur rekomandimeve.




Grafiku 10. Kompania juaj a u përmbahet të gjitha rekomandimeve (dezinfektim i rregullt, distancë e përshtatur ndërmjet të punësuarve, etj.) që u imponuan gjatë kohës së krizës Kovid - 19?

Nëse e analizojmë këtë çështje sipas veprimtarisë, përqindja është e lartë në të gjitha veprimtaritë. Megjithatë, më e lartë është në shëndetësi dhe arsim me 100%, dhe më e ulta në sektorin e shërbimeve me 86.4%.




Grafiku 11. Kompania juaj a u përmbahet të gjitha rekomandimeve që u imponuan gjatë krizës Kovid - 19? (kryqëzuar me industrinë e vendit të punës së të anketuarit)

Lidhur me **të ardhurat mujore**, ekziston një dallim më i madh sa i përket përgjigjeve të të anketuarve. Në ndërmarrjet ku punojnë të anketuarit me të ardhura më të ulta, nga 0 deri në 12,000 denarë, më pak janë respektuar rekomandimet e vendosura gjatë Covid-19, me vetëm 53.8%, rekomandimeve më së shumti u përmbahen kompanitë ku punojnë të anketuarit me të ardhura nga 21,000 deri në 30,000 denarë, përkatësisht me 95.4% dhe mbi 45,000 denarë me 91.7%.



Grafiku 12. *Kompania juaj a u përmbahet të gjitha rekomandimeve që u imponuan gjatë krizës Kovid - 19? (kryqëzuar me të ardhurat mujore të anketuarit)*


Pyetja e tretë nga ky grup ishte dedikuar për të anketuarit që punuan nga shtëpia gjatë krizës shëndetësore dhe të anketuarit u pyetën: "Cila është përvoja juaj për punën nga shtëpia? Renditeni në një shkallë nga 1 në 5, ku 5 do të thotë plotësisht produktive dhe 1 do të thotë plotësisht joproduktive." Nga të anketuarit, 16.7% e vlerësojnë punën nga shtëpia si produktive, 44.7% as produktive dhe as joproduktive, ndërsa 20.7% punën nga shtëpia e vlerësojnë si joproduktive.



Grafiku 13. *Si është përvoja juaj për punën nga shtëpia? Renditeni në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 5, do të thotë plotësisht produktive, kurse 1 plotësisht joproduktive.*

Nga të anketuarit që e vlerësuan si produktive, si përfitime më të mëdha përmendën mbrojtjen nga virusi Korona dhe më shumë kohë punë, me 36%, vijon presioni më i ulët gjatë punës me 24%. Të anketuarit që e vlerësuan si negative punën nga shtëpia, pak më shumë se gjysma e tyre (51.6%) si negativitet më të madh e theksuan *"papërgatitjen për mësim online për fëmijët e tyre"*, pastaj *"Mungesën e kushteve të përshtatshme për punë nga shtëpia"* me 29%, si dhe *"pamundësinë për të bashkëpunuar me kolegët"* me 19.4%.

Grupi 2. Ndikimi i krizës shëndetësore (COVID-19) mbi vëllimin dhe përfitimin e ndërmarrjeve




Grafiku 14. Si ndikoi / ndikon kriza shëndetësore (COVID-19) mbi vëllimin e punës në kompaninë tuaj?

Pyetja e parë e këtij grupi që ua bëmë të anketuarve ishte *"Si ndikon / ndikoi kriza shëndetësore (COVID-19) mbi vëllimin e punës në kompaninë tuaj?"*. Rreth 35.4% e të anketuarve deklaruan se vëllimi i punës në kompaninë në të cilën ata punonin ishte zvogëluar ndjeshëm, ndërsa 16% deklaruan se ishte zvogëluar, por në mënyrë të parëndësishme. 32.5% u përgjigjën se vëllimi i punës mbeti i njëjtë si më parë, ndërsa vetëm 14.9% deklaruan se vëllimi u rrit në mënyrë të konsiderueshme ose të parëndësishme, krahasuar me kohën para fillimit të krizës shëndetësore.


Lidhur me **veprimtarinë**, përqindja më e lartë e përgjigjeve se vëllimi i punës u ul ndjeshëm, ishte tek të punësuarit në veprimtarinë e shërbimit - 51.3% dhe të punësuarit në tregtinë me pakicë - 47.3%. Siç pritej, për këtë pyetje, përqindja më e ulët

është në mesin e të anketuarve që janë pjesë e sistemit shëndetësor me 21.9%, si dhe në arsim me 12.5% të cilët deklaruan se vëllimi i punës ishte ulur ndjeshëm.




Grafiku 15. Si ndikon / ndikoi kriza shëndetësore (COVID-19) mbi vëllimin e punës në kompaninë tuaj? (kryqëzuar me veprimtarinë e vendit të punës të anketuarit)

Pyetja e radhës që ua parashtroam të anketuarve kishte të bëjë me përfitimin e kompanisë, përkatësisht "Si ndikon / ndikoi kriza shëndetësore (COVID - 19) mbi përfitimin në kompaninë tuaj?" Sikur në pyetjen paraprake, përqindje e lartë prej 30.7 % u përgjigjën se përfitimi është ulur ndjeshëm, kurse 11.6 % thanë se përfitimi është ulur, por jo aq ndjeshëm. Se përfitimi mbeti i njëjtë si para fillimit të krizës shëndetësore, u deklaruan 32.4%, ndërsa vetëm 6.1% thanë se përfitimi ishte rritur dukshëm, ose jo aq ndjeshëm.



Grafiku 16. Si ndikon / ndikoi kriza shëndetësore (COVID-19) mbi përfitimin në kompaninë tuaj?


Edhe sa i përket kësaj pyetjeje, më të goditura janë kompanitë që punojnë në veprimtari shërbimi dhe tregtinë me pakicë. 47.8 % të të punësuarve në veprimtarinë e shërbimit besojnë se përfitimi u ul ndjeshëm gjatë krizës shëndetësore, ndërsa midis të punësuarve në tregti, këtë perceptim e kanë 45% të të anketuarve. Të punësuarit në shëndetësi kanë pikëpamje më pozitive dhe vetëm 22 % thonë se përfitimi u ul ndjeshëm gjatë krizës shëndetësore.



Grafiku 17. Si ndikon / ndikoi kriza shëndetësore (COVID-19) mbi përfitimin në kompaninë tuaj? (kryqëzuar me veprimtarinë e vendit të punës të anketuarit)


Grupi 3. Kushtet e punës gjatë krizës shëndetësore (COVID-19)

Grupi i tretë i pyetjeve përqendrohet në ndryshimet në kushtet e punonjësve, të imponuara nga kriza shëndetësore (COVID-19). **Pyetja e parë** nga ky grup pyetjesh që ua bëmë të anketuarve ishte "A ka kontribuar kriza shëndetësore (COVID-19) në zvogëlimin e numrit të të punësuarve në kompaninë tuaj?" Përqindje më e lartë, përkatësisht 72.7 % u deklaruan se numri i të punësuarve ka mbetur i njëjtë, si edhe para fillimit të krizës shëndetësore, kurse 22.2 % u deklaruan se numri i të punësuarve ka qenë dukshëm ose jo aq ndjeshëm i zvogëluar. Vetëm 0.9 % nga të anketuarit thanë se numri i të punësuarve është rritur gjatë krizës.




Grafiku 18. A kontribuoi kriza shëndetësore (COVID-19) për zvogëlimin e numrit të të punësuarve në kompaninë tuaj?

Këtë pyetje e analizuam edhe sipas **veprimtarisë** në të cilin punojnë të anketuarit. Tregtia me shumicë është më e prekur, përkatësisht 20% kanë deklaruar se numri i të punësuarve është zvogëluar ndjeshëm, pastaj është veprimtaria e shërbimit, ku 12% kanë deklaruar se numri i të punësuarve është zvogëluar ndjeshëm. Punonjësit në shëndetësi dhe arsim besojnë se numri ka mbetur i njëjtë ose është rritur pak që nga fillimi i krizës shëndetësore.



Grafiku 19. A kontribuoi kriza shëndetësore (COVID-19) për zvogëlimin e numrit të të punësuarve në kompaninë tuaj? (kryqëzuar me veprimtarinë e vendit të punës të anketuarit)


Pyetja tjetër lidhet me pagat e të anketuarve, përkatësisht "A ka / a ka pasur ulje të pagave të punonjësve në kompaninë tuaj për shkak të krizës shëndetësore (COVID-19)?" Përsëri, përqindje më e lartë 75.1% u përgjigjën se pagat e punonjësve mbetën të njëjtat si para fillimit të krizës shëndetësore. Megjithatë, përqindje e lartë, 14.1 % e të anketuarve u deklaruan se gjatë krizës shëndetësore, rrogat dukshëm u janë zvogëluar (më shumë se 20 %), ndërsa 6.3 % thanë se rrogat nuk u janë zvogëluar aq shumë gjatë krizës shëndetësore (më pak se 20 %). Vetëm 1,5 % thanë se u janë rritur rrogat gjatë krizës shëndetësore.



Grafiku 20. A ka / kishte ulje të rrogave në kompaninë tuaj, për shkak të krizës shëndetësore (COVID-19)?

Nëse kjo çështje analizohet përnga **veprimtaria** në të cilën punojnë të anketuarit, më të prekurit ishin punonjësit në veprimtarinë e shërbimit, ku 21.7% deklaruan se kishte ulje të konsiderueshme të pagave të punonjësve (më shumë se 20%), ndërsa 9.1% thanë se ka pasur ulje të parëndësishme të pagave të punonjësve (më pak se 20%). Përqindja është e lartë edhe tek të punësuarit në tregtinë me pakicë, 15.1% u shprehën se ka pasur një ulje të konsiderueshme të pagave të punonjësve (më shumë se 20%), ndërsa 6% thanë se ka pasur ulje të lehtë të pagave të punonjësve (më pak se 20%) .

**Zvogëlim i pagave të punonjësve
(Industria e vendit të punës)**



Grafiku 21. A ka / kishte ulje të pagave të punonjësve në kompaninë tuaj, për shkak të krizës shëndetësore (COVID-19)? (kryqëzuar me industrinë e vendit të punës të anketuarit)


Lidhur me të **ardhurat mesatare mujore**, ka dallime të konsiderueshme, përkatësisht tek të anketuarit me të ardhura më të ulëta mujore, ulja e pagave gjatë krizës COVID-19 është më e theksuar. Madje, 37.5% të të anketuarve me të ardhura më të ulta nga 0 - 12,000 denarë kanë deklaruar se në kompaninë e tyre ka pasur ulje të konsiderueshme të pagave të të punësuarve (më shumë se 20%), ndërsa tek të anketuarit me të ardhura mujore ndërmjet 12,000 - 21,000 denarë me 13.2%. Tabloja është krejtësisht e ndryshme në mesin e të anketuarve me të ardhura më të larta mujore, përkatësisht 0% e të anketuarve të ardhurat mujore të të cilëve janë + 45,000 denarë, deklaruan se ka pasur ulje të konsiderueshme të pagave (më shumë se 20%), ndërsa te të anketuarit me të ardhura mujore prej 30,000 deri 45,000 denarë, për këtë u deklaruan vetëm 2.4%.



Grafiku 22. A ka / a kishte ulje të pagave në kompaninë tuaj për shkak të krizës shëndetësore (COVID-19)? (kryqëzuar me të ardhurat mujore të anketuarit)


Grupi 4. Të drejtat e punëtorëve dhe diskriminimi në vendin e punës gjatë krizës shëndetësore (COVID-19)

Pyetja e parë nga grupi i katërt i pyetjeve ka të bëjë me pushimin vjetor të të anketuarve, përkatësisht a është zvogëluar / shkurtuar e drejta e tyre për pushim vjetor për shkak të krizës shëndetësore (COVID-19). Shumica e të anketuarve, 74.4% deklaruan se pushimet e tyre nuk ishin zvogëluar aspak, ndërsa 16.3% deklaruan se pushimet e tyre vjetore ishin ulur ndjeshëm ose në mënyrë të parëndësishme. Vetëm 2.9% e të anketuarve deklaruan se nuk u ishte dhënë fare pushim që nga fillimi i krizës shëndetësore.




Grafiku 23. A ju është zvogëluar / shkurtuar e drejta për pushim vjetor për shkak të krizës shëndetësore (Covid 19) ?

Rishtazi bëme një analizë sipas **sektorit** në të cilin punojnë të anketuarit. U pa se 20% e të anketuarve që punojnë në sektorin privat, deklaruan se pushimi i tyre vjetor u zvogëluar ndjeshëm ose në mënyrë të parëndësishme, ndërsa për të njejtën u deklaruan 12 % e të punësuarve në sektorin shtetëror / publik.



Grafiku 24. A ju është zvogëluar / shkurtuar e drejta për pushim vjetor për shkak të krizës shëndetësore (Covid 19) ? (kryqëzuar me sektorin e vendit të punës të anketuarit)


Sa i përket **industrisë** ku punojnë të anketuarit, për këtë pyetje nuk ka dallime të mëdha, në të gjitha veprimtaritë përqindja është ndërmjet 15% dhe 25%.



Grafiku 25. A ju është zvogëluar / shkurtuar e drejta për pushim vjetor për shkak të krizës shëndetësore (Covid 19) ? (kryqëzuar me industrinë e vendit të punës të anketuarit)


Analiza mbi këtë pyetje, sipas të **ardhurave mesatare mujore**, tregon se të anketuarve me të ardhura më të ulëta, u është ulur ndjeshëm e drejta për pushim vjetor gjatë krizës COVID-19. Kështu, të anketuarit që kanë të ardhura mujore ndërmjet 0 - 12,000 denarë, madje 56.3% prej tyre, deklaruan se pushimi i tyre vjetor është zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme ose të parëndësishme, ndërsa tek të anketuarit me të ardhura mujore mbi 45,000 denarë, për këtë u deklaruan vetëm 7.1%.

Pushimi vjetor na u zvogëlua...
(Të ardhura mujore)



Grafiku 26. A ju është zvogëluar / shkurtuar e drejta për pushim vjetor për shkak të krizës shëndetësore (Covid 19) ? (kryqëzuar me të ardhurat mujore të anketuarit)

Pyetja e dytë nga ky grup pyetjesh për të anketuarit ishte "A jeni ndjerë i diskriminuar në ndonjë mënyrë nga punëdhënësi, për shkak të krizës shëndetësore?". Një përqindje e lartë, 91.6% deklaruan se nuk ishin të diskriminuar në asnjë mënyrë, në vendin e tyre të punës gjatë krizës shëndetësore.




Grafiku 27. A u ndjetë i diskriminuar në ndonjë farë mënyre nga punëdhënësi, për shkak të krizës shëndetësore?

Të anketuarit që u deklaruan se kanë qenë të diskriminuar (5,3%), si mënyra më të shpeshta të diskriminimit kanë theksuar:


- Mosrespektim të masave / rekomandimeve;
- Pushim i shkurtuar / nuk ka marrë pushim;
- Zvogëlim i pagës

Nëse e analizojmë këtë çështje **sipas moshës**, kryesisht në të gjitha moshat, përqindja që konsiderohet se kanë qenë të diskriminuar gjatë krizës shëndetësore është e njëjtë, rreth 4%; vetëm tek të anketuarit midis 30-39 vjeç, është më e lartë me 8%.




Grafiku 28. A u ndjetë i diskriminuar në ndonjë farë mënyre nga punëdhënësi, për shkak të krizës shëndetësore? (kryqëzuar me shkallën e arsimit të anketuarit)

E njëjta gjë vlen edhe për **nivelin e arsimit**, ku veçohen të anketuarit me arsim fillor me 6.9% të cilët mendojnë se kanë qenë të diskriminuar nga punëdhënësit e tyre gjatë krizës shëndetësore.




Grafiku 29. A u ndjetë i diskriminuar në ndonjë farë mënyre nga punëdhënësi, për shkak të krizës shëndetësore? (kryqëzuar me moshën e të anketuarit)

Sa i përket **sektorit**, ndjenja se kanë qenë të diskriminuar, në mesin e të punësuarve në sektorin privat është më e theksuar me 7.1%, ndërsa tek të punësuarit në sektorin publik / shtetëror është 3.8%.




Grafiku 30. A u ndjetë i diskriminuar në ndonjë farë mënyre nga punëdhënësi, për shkak të krizës shëndetësore? (kryqëzuar me sektorin e vendit të punës të anketuarit)

Dallimi lidhur me këtë pyetje, ishte i vogël edhe në aspekt të **industrisë** në të cilën punojnë të anketuarit, megjithatë, më i theksuar është në mesin e punonjësve në arsim me 12.5% dhe veprimtarinë e shërbimit me 6.5%.



Grafiku 31. A u ndjetë i diskriminuar në ndonjë farë mënyre nga punëdhënësi, për shkak të krizës shëndetësore? (kryqëzuar me industrinë e vendit të punës të anketuarit)


Përqindja e personave që ndihen të diskriminuar, në të gjitha kategoritë, është e vogël edhe sipas të **ardhurave të tyre mujore**, por megjithatë tek të anketuarit që kanë të ardhura më të ulëta mujore, perceptimi se kanë qenë të diskriminuar nga punëdhënësit, është më i theksuar.



Grafiku 32. A u ndjetë i diskriminuar në ndonjë farë mënyre nga punëdhënësi, për shkak të krizës shëndetësore? (kryqëzuar me të ardhurat mujore të anketuarit)


Grupi 5. Masat e Qeverisë për ballafaqim me krizën shëndetësore (COVID-19)

Ky grup pyetjesh ka për qëllim të analizojë se sa janë të kënaqur qytetarët me masat e marra nga Qeveria për të ndihmuar kompanitë në menaxhimin e krizës shëndetësore dhe perceptimin e qytetarëve krahasuar me masat e marra në vendet e tjera në rajon. Në pyetjen e parë "Në një shkallë nga 1 në 5, ku 5 do të thotë plotësisht i kënaqur dhe 1 plotësisht i pakënaqur, si do t'i vlerësonit masat që i morri Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për të ndihmuar kompanitë për menaxhimin e krizës shëndetësore?"; vetëm 24.8% e të anketuarve deklaruan se ishin të kënaqur (janë përgjigjur me 4 ose 5), ndërsa 39.5% ishin të pakënaqur (përgjigjur me 1 ose 2) me masat që i morri Qeveria. Thuaja një e treta, ose 30.1% e të anketuarve deklaruan se nuk janë as të kënaqur dhe as të pakënaqur me masat e theksuara të Qeverisë.




Grafiku 33. Në shkallë nga 1 në 5, ku 5 do të thotë plotësisht i kënaqur dhe 1 plotësisht i pakënaqur, si do t'i vlerësonit masat që i merr Qeveria e RMV për të ndihmuar kompanitë për menaxhimin e krizës shëndetësore?"

Kjo është një nga pyetjet ku ka dallime më të mëdha, sa i përket pyetjeve demografike. Për sa i përket **moshës**, më të kënaqur me masat që i ndërmerr Qeveria janë më të rinjtë, përkatësisht të anketuarit ndërmjet 18-29 vjeç, me 43.8%, ndërsa më të pakënaqur me masat janë të anketuarit më të moshuar, prej 60-69 vjeç, me 30.9%.



Grafiku 34. Në shkallë nga 1 në 5, ku 5 do të thotë plotësisht i kënaqur dhe 1 plotësisht i pakënaqur, si do t'i vlerësonit masat që i merr Qeveria e RMV për të ndihmuar kompanitë për menaxhimin e krizës shëndetësore?" (kryqëzuar me moshën e të anketuarit)


Ndryshime të rëndësishme ekzistojnë edhe tek të punësuarit në sektorin publik / shtetëror, krahasuar me sektorin privat, përkatësisht 49% e të punësuarve në sektorin publik / shtetëror janë të kënaqur me masat e Qeverisë së RMV, ndërsa vetëm 36% e të punësuarve në sektorin privat kanë të njëjtin qëndrim për këtë pyetje.



Grafiku 35. Në shkallë nga 1 në 5, ku 5 do të thotë plotësisht i kënaqur dhe 1 plotësisht i pakënaqur, si do t'i vlerësonit masat që i merr Qeveria e RMV për të ndihmuar


kompanitë për menaxhimin e krizës shëndetësore?" (kryqëzuar me sektorin e vendit të punës të anketuarit)

Sa i përket **industrisë** në të cilën punojnë të anketuarit, punonjësit në prodhimtari ishin më të kënaqur me masat që i morri Qeveria, me 44.4%, ndërsa më të pakënaqur ishin të anketuarit që punojnë në tregtinë me shumicë, me vetëm 8%.




Grafiku 36. Në shkallë nga 1 në 5, ku 5 do të thotë plotësisht i kënaqur dhe 1 plotësisht i pakënaqur, si do t'i vlerësonit masat që i merr Qeveria e RMV për të ndihmuar kompanitë për menaxhimin e krizës shëndetësore?" (kryqëzuar me industrinë e vendit të punës të anketuarit)

Nëse këtë pyetje e analizojmë sipas **shkallës së arsimit**, shkalla se sa janë të kënaqur me masat, është pothuajse identik tek të gjitha nivelet e arsimit, përkatësisht rreth 40 %.



Grafiku 37. Në shkallë nga 1 në 5, ku 5 do të thotë plotësisht i kënaqur dhe 1 plotësisht i pakënaqur, si do t'i vlerësonit masat që i merr Qeveria e RMV për të ndihmuar kompanitë për menaxhimin e krizës shëndetësore?" (kryqëzuar me nivelin e arsimimit të anketuarit)


Sa i përket të ardhurave **mesatare mujore**, më të kënaqur me masat e Qeverisë ishin të anketuarit që kanë të ardhura mujore prej 21,000 deri në 30,000 denarë me 51.3%, si dhe të anketuarit me +45,000 denarë, me 50%, ndërsa më të pakënaqur me masat, ishin të anketuarit me të ardhura më të ulëta mujore, prej 0 në 12,000 denarë, me 25%.



Grafiku 38. Në shkallë nga 1 në 5, ku 5 do të thotë plotësisht i kënaqur dhe 1 plotësisht i pakënaqur, si do t'i vlerësonit masat që i merr Qeveria e RMV për të ndihmuar


kompanitë për menaxhimin e krizës shëndetësore?" (kryqëzuar me të ardhurat mujore të anketuarit)

Në pyetjen e radhës "Kompania ku punoni, a shfrytëzoi / a shfrytëzon ndonjë nga masat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut?", 29.6% e të anketuarve u përgjigjën pozitivisht, ndërsa 45.4% thanë se kompanitë ku ata punojnë nuk i kanë shfrytëzuar masat e Qeverisë. Është e lartë përqindja e atyre që nuk e dinë nëse kompania e tyre ka shfrytëzuar masa të Qeverisë, përkatësisht 25 %.




Grafiku 39. Kompania ku punoni, a shfrytëzoi / a shfrytëzon ndonjë nga masat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut?

Këtë pyetje e analizuar edhe në aspekt të **industrisë** ku punojnë të anketuarit. Sipas të anketuarve, kjo masë është përdorur më së shumti nga kompanitë, veprimtaria primare e të cilave është shëndetësia, 40.6% dhe tregtia me shumicë, me 36%.



Grafiku 40. Kompania ku punoni, a shfrytëzoi / a shfrytëzon ndonjë nga masat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut? (kryqëzuar me industrinë e vendit të punës të anketuarit)

Pyetja e tretë në këtë grup pyetjesh lidhet me krahasimin e masave me vendet e tjera fqinje, përkatësisht "A mendoni se Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka miratuar masa më të dobishme ose më pak të dobishme për kompanitë private për të kapërcyer më lehtë krizën shëndetësore, në krahasim me vendet fqinje?". Shumica e të anketuarve, gati gjysma (49.4%), mendojnë se masat e miratuara nga Qeveria janë përafërsisht të njëjta si në vendet e tjera fqinje, ndërsa 30.3% besojnë se masat e miratuara nga Qeveria janë më pak të dobishme krahasuar me vendet e tjera fqinje. Vetëm 9.9% e të anketuarve besojnë se Qeveria ka miratuar masa më të dobishme sesa vendet e tjera fqinje.




Grafiku 41. "A mendoni se Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka miratuar masa më të dobishme, ose më pak të dobishme për kompanitë private për të kapërcyer më lehtë krizën shëndetësore, në krahasim me vendet fqinje?"

Përsa i përket **moshës, nivelit të arsimit, sektorit, të ardhurave mesatare mujore dhe industrisë** në të cilën punojnë të anketuarit, nuk ka dallime të mëdha për këtë çështje, përkatësisht tek të gjithë mbizotëron përgjigjja se masat e miratuara nga Qeveria janë përafërsisht të njëjta si në vendet e tjera fqinje.

Grupi 6. Favorizim dhe / ose diskriminim i sektorëve të caktuar, kompanive ose grupeve të punëtorëve


Në pyetjen "A mendoni se Qeveria, me masat që i ndër morri për t'u ballafaquar me pandeminë, favorizoi sektorë të caktuar, kompani apo grupe punëtorësh?", 19.1% u përgjigjën pozitivisht, ndërsa 52.6% besojnë se nuk kishte favorizime kur u sollën masat.



Grafiku 42. "A mendoni se Qeveria, me masat që i ndër morri për t'u ballafaquar me pandeminë, favorizoi sektorë të caktuar, kompani apo grupe punëtorësh?"

Në mesin e atyre që mendojnë se sektorë të caktuar, kompani apo grupe punëtorësh ishin të favorizuar, shumica mendojnë se më i favorizuar është sektori privat me 17.2%, pastaj vjen administrata publike me 15.1% dhe hotelieria dhe turizmi me 11.5%.


Lidhur me **industrinë**, të punësuarit në tregtinë me shumicë kanë perceptimin më të lartë (40%) se Qeveria me masat e miratuara favorizoi sektorë të caktuar, kompani apo grupe punëtorësh, ndërsa midis të punësuarve në tregtinë me pakicë, ky qëndrim është më pak i shprehur, me 12.9%.



Grafiku 43. A mendoni se Qeveria, me masat që i ndër morri për t'u ballafaquar me pandeminë, favorizoi sektorë të caktuar, kompani apo grupe punëtorësh? (kryqëzuar me industrinë e të anketuarit)

Nëse e analizojmë këtë pyetje sipas të **ardhurave mesatare mujore** të të anketuarve, mendimi se sektorë të caktuar, kompani apo grupe punëtorësh janë favorizuar më i theksuar është tek të anketuarit me të ardhura mujore ndërmjet 0 - 12,000 denarë, me 50%, ndërsa përqindja më e ulët është në mesin e të anketuarve me të ardhura mujore prej 30,000 deri në 45,000 denarë, me 16,7%.


Qeveria me masat që i ndër morri favorizoi sektorë të caktuar, kompani apo grupe punëtorësh? (Të ardhura mujore)



*Ден= den

Графикон 44. A mendoni se Qeveria, me masat që i ndër morri për t'u ballafaquar me pandeminë, favorizoi sektorë të caktuar, kompani apo grupe punëtorësh? (kryqëzuar me të ardhurat mujore të anketuarit))


Pyetja e rradhës ka të bëjë me diskriminimin ndaj sektorëve të caktuar, ndërmarrjeve ose grupeve të punëtorëve, me miratimin e masave. Gati gjysma e të anketuarve, përkatësisht 46.4% nuk mendojnë se sektorë të caktuar, kompani ose grupe punëtorësh ishin diskriminuar nga masat, ndërsa 27.1% mendojnë se një gjë e tillë ekzistonte.



Графику 45. A mendoni se Qeveria, me masat që i ndër morri për t'u ballafaquar me pandeminë, diskriminoi sektorë të caktuar, kompani apo grupe punëtorësh?

Nga të anketuarit që u përgjigjën pozitivisht në këtë pyetje, shumica, 50.9% mendojnë se sektori më i diskriminuar është hotelieria dhe turizmi, i ndjekur nga sektori juridik 11.7%.


Edhe këtë pyetje e analizuam sipas industrisë dhe të ardhurave mesatare mujore. Sipas **industrisë**, të punësuarit në arsim më së shumti besojnë se sektorë të caktuar, kompani ose grupe punëtorësh u diskriminuan me marrjen e masave, 50%, ndërsa, përqindja më e ulët është tek punonjësit në prodhimtari me 21.7%.



Grafiku 46. A mendoni se Qeveria, me masat që i ndër morri për t'u ballafaquar me pandeminë, diskriminoi sektorë të caktuar, kompani apo grupe punëtorësh? (kryqëzuar me industrinë e vendit të punës të anketuarit)

Lidhur me të **ardhurat mesatare mujore**, më i shprehur është qëndrimi tek të anketuarit me të ardhura mujore ndërmjet 0 - 12,000 denarë, përkatësisht 62.5% të tyre besojnë se sektorë të caktuar, kompani ose grupe punëtorësh kanë qenë të diskriminuar me marrjen e masave, ndërsa përqindja më e ulët është tek të anketuarit me të ardhura mujore prej 12,000 deri në 21,000 denarë, me 23,1%.

Qeveria me masat që i ndër morri a diskriminoi sektorë të caktuar, kompani apo grupe punëtorësh? (Të ardhurat mujore)



*Ден = den

Grafiku 47. A mendoni se Qeveria, me masat që i ndër morri për t'u ballafaquar me pandeminë, diskriminoi sektorë të caktuar, kompani apo grupe punëtorësh? (kryqëzuar me të ardhurat mujore të anketuarit)

V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga Pandemia COVID-19, tashmë janë infektuar 58,655 njerëz dhe 20,961 janë në proces të trajtimit aktiv. Nëse të dhënat e popullësisë totale nga regjistrimi i fundit merren si të sakta, atëherë numri i rasteve aktive përbën 1% të popullësisë, ndërsa numri i të infektuarve është gati 3%. Kriza është një goditje e paparë për ekonominë dhe tregun e punës, dhe perspektivat, si dhe sasia dhe cilësia e punësimit po përkeqësohen. Që tani, të dhënat zyrtare flasin për rritjen e papunësisë në ekonominë formale. Parashikimet janë jashtëzakonisht të këqija dhe që tani flitet për një krizë ekonomike globale. Ngushëllimi i vetëm mund të jetë fakti që pasojat do të ndjehen nga të gjithë, jo vetëm nga qytetarët tanë.

Nevojiten përpjekje në kohë, gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara të politikave për të siguruar mbështetje për punësimin dhe të ardhurat, si dhe për të stimuluar ekonominë. Masat nuk duhet të mbrojnë vetëm kompanitë, por edhe punëtorët, nga humbjet e drejtpërdrejta të vendeve të punës dhe të ardhurave. Është e domosdoshme një qasje e bazuar në masa proaktive, gjithëpërfshirëse dhe të integruara në të gjitha fushat, si dhe një dialog i mirë-organizuar tripalësh dhe qasje zbatimi që do të zvogëlojë abuzimet dhe do të sigurojë që ndihma e ofruar do të shfrytëzohet në mënyrë efektive dhe efikase. Prandaj, ndërtimi i sigurisë përmes besimit dhe dialogut është thelbësor për efektivitetin e masave dhe politikave.

Kjo krizë shëndetësore është unike në shumë mënyra. Është pandemia e parë globale, pas asaj të gripit spanjoll në vitin 1920, por përvoja e kaluar përqëndron vëmendjen në rolin qendror të punësimit, mbrojtjes sociale dhe dialogut social në politikat e zbatjes dhe rimëkëmbjes. Duke pasur parasysh përvojën, si dhe analizën e bërë, mund të nxirren përfundimet vijuese:

1. Autoritetet shëndetësore, Ministria e Shëndetësisë dhe Komisioni për sëmundjet Infektive, përmes pranisë së tyre të vazhdueshme në media, duke shkëmbyer informacione në lidhje me përhapjen e virusit dhe përgjigjet që ata japin, kanë kontribuar në forcimin e besimit të qytetarëve ndaj tyre. Edhe përsëritja e qasjes së këtyre lidhjes dhe besimit të fortë të qytetarëve, ata edhe më tutje mbetën të vetëdijshëm për brishtësinë e sistemit. Kjo qasje u përmirësua me përgjigje adekuate të shumicës së institucioneve të tjera dhe informimi mbi masat e ndërmarra, si dhe shkëmbimit të informatave të azhurnuara mbi masat ekonomike, situatën e tregut të punës, përhapjen e infeksionit etj. Hapja e web faqes së veçantë kushtuar pandemisë dhe reagimit ekonomik ishte një hap më tutje në këtë drejtim, megjithëse jo të gjithë qytetarët tanë kanë qasje në internet dhe mund të njohin

informacionet e sakta, në fluksin e lajmeve të rreme nga shumë anë, e veçanërisht përpjekjet e disave që donin të përdornin pandeminë për përfitime politike. Prandaj, **informatat e sakta, të qëndrueshme, me kohë dhe transparente janë të nevojshme jo vetëm për të luftuar pandeminë, por edhe për të zvogëluar pasigurinë dhe për të forcuar besimin në të gjitha nivelet.**

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet të vazhdojë të mbledhë, sistemojë dhe publikojë të gjitha informacionet në lidhje me koronavirusin dhe pandeminë, dhe duhet të vë në dispozicion të dhëna për efektet e pandemisë në ekonomi.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Komisioni për sëmundjet infektive duhet të kthejnë praktikën e brifingut të rregullt për gazetarët dhe opinionin, ku do të ndajnë informacionet më të fundit mbi përhapjen e infeksionit, masat e ndërmarra, testet dhe analizat për llojet e reja të virusit dhe veçanërisht hulumtimet dhe provat për efektet e vaksinave të gjetura deri më tani.
- Ministria e Shëndetësisë, në veçanti, rregullisht duhet të ndajë informacione lidhur me funksionimin e mekanizmit COVAX, qasjen në vaksina dhe disponueshmërinë e vaksinave për qytetarët tanë.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Ekonomisë, si dhe Ministria e Financave dhe organet e tyre përbërëse, duhet të mbledhin, sistemojnë dhe publikojnë të gjitha informacionet në lidhje me masat

ekonomike, zbatimin e tyre, por edhe keqpërdorimet e konstatuara.

2. **Vendi i punës është pika kryesore për shpërndarjen e informatave, komunikimit dhe sensibilizimit për sigurinë dhe shëndetin në punë, përfshirë masat parandaluese dhe mbrojtëse.** Prandaj, ndjekja e rekomandimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe udhëzimi që kompanitë të caktojnë "korona koordinatorë" që do të jenë në gjendje të marrin vazhdimisht informacione në kohë për t'i ndarë me punonjësit e tjerë, ishte një hap në drejtimin e duhur. Përkundër përpjekjeve për të organizuar procesin e punës, mbetet përshtypja **se ekziston një mungesë e mbikëqyrjes nga shteti në mënyrë që të sigurohet respektim i qëndrueshme dhe i plotë i të gjitha rekomandimeve dhe masave.**
 - Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në fund të pandemisë, dhe posaçërisht për nevojat e procesit të mbrojtjes së shëndetit të punëtorëve dhe zbatimin e procesit të vaksinimit, duhet të modifikojë masën e ndihmës financiare për pagesën e pagave. Masa e modifikuar duhet të përfshijë drejtpërdrejt "korona koordinatorët" e emëruar, duke i obliguar subjektet afaristë aty ku ata punojnë, t'i mbajnë të punësuar deri në fund të pandemisë.
3. Qeveria iu përgjigj krizës shëndetësore në kohën e duhur dhe, megjithë seriozitetin e saj, u përball me sukses me presionin mbi ekonominë. Masat e miratuara ekonomike garantonin

mbështetje për sektorët më të prekur dhe përfshinin metoda të ndryshme në qasje. Edhe pse përshtypjet për shfrytëzimin e masave nuk janë akoma të qarta, në mënyrë që të mund të nxirren konkluzione përfundimtare, një gjë është e qartë: ***menaxhimi me pandeminë dhe pasojat e saj kërkon ndërhyrje të mëdha, të ndihmuara nga burimet maksimale dhe zgjidhjet inovative.*** Vetëm në këtë mënyrë mund të mbështesim standardin e jetesës dhe të inkurajojmë rimëkëmbjen. Përkundër të gjitha përpjekjeve, ndryshimi në tregun e punës dhe trendi serioz i zvogëlimit të vendeve të punës në Maqedoninë e Veriut është i dukshëm. Prandaj, ***nevojitet një qasje më serioze në zbatimin dhe krijimin e masave ekonomike të Qeverisë.***

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet të bëjë një analizë të hollësishme të efekteve të shfrytëzimit të masave, në mënyrë që të përmirësojë pakot e ardhshme të masave ekonomike, si dhe të shpallë rezultatet e plota të analizës, në mënyrë që të informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet afariste.
- Në planifikimin e pakove të ardhshme të masave ekonomike, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të përdorë analizat dhe gjetjet, me qëllim që të përshtasë masat dhe pakot me nevojat e përfituesve përfundimtarë.
- Gjatë planifikimit të pakove të ardhshme të masave ekonomike, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta përshtasë vëllimin e

ndihmës së dhënë në përputhje me nevojat e përfituesve përfundimtarë.

4. Pandemia do të përfundojë një ditë, por shumica prej kategorive më të rrezikuara megjithatë do të mbesin pa punë, ose do të kenë të ardhura të reduktuara ndjeshëm. Megjithëse kategoritë më të rrezikuara u përkasin disa sektorëve, në hartimin e masave ekonomike, ***Qeveria u orientua vetëm drejt mbështetjes në formën e trajnimit për teknologjinë e informacionit dhe aftësive dixhitale, duke harruar kategoritë e tjera të rrezikuara dhe mbështetjen reale për punësimin e tyre në të ardhmen.***
 - Qeveria e Republikës së Maqedonisë Veriore duhet të modifikojë masat për punësimin, në mënyrë që të njohë se të rinjtë, gratë dhe personat mbi 55 vjeç janë më të rrezikuarit. Gjatë kësaj, ndihmën dhe qasjen ta dimensionojë për ta dhe punësimin e tyre në të ardhmen, pa u kufizuar në trajnime për teknologjinë e informacionit dhe aftësitë dixhitale.
 - Gjatë planifikimit të pakove të ardhshme të masave ekonomike, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të përdorë analizat e bëra dhe gjetjet e konstatuara për t'ia përshtatur masat dhe pakot e nevojave, përfituesve përfundimtarë.
 - Gjatë planifikimit të pakove të ardhshme të masave ekonomike, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të adaptojë vëllimin e ndihmës së ndarë në përputhje me nevojat e përfituesve përfundimtarë.

5. Të parët që u goditën gjatë krizës ishin punëtorët shëndetësorë, nga përkushtimi i tyre varet i gjithë suksesi në menaxhimin e krizës. Edhe në kushtet e rritjes serioze të numrit të të sëmurëve, si dhe në kushte të lodhjes ekstreme, punonjësit shëndetësorë, vazhdojnë të përballen me sukses me krizën. E vetmja gjë që është e qartë është se ***lënia pas dore shumëvjeçare e sektorit dhe vlerësimi i dobët i këtyre punëtorëve është arsyeja e migrimit të madh dhe ikjes së "trurit", dhe kjo na kushton jetë njerëzish. Madje, edhe vendet fqinje, ku kriza kishte periudha jashtëzakonisht shpërthyes, kanë tregues më të mirë se ne.***

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave duhet të jenë të vetëdijshëm se infrastruktura dhe shërbimet janë një mjet i rëndësishëm për krijimin urgjent të vendeve të punës në kriza. Për këtë arsye, angazhimin e tyre duhe ta përqëndrojnë në rritjen e investimeve në kujdesin shëndetësor. Gjatë kësaj, masat duhet të garantojnë rritjen e punësimit në shëndetësi, pajisje të plota dhe bashkëkohore, si dhe investime në ujësjellës, kushtet sanitare dhe higjienë.
 - Sekretariati për Çështjet Evropiane, procesin e programimit dhe koordinimit të ndihmës së huaj duhet ta udhëheqë dhe orientojë në mënyrë që të shfrytëzojë të gjitha fondet e hapura nga donatorë të ndryshëm, për të arritur qëllimet e përcaktuara më parë.
6. Të punësuarit janë të ekspozuar ndaj virusit dhe mbase janë nën ndikimin më

të fortë të krizës, por nuk janë të vetmit. Të papunët, punëkërkuessit, të vetëpunësuarit janë njëloj të rrezikuar dhe së shpejti do të ndjejnë ndikimin e pandemisë. ***Sistemi i mbrojtjes sociale dhe infrastruktura për shërbimet sociale rrisin qëndrueshmërinë e ekonomisë dhe shoqërisë. Mungesa e masave të mbrojtjes sociale në kontekstin e epidemive shëndetësore rrit varfërinë, papunësinë dhe informalitetin.*** Prandaj, masat ekonomike që synojnë këto grupe, e që nuk do të jenë vetëm ndihmë sociale gjatë krizës, por edhe mbështetje për punësimin në të ardhmen, janë vendimtare

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Agjencia e Punësimit duhet t'i vazhdojnë masat ekonomike dhe t'i orientojnë në mbështetjen e kategorive të personave të përmendur, drejt përmirësimit të punësimit të tyre përmes trajnimeve profesionale për ndërrimin e karrierës dhe zhvillimit të karrierës, fondeve për zhvillimin e iniciativave të reja afariste dhe të ngjashme.
7. Rëndësia e menaxhimit të krizave, rreziqeve dhe investimeve, nuk do të kalojë me kalimin e pandemisë. Për të ndihmuar ekonominë, Qeveria duhet të ketë një sistem për ndihmë dhe mbështetje, që duhet të njihet edhe nga odat ekonomike. Duhet qasur ***investimit serioz në përgatitje, aftësi për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet, vetëm në këtë mënyrë do të zbuten***

ndikimet e ardhshme negative dhe do të rritet qëndrueshmëria e bizneseve.

- Ministria e Ekonomisë duhet të fillojë një proces konsultimi me odat ekonomike dhe përfaqësuesit e tjerë të punëdhënësve, në lidhje me nevojën e zhvillimit dhe zbatimit të programeve për përgatitjen dhe menaxhimin e rreziqeve.
 - Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave dhe Sekretariati për Çështjet Evropiane do të fillojnë një proces koordinimi me donatorë të ndryshëm për të siguruar mbështetje financiare për zbatimin e programeve.
8. Edhe masat e konceptuara në mënyrën më të mirë, nuk do të kenë rezultatin e dëshiruar nëse nuk arrijnë tek ata që kanë më shumë nevojë për ndihmë. ***Dialogu konstruktiv dhe i vazhdueshëm social ka rol thelbësor në përgatitjen e masave, por edhe në zbatimin e tyre. Qeveritë nuk mund të përballen me krizën, ose të sigurojnë stabilitet dhe rimëkëmbje në mënyrë të njëanshme. Dialogu social është një mjet i pazëvendësueshëm për menaxhimin e ekuilibruar të krizave dhe përshpejtimin e rimëkëmbjes.***
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale do të përdorin mekanizmat e dialogut social për konsultim dhe përcaktim të hapave të ardhshëm dhe masave ekonomike në pakot për menaxhimin dhe rimëkëmbjen nga pandemia.
 - Gjatë planifikimit të pakove të ardhshme të masave ekonomike,

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të përdorë analizat e bëra dhe gjetjet e konstatuara, me qëllim përshtatjen e masave dhe pakove me nevojat e përfituesve përfundimtarë.

- Gjatë planifikimit të pakove të ardhshme të masave ekonomike, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, vëllimin e ndihmës së dhënë do ta përshtasë në pajtim me nevojat e përfituesve përfundimtarë.
9. Në strukturën e tregut të punës, kriza do të ndikojë në shumë mënyra, si për shembull më shumë punëtorë do të vazhdojnë të punojnë nga shtëpia, do të rritet dixhitalizimi i shërbimeve publike dhe private, do të ketë ndryshime në kategoritë e punëtorëve të nevojshëm në tregun e punës etj. Prandaj, ***nevojitet një analizë e hollësishme dhe përgatitje e plotë për të krijuar politika (arsimore, sociale) në dritën e ndryshimeve të pritshme. Politikat e tilla do të synojnë të mbajnë sa më shumë vende pune të jetë e mundur.***
- Duke përdorur mekanizmat e dialogut social, si dhe analizën e kushteve të tregut dhe efektet e masave të mbrojtjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do t'i qaset analizës dhe ndryshimit të politikave arsimore dhe programeve që zbatohen, me qëllim që të përshtaten me ndryshimet që ndodhën nga pandemia.
 - Duke përdorur mekanizmat e dialogut social, si dhe analizën e kushteve të tregut të punës dhe efektet e masave të

mbrojtjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do t'i qaset analizës dhe ndryshimit të politikave sociale dhe programeve për ndihmë sociale, me qëllim që të merren dhe të përshtaten me ndryshimet që ndodhën nga pandemia.

10. Nevojitet një **transparencë më e madhe** e masave ekonomike të Qeverisë për ballafaqim me krizën. Për shembull, **është e nevojshme ndarje e masave sipas kategorive** të dedikuara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, tregtarë individualë, për ndërmarrje të mëdha etj. Pastaj, **ndarje sipas sektorëve**, siç janë industria e tekstitit, bujqësia, hotelieria, turizmi, prodhimtaria e të tjera, me qëllim që qytetarët, ndërmarrjet dhe palët e tjera të interesuara të mund të gjejnë lehtë dhe thjeshtë se cila ndihmë u është dedikuar atyre. Më në fund, **nevojitet një sistem për të kërkuar dhe për të gjetur lehtë dokumentet dhe procedurat e nevojshme për shfrytëzimin e masave**, i përgatitur dhe i vendosur në një vend qendror.

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet të vazhdojë të mbledhë, sistemojë dhe publikojë të gjitha informacionet në lidhje me koronavirusin dhe pandeminë, dhe duhet të sigurojë qasje në të dhënat për efektet e pandemisë në ekonomi.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Ekonomisë, si dhe Ministria e Financave dhe organet e tyre përbërëse duhet të mbledhin,

sistemojnë dhe publikojnë të gjitha informacionet në lidhje me masat ekonomike, zbatimin e tyre, por edhe abuzimet e identifikuar.

11. Megjithëse Qeveria planifikoi dhe miratoi grupe masash ekonomike të zhvilluara në mënyrë të konsiderueshme dhe masat njohën saktë nevojën për të mbrojtur vendet e punës, për të mbrojtur subjektet afariste dhe për të ruajtur stabilitetin e ekonomisë, masat nuk ishin përgjigje adekuate dhe nuk patën efektin e dëshiruar mbi punëtorët dhe tregun e punës. Ndihma e siguruar financiare kryesisht u drejtohej subjekteve afariste, kurse keqpërdorimet e përkeqësuan më tej efektin. **Duke pasur parasysh se kriza ekonomike është para nesh, nuk do të jetë aspak e gabuar nëse masat ekonomike në të ardhmen orientohen dhe u paguhen drejtpërdrejtë punëtorëve.**

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, deri në fund të pandemisë, e posaçërisht për nevojat e procesit të mbrojtjes së shëndetit të punëtorëve dhe zbatimin e procesit të vaksinimit, duhet të modifikojë masën e ndihmës financiare për pagesën e pagave. Masa e modifikuar duhet drejtpërsëdrejti të përfshijë "korona koordinatorët" e caktuar, duke obliguar subjektet afariste ku ata punojnë, t'i mbajnë në marrëdhënie pune deri në fund të pandemisë.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, deri në fund të pandemisë, por edhe pas përfundimit të saj, do të modifikojë masat që parashohin

ndihmë financiare për pagesën e pagave, në mënyrë që të arrijnë tek shfrytëzuesit përfundimtarë - punonjësit. Me masat e modifikuara do t'i obligojnë subjektet afariste ku punojnë shfrytëzuesit, t'i mbajnë në marrëdhënie pune, si dhe të vazhdojnë të përmbushin pjesën tjetër të detyrimeve ndaj tyre.

12. Pandemia, me pasojat e saj ekonomike, më së shumti i goditi punëtorët. Pasojat ishin të shumta, punë në kushte të vështira, ekspozim ndaj virusit, por edhe humbje e vendeve të punës, humbje ekonomike, shkurtime të të drejtave të punëtorëve dhe të ngjashme. Pasojat më serioze të krizës i ndiejnë ata me të ardhurat më të ulëta. ***Nevojitet kontroll serioz për të monitoruar zbatimin e ligjeve dhe masave ekonomike, si dhe planifikim më i mirë i politikave ekonomike, me qëllim që të sigurohet***

mbrojtje e punëtorëve dhe vendeve të punës.

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave të pakove ekonomike, por edhe masat për mbrojtjen e shëndetit publik, si dhe inspektoratet, të vazhdojnë me kontrollet e rregullta të zbatimit të masave.
- Duke shfrytëzuar mekanizmat e dialogut social, si dhe analizën e kushteve të tregut dhe efektet e masave të mbrojtjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do t'i qaset analizës dhe ndryshimit të politikave sociale dhe programeve për ndihmë sociale, me qëllim që të merren dhe të përshtaten me ndryshimet që ndodhën nga pandemia.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut
2. Ligji për marrëdhënie pune, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 62/2005 dhe ndryshimet vijuese
3. Ligji për siguri dhe shëndet gjatë punës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 92/2007 dhe ndryshimet vijuese
4. Ligji për mbrojtjen e popullësisë nga sëmundjet infektive, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 66/2004 dhe ndryshimet vijuese
5. Dekrete me fuqi ligjore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë gjendjes së jashtzakonshme – Pasqyrë e sistematizuar, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj - Shkup
6. Pasqyrë e masave dhe konkluzioneve që i miratoi Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për ballafaqim me krizën shëndetësore
7. “A policy framework for tackling the economic and social impact on workers”, Organizata Ndërkombëtare e Punës
8. „Ndikimi ekonomik dhe social i KOVID-19 – Varfëria dhe mirëqenia e amvisërive“, Raport i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor, World Bank Group
9. Dialogu social rreth sigurisë dhe shëndetit gjatë punës në kontekst të KOVID-19, Organizata Ndërkombëtare e Punës
10. Politika me fokus në familjen dhe praktika të tjera të mira të vendit të punës lidhur me KOVID-19: Hapa kyç që mund t'i ndërmarrin punëdhënësit, Organizata Ndërkombëtare e Punës
11. Analizë e gjendjes së personave me aftësi të kufizuara dhe pengesa të kombinuara në Republikën e Maqedonisë
12. Analizë e gjendjes së personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë
13. Analizë e gjendjes së grave në mjediset rurale, më shumë pengesa, se sa mundësi
14. Analizë e politikave publike për të drejtat e romëve në Republikën e Maqedonisë
15. Analizë e shpenzimeve dhe efektivitetit të politikës arsimore për transferim të fëmijëve romë prej shkollave fillore speciale në arsimin e rregullt në Maqedoni
16. Analizë për ekipin e patronazhit për mbrojtje shëndetësore, sociale dhe juridike të grave të mjediseve rurale
17. Analizë e standardeve për të drejtat e punëtorëve dhe zbatimi i tyre në Republikën e Maqedonisë së Veriut
18. Analizë se në çfarë shkalle janë të kënaqur nga mekanizmat për mbrojtje të të drejtave të punëtorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut

4. VI. SHTOJCË – PYETËSOR

M1. Numri i pyetësit (Numri rendor i të anketuarit)

M2. Numri i telefoniti të anketuarit?

M3. Komuna (nga kampioni):__ __

M4. Rajoni (nga kampioni):

- 1: I Vardarit
- 2: Lindor
- 3: Jugperëndimor
- 4: Juglindor
- 5: I Pellagonisë
- 6: I Pollogut
- 7: Verilindor
- 8: I Shkupit

Për anketuesin: Konfirmoni që i anketuari jeton në komunën e definuar në kampionin (vend i banuar dhe rural / urban)

- 1- Urban
- 2- Rural

M5. Emri i vendbanimit

FILLIMI I PYETËSORIT

Mirëmëngjes / Mirëdita / Mirëmbrëma.

Unë quhem _____ dhe punoj për agjencië BRIMA- - pjesë e grupacionit KANTAR. Tani jemi duke kryer një hulumtim telefonik mbi pasojat e virusit Korona në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Numri juaj i telefonit u zgjodh rastësisht. Pjesëmarrja juaj është shumë e rëndësishme, sepse pjesëmarrja e sa më shumë të anketuarve do të mundësojë marrjen e rezultateve të sakta mbi pasojat e virusit Korona mbi tregun e punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kuptohet, përgjigjet tuaja janë plotësisht anonime dhe trajtohen si rreptësisht konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për analiza statistikore së bashku me përgjigjet e të anketuarve të tjerë.

I ANKETUAR I PËRSHTATSHËM: Këtë anketë duhet ta bëj me anëtar të amvisërisë suaj në moshë prej 18+ vjeç. Prioritet për pjesëmarrje në këtë hulumtim kanë qytetarët të cilët kanë fituar ose kanë humbur vendin e punës që nga fillimi i pandemisë COVID-19 (prej 15 marsit 2020 deri më sot) ose janë punësuar paraprakisht (i punësuar para

15 marsit 2020). Nëse në amvisërinë ka më shumë se një anëtar të përshtatshëm për të marrë pjesë në këtë sondazh, përdoret rregulli "ditëlindja e parë e ardhshme" për të zgjedhur të anketuarin.

PASI TË LIDHET KONTAKTI VAZHDO, I ANKETUARI:

1: PRANON ANKETËN

2: Refuzon anketën (për çfarëdo arsye)

3: Caktim i anketës (përpjekja e parë)

4: Caktim i anketës (përpjekja e dytë)

5: Caktim i anketës (përpjekja e tretë)

6: S'ka askush (përpjekja e parë)

7: S'ka askush (përpjekja e dytë)

8: S'ka askush (përpjekja e tretë)

9: Anketë e ndëprerë

10: Numri i telefonit nuk ekziston, sinjali i faksit, kompania

11: Numri i telefonit është çaktivizuar përkohësisht

*****SKRINING PYETJE*****

S1. Ju jeni anëtar i amvisërisë suaj i cili:

1. Është punësuar gjatë gjatë pandemisë COVID-19 (periudha nga 15 marsi 2020 deri më sot)
2. Ka mbetur pa punë gjatë pandemisë COVID-19 (periudha nga 15 marsi 2020 deri më sot)
3. Ka lidhur marrëdhënie pune para pandemisë COVID-19 (i punësuar para 15 marsit 2020)

1. Demografia

Për fillim do të donim t'ju parashtrojmë disa pyetje të përgjithshme demografike.

D1. Gjinia e të anketuarit

1. Mashkull
2. Femër

D2. Sa vjet i keni?

1. Nën 18 - ndërpreje anketën
2. 18-29

3. 30-39
4. 40-49
5. 50-59
6. 60-69
7. Më shumë se 70
9. Refuzon të përgjigjet (NUK LEXOHEJ)

D3. Cila është përkatësia juaj etnike?

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Maqedonas / e
2. Shqiptar / e
3. Serb / e
4. Turk / e
5. Rom / e
6. Vlleh / ahinkë
7. Boshnjak / e
8. Kroat / e

D4. Ku jetoni?

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Në mjedis urban (në qytet)
2. Në mjedis rural (në fshat)

D5. Cili është niveli më i lartë i arsimit që keni përfunduar (nëse janë aktualisht në shkollë - niveli më i lartë i diplomës së marrë)

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Arsimi fillor i papërfunduar
2. Arsim fillor
3. Arsim të mesëm
4. Arsim sipëror
5. Diplomë master
6. Doktor shkence

D6. Për momentin a jeni...?

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. I punësuar për pagë në sektorin publik
2. I punësuar për pagë në sektorin privat
3. I punësuar për pagë në sektorin civil
4. I vetëpunësuar
5. I papunësuar, në kërkim të punës
6. I papunësuar, nuk kërkon punë - ndërpreje anketën
7. Student / e - ndërpreje anketën

8. Pensionist / e - ndërpreje anketën
9. Persona me aftësi të kufizuara fizike ose shqisore - ndërpreje anketën
10. Tjetër, specifiko _____
11. Fermer i regjistruar

D7. Cili ishte statusi juaj i punës para fillimit të krizës shëndetësore (Covid 19).

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. I punësuar në sektorin publik
2. I punësuar në sektorin privat
3. I punësuar në sektorin civil
4. I vetëpunësuar
5. I papunësuar, në kërkim të punës
6. I papunësuar, nuk kërkon punë
7. Student /e
8. Pensionist / e
9. Persona me aftësi të kufizuara fizike ose shqisore
10. Tjetër, secifiko _____
11. Fermer i regjistruar

D8. (Nëse në pyetjen D6 janë përgjigjur nën 2 ose 4) Në cilën industrri punoni(veprimtaria primare)?

(Për anketuesin: lexoji përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Veprimtari shërbimi (shënoni veprimtari primare) _____
2. Prodhimtari (shënoni veprimtari primare) _____
3. Tregti me shumicë (shënoni veprimtari primare) _____
4. Tregti me pakicë (shënoni veprimtari primare) _____
5. Arsim
6. Shëndetësi
7. Ushtri/Polici
8. Refuzon të përgjigjet

D8_1. Veprimtari shërbimi (shënoni veprimtari primare)?

1. Hotelieri dhe turizëm
2. Transport dhe distribuim
3. Telekomunikime dhe IT
4. Medime dhe marketing
5. Sigurim
6. Industria e automjeteve
7. Lojërat e fatit
8. Punë administrative
11. Shitore dhe markete
12. Ndërtimtari

- 13. Sektori financiar
- 14. Zejtar individual
- 17. Mirëmbajtje sanitare
- 18. Zdrukhtari
- 22. Tjetër

D8_2. Prodhimtari (shënoni veprimtari primare) ?

- 1. Hotelieri dhe turizëm
- 2. Transport dhe distribuim
- 3. Telekomunikime dhe IT
- 4. Mediume dhe marketing
- 6. Industria e automjeteve
- 9. Bujqësi
- 10. Industria e tekstilit
- 12. Ndërtimtari
- 13. Sektori financiar
- 14. Zejtar individual
- 15. Industri farmaceutike
- 17. Mirëmbajtje sanitare
- 18. Zdrukhtari
- 19. Industri ushqimore
- 20. Industria e metaleve dhe minierat
- 22. Tjetër

D8_3. Tregti me shumicë (shënoni veprimtari primare) ?

- 2. Transport dhe distribuim
- 6. Industria e automjeteve
- 8. Punë administrative
- 9. Bujqësi
- 10. Industria e tekstilit
- 11. Shitore dhe markete
- 12. Ndërtimtari
- 15. Industri farmaceutike
- 19. Industri ushqimore
- 22. Tjetër

D8_4. Tregti me pakicë (shënoni veprimtari primare)?

- 6. Industria e automjeteve
- 9. Bujqësi
- 10. Industria e tekstilit
- 11. Shitore dhe markete
- 12. Ndërtimtari

- 14. Zejtari individual
- 15. Industri farmaceutike
- 16. Tregtia e derivateve të naftës
- 18. Zdrukthtari
- 19. Industri ushqimor
- 22. Tjetër

9. Roli i krizës shëndetësore (Covid 19) në kompaninë tuaj dhe vendin tuaj të punës

Të gjithë jemi të njohtuar me krizën shëndetësore (Covid 19), kështu që tani dëshirojmë t'ju parashtrojmë disa pyetje se si ndikoi ajo në vendin tuaj të punës.

Q1. A shkonit rregullisht në ambientet e vendit tuaj të punës, gjatë krizës shëndetësore (Covid 19), në periudhën kur shteti caktoi masa të jashtzakonshme?

(Për Anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

- 1. Po, gjatë gjithë krizës rregullisht shkoja në vendin tim të punës
- 2. Po, në pjesën më të madhe të krizës shkoja rregullisht në vendin tim të punës
- 3. Punoja nga shtëpia dhe vetëm herë pas here shkoja në vendin tim të punës
- 4. Jo, fare nuk shkoja në vendin e punës, puna u transferua plotësisht në punë nga shtëpia
- 5. Jo, fare nuk shkoja në vendin e punës, shfrytëzoja masën “prind i fëmijës nën 10 vjeç”
- 6. Tjetër (shëno) _____
- 7. Ndalesë për punë për shkak të pandemisë
- 8. Ka mbetur pa punë
- 9. Nuk di / Refuzoj të përgjigjem (NUK LEXOHE)

Q2. (Nëse në pyetjen Q1 janë përgjigjur nën 1, 2 ose 3) A u përmbahet kompania juaj të gjitha rekomandimeve (dezinfektim i rregullt, distancë e përshtatur ndërmjet të punësuarve etj.) të imponuara gjatë krizës COVID-19?

(Për Anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

- 1. Po, plotësisht i përmbahet të gjitha rekomandimeve
- 2. Vetëm pjesërisht i përmbahej të gjitha rekomandimeve
- 3. Jo, fare nuk i përmbahej rekomandimeve
- 4. Tjetër(shëno) _____
- 9. Nuk di / Refuzoj të përgjigjem (NUK LEXOHE)

Q3. (Nëse në pyetjen Q1 janë përgjigjur nën 3 ose 4) Cila është përvoja juaj për punën nga shtëpia? Renditeni në shkallën prej 1 deri në 5, ku 5 do të thotë plotësisht produktive, kurse 1 plotësisht joproduktive.

(Për Anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Plotësisht joproduktive
- 2.
- 3.
- 4.
5. Plotësisht produktive
9. Nuk di / Refuzoj të përgjigjem (NUK LEXOHEJ)

Q4. (Nëse në pyetjen Q3 janë përgjigjur nën 1 ose 2) Thoni negativitetet më të mëdha, për shkak të të cilave mendoni se puna nga shtëpia është joproduktive?
(Pyetje e hapur (shëno))

Q4_rec. (Nëse në pyetjen Q3 janë përgjigjur nën 1 ose 2) Thoni negativitetet më të mëdha, për shkak të të cilave mendoni se puna nga shtëpia është joproduktive?

1. Papërgatitje për mësim on line
2. Mungesa e kushteve adekuate për punë nga shtëpia
3. Pamundësia për të bashkëpunuar me kolegët
4. Nuk di / Refuzon

Q5. Nëse në pyetjen Q3 janë përgjigjur nën 4 ose 5) Renditni përfitimet më të mëdha që ju bëjnë të mendoni se puna nga shtëpia është më produktive
(Pyetje e hapur (shëno))

Q5_rec. Nëse në pyetje Q3 janë përgjigjur nën 4 ose 5) Renditni përfitimet më të mëdha që ju bëjnë të mendoni se puna nga shtëpia është më produktive?

1. Mbrojtje nga virusi Korona
2. Më shumë kohë për punë
3. Punoni pa presion
4. Nuk di / Refuzon

Q6. Si ndikon / ka ndikuar kriza shëndetësore (Covid 19) në vëllimin e punës së kompanisë tuaj?

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Ngarkesa e punës është zvogëluar / u zvogëlua ndjeshëm
2. Ngarkesa e punës është zvogëluar / u zvogëlua, por jo ndjeshëm
3. Ngarkesa e punës është / ishte e njëjtë si më parë
4. Ngarkesa e punës është rritur / u rrit, por jo ndjeshëm
5. Ngarkesa e punës është rritur / u rrit ndjeshëm
6. Tjetër (shëno)_____

7. Ndërprerje e punës
8. Nuk di / Refuzoj të përgjigjem (NUK LEXOHE)

Q7. Si ndikon / ka ndikuar kriza shëndetësore (Covid 19) në përfitueshmërinë në kompaninë tuaj?

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Përfitueshmëria është / u ul ndjeshëm
2. Përfitueshmëria është e zvogëluar / u zvogëlua, por jo dukshëm
3. Përfitueshmëria është / ishte e njëjtë si më parë
4. Përfitueshmëria është / u rrit, por në mënyrë të parëndësishme
5. Përfitueshmëria është / u rrit ndjeshëm
6. Tjetër (shëno)_____
7. Veprimtari jofitimprurëse
8. Nuk di / Refuzoj të përgjigjem (NUK LEXOHE)

Q8. A ka kontribuar kriza shëndetësore (Covid 19) në ulje të numrit të të punësuarve në kompaninë tuaj?

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Po, numri i të punësuarve është zvogëluar / u zvogëlua ndjeshëm
2. Po, numri i të punësuarve ishte / është zvogëluar pak
3. Jo, numri i të punësuarve nuk ishte / është zvogëluar
4. Tjetër (shëno)_____
5. Numri i të punësuarve është rritur
6. Nuk di / Refuzoj të përgjigjem (NUK LEXOHE)

Q9. A ka / ka pasur ulje të pagave të punonjësve në kompaninë tuaj për shkak të krizës shëndetësore (Covid 19)?

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Po, ka / ka pasur ulje të ndjeshme të pagave të punonjësve (më shumë se 20%)
2. Po, por ulja e pagave të punonjësve është / ishte jo e ndjeshme (më pak se 20%)
3. Jo, pagat e punonjësve mbetën të njëjta
4. Përkundrazi, pagat e punonjësve u rritën
5. Tjetër (shëno)_____
6. Nuk di / Refuzoj të përgjigjem (NUK LEXOHE)

Q10. A u zvogëlua e drejta juaj për pushim vjetor për shkak të krizës shëndetësore (Covid 19)?

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Po, pushimi vjetor na u zvogëlua ndjeshëm
2. Po, pushimi vjetor na u zvogëlua, por jo ndjeshëm

3. Jo, pushimi vjetor nuk na u shkurtua aspak
4. Tjetër (shëno)_____
5. Nuk na dhanë fare pushim vjetor
6. Nuk ka të drejtë për pushim vjetor
7. Nuk di / Refuzoj të përgjigjem (NUK LEXOHE)

Q11. A jeni ndjerë i diskriminuar nga punëdhënësi juaj në ndonjë mënyrë, për shkak të krizës shëndetësore?

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Po
2. Jo
3. Nuk di / Refuzoj të përgjigjem (NUK LEXOHE)

Q12. (Nëse në pyetjen Q11 është përgjigjur me PO) A mund të jepni një shembull për këtë? (Pyetje e hapur (shëno)

Q12_rec. (Nëse në pyetje Q11 është përgjigjur me PO) A mund të jepni një shembull për këtë?

1. Zvogëlim i pagës
2. Obligime të shtuara
3. Mosrespektim i masave/ rekomandimeve
4. Shkurtim i pushimit / Nuk i është dhënë pushim
5. Mobing
6. Është pushuar nga puna
7. Nuk di / Refuzoj të përgjigjem

10. Masat e Qeverisë për ballafaqimin me krizën shëndetësore (Covid 19)

Q13. Në një shkallë nga 1 në 5, ku 5 do të thotë plotësisht i kënaqur dhe 1 plotësisht i pakënaqur, si do t'i vlerësonit masat që i ndërmerr Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për të ndihmuar kompanitë për menaxhimin e krizës shëndetësore?

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Tërësisht të pakënaqur
- 2.
- 3.
- 4.
5. Tërësisht të kënaqur
6. Nuk di / Refuzoj të përgjigjem (NUK LEXOHE)

Q14. A shfrytëzon / shfrytëzoi kompania ku punoni, pjesë të masave të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut?

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Po
2. Jo
3. Tjetër (shëno)_____
4. Nuk di / Refuzoj të përgjigjem (NUK LEXOHE)

Q15. A mendoni se Qeveria, me masat që i solli për ballafaqimin me pandeminë, favorizoi sektorë të caktuar, kompani apo grupe të punonjësve?

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Po
2. Jo
3. Tjetër (shëno)_____
4. Nuk di / Refuzoj të përgjigjem (NUK LEXOHE)

Q16. (Nëse në pyetjen Q15 janë përgjigjur PO) Cilët janë ata sektorë, kompani apo grupe punëtorësh? (Pyetje e hapur (shëno))

Q16_rec. (Nëse në pyetjen Q15 janë përgjigjur PO) Cilët janë ata sektorë, kompani apo grupe punëtorësh?

1. Hotelieri dhe turizëm
3. Industria farmaceutike
6. Shëndetësi
10. Administrata publike
11. Përfitim politik
12. Sektori privat
13. Arsimi
22. Tjetër
99. Nuk di

Q17. A mendoni se Qeveria, me masat që i solli për ballafaqimin me pandeminë, diskriminoi sektorë të caktuar, kompani apo grupe të punonjësve?

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Po
2. Jo
3. Tjetër (shëno)_____
4. Nuk di / Refuzoj të përgjigjem (NUK LEXOHE)

Q18. (Nëse në pyetjen Q17 janë përgjigjur PO) Cilët janë ata sektorë, kompani apo grupe punëtorësh? (Pyetje e hapur (shëno)

Q18_rec. (Nëse në pyetjen Q17 janë përgjigjur PO) Cilët janë ata sektorë, kompani apo grupe punëtorësh?

1. Hotelieri dhe turizëm
2. Transport dhe distribuim
3. Industria farmaceutike
6. Shëndetësia
7. Artistët e estradës
8. Industria e tekstilit
9. Fermerët
10. Administrata publike
11. Kompanitë e kundërshtarëve politikë
12. Sektori privat
13. Arsimi
17. Zejtarët
18. Ndërtimtaria
22. Tjetër
99. Refuzon të përgjigjet

Q19. A mendoni se Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për kapërcimin më të lehtë të krizës shëndetësore, ka miratuar masa më të dobishme ose më pak të dobishme për ndërmarrjet private në krahasim me vendet e tjera fqinje?

(Për anketuesin: lexo përgjigjet – VETËM NJË PËRGJIGJE)

1. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi masa më të dobishme në krahasim me shtetet tjera fqinje
2. Masat që i solli Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë përafërsisht të njëjta si edhe në shtetet tjera fqinje
3. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut solli masa më pak të dobishme në krahasim me shtetet tjera fqinje
4. Tjetër (shëno)_____
5. Nuk di / Refuzoj të përgjigjem (NUK LEXOHE)

FUNDI I BËRTHAMËS

D10a. Përafërsisht, sa janë të ardhurat tuaja PERSONALE mesatare mujore?

Nuk keni nevojë të specifikoni shumën e saktë, thjesht më tregoni se cilës nga kategoritë e mëposhtme Ju i përkisni.

(VETËM NJË PËRGJIGJE)

01: 0-3,000 ден.

02: 3,001-6,000 den

03: 6,001-9,000 den

04: 9,001-12,000 den

05: 12,001 - 15,000 den

06: 15,001 - 18,000 den

07: 18,001 - 21,000 den

08: 21,001 - 24,000 den

09: 24,001 - 27,000 den

10: 27,001 - 30,000 den

11: 30,001 - 45,000 den

12: 45,001 + den

97: Nuk kam të ardhura personale (NUK LEXOHE)

98: Refuzon të përgjigjet (NUK LEXOHE)

99: Nuk di (NUK LEXOHE)

Ju falenderojmë për pjesëmarrjen në këtë hulumtim. Kalofshi një ditë të mbarë.

VII. SHTOJCË – UDHËZUES TEMATIK PËR HULUMTIMIN KUALITATIV

Nëpunësit publik

Kohëzgjatja: deri në 30 minuta

I. Hyrje dhe njohje e përgjithshme

1. Me çka merreni për momentin

2-3 minuta

- Çka punoni? / Ku punoni?
- Sa kohë ka që jeni në këtë vend pune?
- A ju sfidon puna juaj? A jeni të kënaqur?

2. Shqetësimet dhe prioritetet

2-3 minuta

- Cilat janë prioritetet tuaja në jetë?
- Çfarë ju shqetëson më së shumti?
- Kush/çfarë ju pengon t'i përmbushni prioritetet dhe të merreni me shqetësimet?

II. Kriza shëndetësore (Covid-19), kompania juaj dhe masat e Qeverisë

1. Si ndikoi kriza shëndetësore (Covid-19) në punë në institucionin ku punoni / punonit?

7-10 minuta

- A ndikoi kriza shëndetësore në zvogëlimin e vëllimit të punës?
- Kriza shëndetësore, a shkaktoi ulje të numrit të punësuarve?
 - Nëse po, a ishte për shkak të sëmundjes (pozitivë në Covid-19, të sëmurë kronikë që i përkasin kategorisë së rrezikuar, të tjera)
 - Nëse jo, a ishte kjo për shkak të zvogëlimit të vëllimit të punës?
 - Nëse po, sa përqind, cilët sektorë ishin më të prekur?
- A i përmbahet të gjitha rekomandimeve të autoriteteve shëndetësore, institucioni ku punoni?
- A praktikoni / praktikoni punë nga shtëpia. Cila është përvoja juaj për punën nga shtëpia? (Këtu një vështrim të veçantë të atyre që jetojnë me fëmijë të vegjël)
- A u zvogëlua / shkurtua e drejta juaj për pushim vjetor, për shkak të krizës shëndetësore?

2. A jeni të njohur me masat që i ndërmorrën institucionet për të ndihmuar ekonominë?

7-10 minuta

- Ku informoheshit për masat?
- Si qytetar, a keni shfrytëzuar pjesë të masave?
- A jeni të kënaqur me masat?
 - Nëse po, cila nga masat mendoni se ishte më e dobishme, e cila më

- o pak e dobishme?
 - o Nëse jo, çfarë mendoni se duhet të kishin ndërmarrë institucionet (Qeveria) për t'i bërë kompanitë më të qëndrueshme gjatë krizës shëndetësore?
 - o Ku e adresoni më shumë fajin, tek pronarët e kompanive, apo tek institucionet e shtetit?
- A keni njohuri për ndonjë masë, që ishte zbatuar në ndonjë nga shtetet tjera, për të cilën mendoni se me të vërtetë do të ishte e dobishme të zbatohet edhe në shtetin tonë?(Këtu theks të veçantë në shtetet fqinje)

III. Konkluzione dhe rekomandime

Punëdhënësit

Kohëzgjatja: deri në 30 минути

IV. Hyrje dhe njohje e përgjithshme

3. Me çfarë merreni për momentin

2-3 minuta

- Me çfarë merret veprimtaria juaj afariste?
- Sa gjatë mbijetoni në sektorin?
- A njihet biznesi juaj nga klientët dhe a fiton vlerë? A janë të kënaqur?

4. Shqetësimet dhe prioritetet

2-3 minuta

- Cilat janë prioritetet tuaja në jetë?
- Çfarë ju shqetëson më së shumti?
- Kush/çfarë ju pengon t'i përmbushni prioritetet dhe të merreni me shqetësimet?

V. Kriza shëndetësore (Covid-19), kompania juaj dhe masat e Qeverisë

3. Si ndikoi kriza shëndetësore (Covid-19) në punën e veprimtarisë suaj afariste?

7-10 minuta

- A ndikoi kriza shëndetësore në zvogëlimin e vëllimit të punës?
- A u zvogëluan të hyrat, për shkak të krizës shëndetësore?
 - o Nëse po, sa muaj zgjati kjo?
 - o A u përfshi e tërë veprimtaria afariste?
- A u ballafaquat me zvogëlim të numrit të të punësuarve, për shkak të krizës shëndetësore?
 - o Nëse po, a ishte për shkak të sëmundjes (pozitivë në Covid-19, të sëmurë kronikë që i përkasin kategorisë së rrezikuar, të tjera)
 - o Nëse jo, a ishte kjo për shkak të zvogëlimit të vëllimit të punës?
 - o Nëse po, sa përqind, cilët sektorë ishin më të prekur?

- Në veprimtarinë tuaj afariste, a u jeni përmbajtur të gjitha rekomandimeve të autoriteteve shëndetësore?
- A kërkonit nga punëtorët që rregullisht të shkojnë në punë gjatë krizës shëndetësore?
- A ua keni ulur të drejtën për pushim vjetor punonjësve tuaj, për shkak të krizës shëndetësore?

4. A jeni të njohur me masat që i ndërmorrën institucionet për të ndihmuar ekonominë? **7-10 minuta**

- Ku informoheshit për masat?
- A ka shfrytëzuar pjesë të masave sipërmarrja juaj afariste?
- A jeni të kënaqur me masat?
 - Nëse po, cila nga masat mendoni se ishte më e dobishme, e cila më pak e dobishme?
 - Nëse jo, çfarë mendoni se duhet të kishin ndërmarrë institucionet (Qeveria) për t'i bërë kompanitë më të qëndrueshme gjatë krizës shëndetësore?
 - Ku e adresoni më shumë fajin, tek pronarët e kompanive, apo tek institucionet e shtetit?
- A keni njohuri për ndonjë masë, që ishte zbatuar në ndonjë nga shtetet tjera, për të cilën mendoni se me të vërtetë do të ishte e dobishme të zbatohet edhe në shtetin tonë?(Këtu theks të veçantë në shtetet fqinje)

VI. Konkluzione dhe rekomandime

Punonjësit

Kohëzgjatja: deri në 30 minuta

VII. Hyrje dhe njohje e përgjithshme

5. Me çfarë merreni për momentin

2-3 minuta

- Çka punoni? / Ku punoni?
- Sa kohë ka që jeni në këtë vend pune?
- A merrni vlerë nga puna juaj? A jeni të kënaqur?

6. Shqetësimet dhe prioritetet

2-3 minuta

- Cilat janë prioritetet e juaja në jetë?
- Çfarë ju shqetëson më së shumti?
- Kush/çfarë ju pengon t'i përmbushni prioritetet dhe të merreni me shqetësimet?

VIII. Kriza shëndetësore (Covid-19), kompania juaj dhe masat e Qeverisë

5. Si ndikoi kriza shëndetësore (Covid-19) në punë në kompaninë ku punoni / keni punuar? **7-10 minuta**

- A ndikoi kriza shëndetësore në zvogëlimin e vëllimit të punës?
- A ju zvogëluan pagat, për shkak të krizës shëndetësore?
 - Nëse po, sa muaj zgjati?
 - A ishin të përfshirë të gjithë sektorët në kompaninë?
- Kriza shëndetësore, a shkaktoi ulje të numri të të punësuarve? Nëse po, sa përqind, cilët sektorë ishin më të prekur?
- A i përmbahet kompania juaj të gjitha rekomandimeve të autoriteteve shëndetësore?
- A shkonit rregullisht në punë gjatë krizës shëndetësore? A praktikoni / praktikoni punë nga shtëpia. Cila është përvoja juaj për punën nga shtëpia. (Këtu një vështrim të veçantë të atyre që jetojnë me fëmijë të vegjël)
- A u zvogëluar / shkurtua e drejta juaj për pushim vjetor, për shkak të krizës shëndetësore?

6. A jeni të njohur me masat që i ndërmorrën institucionet për të ndihmuar ekonominë? **7-10 minuta**

- Ku informoheshit për masat?
- A shfrytëzoi pjesë të masave, kompania ku punoni / punonit?
- A jeni të kënaqur me masat?
 - Nëse po, cila nga masat mendoni se ishte më e dobishme, e cila më pak e dobishme?
 - Nëse jo, çfarë mendoni se duhet të kishin ndërmarrë institucionet (Qeveria) për t'i bërë kompanitë më të qëndrueshme gjatë krizës shëndetësore?
 - Ku e adresoni më shumë fajin, tek pronarët e kompanive, apo tek institucionet e shtetit?
- A keni njohuri për ndonjë masë, që ishte zbatuar në ndonjë nga shtetet tjera, për të cilën mendoni se me të vërtetë do të ishte e dobishme të zbatohet edhe në shtetin tonë? (Këtu theks të veçantë në shtetet fqinje)

IX. Konkluzione dhe rekomandime

